

**LONI
PAPÄ**

BIBLIOTEKA

E

844-31

211

SHTETL

GIROKASTER



Fundi i një vjeshte

roman

PJI - 31
P24

LONI PAPA

Fundi
i një
vjeshte

Roman

SHËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

VILET E DASHURISË

Në mëngjes qyteza shpinte gjymtyrët e veta.

Në veprat e artit punohej me ngulm e turne të pandërprera. Netët quheshin net betoni. Edhe kur qyteza nuk jetonte netët e betonit, zgjimi i saj fillonte sa fekste, me ca pëshpërima nëpër sjetore: «Zgjohu, shok! Çohu shpejt!» Tjetri buzëqeshte përgjumësh, vështronte ngultas dhe pyeste për orën. «Shshshsht! Ke turnin. Kujdes, të tjerët flenë!» «Flenë?» Dhe çohej në këmbë.

Nga fundi i bujtinës dikush shtriqej; në oborr tek armatura dikush kërkonte lopatën. Një tjetër mbështetej te stoli dhe priste sa të grumbulloheshin të gjithë e të niseshin për në punë.

Qyteza ngjante me një muze pa gurë e pa pikitura të sjella nga lashtësia, ku përplasen botë dhe veçohen kohë nga më të ndryshmet. Bota rimore e këtyre banorëve të ardhur nga ana e anës, gjallonte thellë dhe, papritur, shpërthente edhe buzëmbrëmjesh në rrugët e qytezës, në copëra bisedash, të hedhura lakuriq, nga më dramatiket e deri te më qesharaket...

Matanë thurimave, në të dy anët e rrugës kryesore, shtrihej një lulishte e vogël me disa stola të shpërndarë nëpër të. Rrugëzat e tjera

dredhonin midis barakave prej pupuliti dhe dil-nin në sheshin e madh, ku bëhej rreshtimi i brigadave, organizoheshin lodra dhe mbrëmjeve jepeshin përfundimet e një dite të lodhshme pune. Natën kishte vesuar shi dhe çatitë e barakave dukeshin si të lara. Ajri qe i ftohtë dhe mëngjesi i vjeshtës më i freskët.

Lora qe harruar mbas një kënge që vinte nga megafoni majë shtyllës dhe as e pati mendjen të përgjigjej, kur Bujari e pyeti se ku kishin punuar një natë më parë. Ai e pa dhe rrobat e saj dalëboje iu dukën në ngjyrë të baltës, ndoshta ngaqë edhe shtylla, aty pranë, ashtu ishte, në ngjyrën e baltës. Lora vështroi nga gryka e megafonit, sikur të dallonte zérat që vinin prej andej.

— Më fal, Bujar, nuk të dëgjova! — u përmend ajo.

— Të pyeta ku punuat mbrëmë, — tha ri-shtazi ai.

— Tek ura, betonuam këmbëzën.

— Gjithë natën?

— Thuajse nga mesi i natës. Sa erdhëm këtu...

Ajo u shtriq me kujdes dhe u mbështet në stol. Vjeshta i kishte vyshkur lulet rrëth e qark e, me gjithatë, ngjyra e tyre e zbërdhylët binte në sy mbi kryet e një kërcelli të hollë, ku nga nyjet vareshin krahëzit e rreshkur dhe mblidheshin mbas tij si të pajetë: ato e kishin lëshuar tanimë farën e vet. Bujari vuri re se duart e Lorës ishin të ashpra dhe ende me pluhur çimentoje, madje njërin gisht e kishte pakutë vrarë. Ai e pyeti përse nuk shkonte të flinte. Ajo i tha se nuk kishte gjumë. Ai e pyeti për gishtin. Ajo i tha se gishtin ia kishte

zënë rrota e karrocës, tek po e njiste në dërrasë. I kishte dalë nga udhëza dhe...

Biseda u ndërpre për një çast. Lorës sesi i shkoi mendja tek ura e Guravit. Një urë e vogël, që lidhte dy brigjet e një përroi. Anës përroit kishte gëmusha dhe gurë. Uji rridhëtë dhe përroi ngjante si kurrizi i një peshku të madh, që ngrohej në rreze dielli... Tregonin se në bregoren aty pranë kishte ardhur një ujkonjë me dy këlyshë. Thoshin se e kishin prurë nga matanë detit për të trembur bagëtitë, që ato të shteronin qumështin e të mos pillnin më. Pa u ngritën natën burrat e fshatit, vranë ujkonjën me gjithë këlyshë dhe e hodhën në përrua. Fëmijët ende qëllonin me gurë mbi Bregoren e Ujkonjës, kinse vrissin bishën e ardhur me dy këlyshë, që donte t'u trembte bagëtinë. Ky trill i të vegjelvë qe për shtatoren «Lupo di Toskana», të cilën fshatarët e prishën dhe e hodhën në përrua brenda një nate. Atëherë dhe ura u dukej e madhe, me ca drurë të trashë të vendosur radhë, njëri pas tjetrit, ku Lora kalonte me druajtje e frikë se mos binte në përrua nga hapësirat midis drurëve. Tani që po betononte këmbëzat e një ure mbi lumë, ura e Guravit i kishte mbetur si një kujtim dhe iu duk se mund ta kalonte me një frymë. Bujari e pyeti pas pak në i pëlqente vjeshta. Lora as e pati shkuar ndër mend një gjë të tillë dhe qeshi. Në faqe iu formuan dy gropëza. Bujari e humbi dhe mbeti si i zënë në faj.

— Se si ndihesh, kur bien gjethet, prandaj!
— tha ai.

Lora tundi kokën për t'i thënë se nuk puqeshin kurrkund.

— Ti nga sytë dukesh e lodhur, — tha ai.

Lorës nuk i erdhi mirë, kafshoi cepin e

buzës dhe sakaq iu shmang vështrimit të tij. Anëgushe flokët i fshehën regëtimën e një dëmari. Lora u turbullua dhe Bujari e vuri re. Mbi thurimë një harabel tundte bishtin, shihte anës, hapte paksa krahët, si i trembur dhe këndonte «cërr-cërr-cërr!». Zogu u hodh pupthi e zbriti anës lulishtes. Harabelat në vjeshtë janë grykës. Të paktën kështu i qenë dukur harabelat e fshatit të saj që, ende pa u mbledhur mirë misri, ishin me tufa ndër ara dhe, me të ardhur dimri, kërkonin koçekët e strehët e shtëpive «cërr-cërr-cërr e xhërr-xhërr-xhërr». Bujari tha se kishte lexuar një vjershë ku thuhej se harabelat nuk kanë ligje.

— Vjersha që merren me ligjet e harabelave?! — tha Lora me shpoti dhe, aty për atyë, preku dregëzën e gishtit e ndërrroi bisedë. — E di sa më dhemb?! Po nuk punove shpejt, betoni ngrin.

Bujari po e ndiente veten ngushtë në këto biseda me pyetje të ftohta e përgjigje të thata, që ngjanin si gjethë të rëna. Ai ferkoi ballin sipër shtegut të vetullave dhe nxitoi të tregonte diçka, por ajo ia humbi mendjen.

— Ka qenë gënjeshtër! — tha Lora dhe u çua nga stoli.

Harabeli u ngrit përsëri i trembur e fluturoi lart.

— Jo, për Gjokën desha të të them.... përfletërrufenë, — tha ai për të vazhduar më tej.

— Është gënjeshtër, — i qeshi Lora sy në sy dhe sakaq u largua, duke e lënë Bujarin po tek ai stol pranë shtyllës së megafonit.

Bujari kishte ditë që e shihte Gjokën vetull-ngrysur, tek përshkonte rrugët e qytezës me hap të hutuar, por edhe në atë hutim ai nuk e lëshonte veten përparrë gjindjes, sidomos në

prani të gruas, Regës. Gjoka ishte trupgjatë, shpatullgjerë dhe fjalëpakë. Në hekurudhë zbriti me çakçir dhe xhaketë të zakonshme stofi. Kur i vunë fletërrufenë, shkoi në një nga zyrat e shtabit dhe kërkoi një fletë kartoni. «Ta shkruaj unë!» — i tha disenjatori. «Me vdekë unë, po!» — i tha Gjoka. Mori fletën e kartonit dhe, me hapa të gjatë, doli jashtë. Në një nga sallat e ngrënies shtroi kartonin në tavolinën e fundit dhe, me një copë laps, shkroi me germa çapraze: «Kjo fletërrufë asht ma e vlefshme për ju. Gjokë Çani»

Lora humbi në një nga udhëzat e heshtura të qytezës, krah bujtinave prej pupuliti. Në rrugë e sipër ndeshi Gencin. Edhe atë mëngjes ai kishte veshur këmishën blu, pulovrin ngjyrë ulliri dhe pantallonat terital sapo të hekurosura.

— Ku shkon? — pyeti Genci dhe, i druajtur, ndali larg saj.

— Në bibliotekë, — ia ktheu ajo, pa ndalur hapin. — Kam punë me Marianën.

Genci ndenji një hop në mëdyshje dhe pastaj mori rrugën për te Bujari. Këpuca ngrinte copëra të lagështa pluhuri dhe ia hidhte në këmbëzën e pantalonave. Mbi kupolën e luleve ende qëndronin të varura pika shiu.

— Qenke lodhur! — buzëqeshi Genci dhe i shtriu dorën.

— Jo! Isha me Lorën, — tha Bujari. — Sa iku.

Genci bëri sikur nuk dëgjoi dhe ndërkohë zuri vend në stol. Ai nuk qeshte kurrë çiltër dhe kishte raste që vetëm dëgjonte, thoshte dhe ndonjë fjalë e ikte pa përgjigje. Kështu dhe atë mëngjes. Kurorat e luleve dukeshin të flashkëta. Bujari i kujtoi Lorën, ai bëri sikur nuk dëgjoi.

— E pe fletërrufenë për Gjokën? — ndërroi bisedë Bujari.

— Ai është i ndjeshëm, — tha Genci.

Bujari mblodhi buzë e supe. Tha rishtazi Genci: «E ç'më rri ashtu si guhak?! E di ti ç'janë malet?! Malet...» Ai u çua nga stoli. Në këmbëzat e pantallonave kishin mbetur njollat e pluhurit të shkundur. Mbi kupolën e luleve ende qëndronin të varura ca pikla shiu. Nga megafoni ndiheshin të tjera këngë. Rrugëventë qytezës ndiheshin zërat e vullnetarëve.

Kishte ditë që ata punonin aty, tek ura pike të 143. Gjoka rrëmbente karrocën dhe ikte. Rega grumbullonte dhé. Mandej, fytyrëpërtharë dukej sikur diç kërkonte...

Brigada ecte drejt trasesë. Një pjesë ishte shtruar me shina dhe në një pjesë ishin renditur vetëm trarët e drunjë. Agu i fushës vinte në ngjyrë të kuqërrëmtë dhe pastaj shpërndahet tej në ngjyrë alle. Nëpër ag po ecte Gjoka. Ai po ndiente më tepër freskinë e mëngjesit, se të ftohtët e natës. Ai para, Rega mbas. Mandej Rega kapërceu trarët dhe u bashkua me shoqet. Gjoka mbeti vetëm anës trasesë. Në bjeshkë agu që i copëzuar dhe me ngjyra të thekshme. Edhe kur lindte dielli e rrihte vetëm majat e pishave, përsëri kishte vende që mbeshteshin në agmi. Atëherë formoheshin njolla të ndryshme ylberi. Dhe një ditë Gjoka zbriti nga malet.

Zbriti në kohë agu.

Gjoka para, Rega mbas.

Rrugës kishte dhe ujëvara. Ai vetëm ecte dhe as e kthente kryet, se e dinte që gruaja çapitej mbas tij. Na ishte njëherë një grua që endej nëpër male e çapitej mbas burrit dhe ec e ec... Aty tek Ura e Mirdekës Gjoka qëndroi. Rega iu afrua. Ai e pushtoi në parzëm. Tek Ura e Mirdekës pëshpërimat mbeten nëpër regëtimën e yjeve: «Nuk do të ndahemi kurë, Regë!» «Jo, askurrë!» «As në udhë hekuri.» «Mos, Gjokë, mos! A nuk po ndien za?!» Gjoka kishte parë anës, atje tek Ura e Mirdekës... Rega mbas, çap e çap. Ajo nuk ia thoshte dot emrin, se rruga kishte shumë njerëz dhe zbardhëllimi i vagët qe mbushur me zëra. Atij i dukej se po linte mbas një botë, që ca emra i përmendte me pëshpërimë dhe ca... «Mirdeka!» — e thoshte me aq lehtësi, sikur të thoshte «Mirëdita!» apo «Mirëmëngjesi!»

Rega kapërceu në trarët e drunjëtë dhe Gjokës, aty anës trasesë, sec iu kujtua ai emër, që vdekjen e bënte si të mirë (!), apo ndjeu sikur e shoqja i thirri me pëshpërimë. Fresku i erës ua nxori gjumin. Vajzat u kapën dorë për dore, ndërsa djemtë e ndienin veten më të shkujdesur. Copërat e bisedave ngjanin si lëkurë pemësh të hedhura pa kujdes e të shpërndara pa cak. Na paska qenë këtu një Davë, një mirditore e guximshme që, kur u martua, i la krushqit në turp: hoqi duvakun në mes të rrugës dhe e hodhi tej. Njëherë, se cilët qenë ata, nuk dihet, na e paskan shkurtuar këmbalecin fshehurazi dhe të nesërmen brigadieri, në vend që të maste dy metra, maste një e tetëdhjetë... Shaka vullnetarësh të mbështjella me freskun e erës. Gjokës iu dukën si ca rrëfenja, ku ditët ngatërröheshin me ngjarje turnesh dhe, tek-tuk,

nxirrte krye ndonjë hero. Kështu na paskan qenë dhe dy vajza: njëra me emrin Mbarime dhe tjetra Qefine.

— Kjo është përrallë, — tha njëri nga djemtë. Zëri i tij u duk si i këputur.

— Nuk është përrallë, vëllezër, është dhimbje! — tha Lora dhe buza po i dridhej. — Prindërit nuk deshën të lindnin vajza dhe i dënuan pjellat me emrat e vdekjes.

Rega ndjeu një të përqethur dhe mbështolli trikon përpëra gjoksit... Paskan qenë dy vajza në hekurudhë. Kështu është shënuar dhe në ditarin e shtabit qendror. Dy vajza të thjeshta, që mbanin me vete dy emra të kobshëm. Shkurt, 1967. Ato u ngritën dhe, në mbledhje, grisën pasaportat. I grisën thjesht, thoshin ca, pa bujë. Në ditar nuk shënohej gjë. Ca të tjerë thanë se qanë përpëra se t'i grisnin. Në ditar përsëri nuk shënohej gjë. Dy vajzat kishin kërkuar t'u viheshin dy emra të rinj. Po atyre u vunë të njëjtin emër: Lindita. Kështu thuhej në ditar, sikur ato të kishin lindur atë ditë.

Fresku i erës mbështillte copëra bisedash.

— Ta marrë e mira, ta marrë! — tha Gjoka pasi u vendosën në punë.

E shoqja e pa kureshtare, ashtu siç qe, gjysmë e përkultur tek grumbullonte dhé me lopatë. Sa herë që fillonte punë, Gjoka uronte mbarësi e nuk truante.

— Për të mirë! — tha Rega, si e nemitur.

— Për të mirë! — tha dhe Gjoka, për të trembur mendimin e vet. — Sesi m'u dukën ato dy vajzat me ata dy emnat, prandaj... Hekurudha t'i fshin emnat!

— Emnat e kosit, po! — tha Rega dhe drejtë trupin.

Ai ia mori lopatën së shoqes dhe filloi ta

mbushte vetë karrocën. Vullnetarët përreth as e kishin mendjen tek ai. Dikush, tek zbriste nga argjinatura, shtynte me vrull një karrocë dore dhe thërriste me të madhe t'i hapsin rrugë. Një iu hakarrit të mos vraponte si i luajtur mendsh, por karrocieri as pati kohë të dëgjonte të sharat nga pas. Kujtonte «hajvani» se mund të ndërtonte hekurudhën i vetëm! Mandej u dëgjua një e qeshur e zgjatur. Kujtimi vinte vërdallë dhe porosiste të mos bënin pushim: «Dëgjuat, motra dhe vëllezër?! Motra dhe vëllezër!» — përsëdytte fjalën ai. Të tjerët qeshën. Bujari la lopatën, shkoi te gropë e gërmimit dhe u tha të bënin pushim. Kujtimi shpejtoi e i foli Bujarit të mos i ngatërronte: «Do të fillojë ngulja e pilotave, motra dhe vëllezër! Ngulja e pilotave...» Zëri i tij tërhoqi vëmendjen dhe vetiu u krijua një heshtje e shurdhët. Të gjithë mësuan se duhej të punonin pa pushim. Atë vështronin Kujtimin që nga gropë dhe askush nuk fliste. Lorën e shqetësonët një cullufe, rënë mbi ballë, dhe mundohej ta shtinte nën shallin e vullnetarit, me të cilin kishte mbledhur flokët për t'i ruajtur nga thërrmijat e dheut. Agushi la karrocën t'i mbushej dhe, ende pa u ndier vringëllima e lopatës së Regës, u gjend te gropë.

— E, shokë?! — tha Kujtimi.

— Motra dhe vëllezër! — ngjasoi Lora zërin e tij.

Të tjerët qeshën. Kujtimi iku rrëmbyer. Lora vështronte anës dhe mundohej të trempte të qeshurën. Atë mëngjes, pa feksur, ajo qe zgjuar e trembur nga një èndërr, që nuk do t'i pëlqente t'ua tregonte shoqeve. U ngrit marramenthi dhe shkoi të lahej. Uji i ftohtë i çezmës e freskoi. Atë natë ajo kishte qarë në gjumë, se Bujari apo

Genci (ëndrra i sillte të ngatërruar!), njëri nga këta na kishte prerë kokën me lopatë. Ca thoshin se e kishte prerë padashur, ca të tjerë e ngatërronin gjoja me një dashuri, që Lorës iu duk një marrëzi e vërtetë. Ëndrra qe e lidhur dhe me një shaka të bërë midis shoqesh, para se t'i zinte gjumi. Duket ato shaka ishin shtjelluar në atë ëndërr çapraze. Mbas pastrimit, krehur e pa krehur mirë, ajo as e pati mendjen të shkonte para pasqyrës dhe, si erë e trazuar, ia behu jashtë bujtinës, për t'u qetësuar nga ankthi i asaj nate.

Bujari shpejtonte të mbushte karrocën e Gencit (ndërkohë ai shkonte në gërmim e hidhët lopata me dhë me të tjerët). Nga larg kërlima e gjelatonjve u ndje si një regëtimë e mekur: «Kërli-kurli.» Vullnetarët panë nga qielli dhe ashtu, mendjehumbur në ato caste, u përpoqën të dallonin vargun e gjatë të gjelatonjve, që dërgonin nga andej, thua nga nënretë, kërlimën e largët: Kërli-kurli! Vjeshta po i priste shpesët e egra përpara kohe. Stina do të qe e lagësht.

— Kurrillat! — tha një.

— Gjelatonjtë! Këndojnë vetëm gjelat, prandaj dhe u thonë gjelatonj, — tha tjetri.

Bujari pyeti në donte dhe shumë të mbaronte gërmimi. Atëherë u kujtuan njerëzit se kishin imbetur të harruar...

— Nxënësi dembel numëron faket e librit,
— tha Genci nga fundi i gropës së gërmimit.

— Numëron lopatat e Lorës, — tha Bujari pa e menduar gjatë.

Gencit i mbeti fryma si i trembur. Lora kafshoi buzën sa i dhembti dhe mbi shtegun e vetullave iu formua një rrudhë. Një pikë uji e përzier me baltë dhe e fshirë në anë të ballit, ngjante si një shenjë plage e përtharë. Genci

doli jashtë gropës, rrëmbeu karrocën, mbushur e pa mbushur mirë, dhe u largua pa thënë fjalë.

Lora doli nga gropë e iu afrua Bujarit:

— Më parë mate fjalën dhe mandej....

Bujari mori lopatën dhe filloi të lozte me një fije bari. Ajo rrudhëza mbi shtegun e vetullave të Lorës, atij iu duk si një e prerë e hershme brisku:

— Hë!... Genci ka filluar të mbahet, — qeshi ai nën buzë.

— Edhe?! — pyeti ajo, vetiu.

— Asgjë, pulovrin ngjyrë ulliri...

Lora këndellej me pyetje naziqe e përgjigje të marra, që ngjanin si copëra ashklash të drunjta, të hedhura pa kujdes nga gdhendjet e sqeparit. Ajo pyeti përsëri. Dhe ai përsëri tha «asgjë», e lozte ende me atë fije bari që mbante ndër dhëmbë. Asaj iu duk sikur po ia guduliste buzët dhe do të donte t'ia merrte.

— Si asgjë?! Apo nuk do të dish ti ku vret e pret fjala! — tha ajo me ngulm.

Bujari e kundroi. Lora dukej si një fëmijë: shalli i vullnetarit ia mblidhte flokët dhe i nxirrte në pah fytyrën miturake me anët e bardha të gushës, të parrahura nga dielli. Ai nuk ia pa më atë rrudhëzën mbi shtegun e vetullave, sado që Lora mundohej të mbante inat. Në anë të ballit ende i qëndronte si plagë e përtharë vraka e së fshirës së asaj pike uji përzier me baltë. Gjelatonjtë nuk po ndiheshin më. Gjoka erdhi, rrëmbeu karrocën e Agushit pér ta larguar, por ajo u përbys dhe mbeti me rrotë përpjetë. Bujari seç tha. Lorës ai zë iu ngatërrua me rrapëllimën e karrocës dhe biseda e tyre mbeti përgjysmë. Më tej, Rega mbante frymën si e trembur. Gjoka ia mori lopatën dhe filloi të mbushte karrocën e vet: vring!

— Përse e përmbysë, Gjokë?! — tha Agushi sa doli nga gropë.

— Pa dashtë.

— Si pa dashtë?! Më thërrisje mua ta largoja.

— Përse e solle këtu? — tha Gjoka.

Agushi shkoi e kapi karrocën nga rrota. Ajo niste rrrotullima të ndërprera dhe ai nuk po mundej ta kthente mbarë.

— Oj?! Dheu yt është?! — tha ai dhe doli nga ana tjetër të ngrinte karrocën nga të dy dorezat.

— Po, dheu im! — dhe «vring», lopata e Gjokës nuk lëvizi më.

Ata për herë të parë u panë sy në sy. Era ia përthau Gjokës anët e syve. Dhe i tha Agushit se dheu qe i tij: «Edhe unë boll kam, edhe ti boll ke! Nji hekurudhë të tanë ke, po deshe me e ndërtue, prandej ban mirë me e shty karrocën ma tej!» Regës thuajse i luajti zemra nga vendi, tek e pa ashtu të zverdhur, me bulëzat e djersës mbi ballë. Ai vështron te kryelartë dhe, paksa i rënduar, nënqeshte. Regës iu duk sikur Gjokës po i rrighnin kyçet e nofullave me ritmet e zemrës: tak-tak! Ajo iu afrua dhe, me kujdes që të mos e shihnin, e tërhoqi nga fundi i xhaketës. Gjoka ia shkëputi dorën. Llëra e tij Regës iu duk si një cung eshtak.

— A u kuptuam? — tha Gjoka.

— Jo, nuk u kuptuam! — tha Agushi.

Gjoka priti t'i thoshte dhe një fjalë më tepër, por Agushi i ktheu kurrizin dhe shkoi te gropë për të marrë lopatën. Përreth u krijua një angështi.

— Rrezik me të mbetë karroca tanë jetën me rrötë përpjetë! — nxitoi e tha Gjoka,

Të tjerët u çlirën. Secili ndjeu erën t'i rrigh-

te fytyrën dhe u largua në punë të vet. Lora iu afrua Regës. Ajo ndrydhite gishterinjtë e dorës dhe, padashur, lëvizte fundin e brezit shumëngjyrësh, që sa kishte dalë nga pala e vet e derdhej paksa në anë të përparëses së qëndisur me ca ngjyra të ndezura, me forma katrorësh e figura të ndryshme gjeometrike. Linja e bardhë, thuajse deri në fund të këmbëve, i nxirrte në pah ngjyrat e përparëses, xhaketën blu dhe këpucët e zeza.

— Jo me të përpjekur, Gjokë! — i tha Lora.

Gjoka kishte mbetur përballë një vajze, që e vështronte ngultazi. Ai e ndjeu veten ngshtë. Rega kapuliti sytë e nuk foli. Gjoka mori lopatën dhe «vring e vring!», filloi të mbushte karrocën gjithë inat. Vringëllimi i asaj lopate Regës i ngjante si një kërcënim. Kur iku Gjoka, u thye heshtja dhe u duk sikur përsëri copërat e bisedave vërshuan në trase, pa u lidhur me njëratjetren.

— Fshije pak këtu! — tha Rega për pikën e ujit me baltë dhe ia bëri me shenjë.

Lora ndiqte lëvizjet e dorës së saj dhe fshinte atë vend, që ngjasonte si plagë e përtharë. Anës njollës një cullufe floku lozta me erën.

Bujari grumbullonte dheun pranë rrugëzës me dërrasa, ku kalonin karrocat. Në një çast ai drejtoi trupin, u mbështet në bishtin e lopatës dhe tha me zë të lartë, të dëgjonin dhe tëd tjerët: «Koka, shokë, koka! Do gërmuar si toka!» Nga gropat u ndje një zë i belbët dhe përplasja e vetme e një shuplakë. Regës iu duk sikur «praf!», e qëlloi dikush me pëllëmbë në surrat, kur Gjoka nuk ndodhej aty.

— Mos shit trimni ballë femnash, more djalë!

— tha ajo flakë e prush.

Lora la lopatën dhe shkoi e pushtoi Regën.

Dhe e puthi në faqe. Rega vështronte me sy shqerre:

— Dhe na kena jetën tonë, Lorë!

— Po, Regë, po!

Bujari mbeti si një meit.

Rega nuk foli. Ajo shtrëngonte dorën e Lores. Lora flokët i kishte të mbledhur me shallin e vullnetarit. Rega, me rizën e nuses. Bujari nuk dinte ç'të bënte, mori një gur dhe e hodhi kot, sa më larg. Lora pyeti Regën përse Gjoka nuk i linte të tjerët të punonin me të.

— Nuk e di! — tha Rega ciltër.

— A keni kohë të martuar? — pyeti Lora.

— Gjashtë muej, — tha Rega dhe ndjeu se diç i lëvizi në parzëm, një si therje a si gudulisje e mandej ky ngacmim sikur iu shpërnda dhe, sa vinte, po i zinte grykën. Para martese ata nuk njiheshin dhe tregimet e vajzave apo të nuseve për atë ditë a natë martese, tirreshin e ngatërrroheshin me copëra legjendash.

Na ishte një djalë... Hë! Kështu fillonte zakonisht çdo tregim a përrallë për të térhequr vëmendjen rrëth bëmave. Po këtu ngatërrrohej dhe e vërteta me trillin, tek ajo e nënqeshura e rrëfimtarit, që vajzave e nuseve u dukej sikur bashkonte të thënën me èndrrën. Ishin një djalë e një vajzë, që ruanin delet në bogë e prozhme pranë. Boga kishte lule, prozhmi kishte bar. Djalit i thoshin Ujkan, vajzës Brerina... Një ditë delet u përzien. Ujkani e Brerina lidhën besën. Uh, e marra besë! Donte Ujkani të rrinte përherë me të, ku bogat kishin lule e prozhmet kishin bar, por Brerina qe rritur dhe e mbanin në shtëpi... Dhe Rega qe rritur dhe donte që

dhe asaj t'i ngjitej në hatullat e shtëpisë një i ndërmendur e ta qëllonte që andej me guralec, si Ujkani që zgjoi Brerinën: «Tak-tak, ori!» Kuku! Guraleci do të godiste babën; do të çohej nëna e do të ndizte bishtukun dhe kërko e kërko, të ndërmendurin natën! Uh! Asaj do t'i rrihte zemra dhe nënës do t'i merrej fryma: kërko hutak e hutak nuk ka! I ndërmenduri do ta priste te molla, nën rrezen e hënës, si Ujkani... Pa nëna do t'i thoshte babës: «Ka qenë maca ndër hatulla.» Dhe ai do të shtrihej të flinte përsëri, si baba i Brerinës. Hi-hi! Brerinës i qeshi buza. Deri këtu Rega nuk e ndante veten nga Brerina. Mandej ngjarja rriddhe hijerëndë, e ngirirë si ca qirinj akulli, që vareshin nëpër shpella e shpesh i shtinin të ftohtët. Iku një dimër, erdhi një verë. I ndërmenduri prit e prit të molla. Brerina fshihu e fshihu ndër gjethë, të mos e shihte rrezja e hënës. Na ishte një djalë... kuku! Na i thanë me u martue. Ai nuk donte tjetër nuse, veç Brerinës, por asaj shtëpie na i kishte ngelur një borxh pa u larë dhe... Na ishte një vajzë, që, përpos Ujkinit, nuk donte tjetër, por asaj shtëpie seç i kishte mbetur një hak pa u marrë dhe... Erdhën ditë e rrodhën vite: «Paj nji borxh e paj nji hak!» Thanë se Ujkani do të martohej me një tjetër. Në rrjedhën e ngjarjeve nata e martesës merrte ngjyra të ndezura dhe dukej sikur secila vajzë gërmonte në kujtesën e vet në do të që heroina që do të flijonte për Brerinën, si ajo nusja e re. Thonë se natën e martesës ajo nuk deshi të rrinte me të. «A je e marrë, a?!» — i tha Ujkani. «Kur unë nusëroja, erdhi nji grue e plakun e më dha fshehtas nji mollë» — tha nusja. Ujkani

u drodh, pa mundur të nxirrte zë. Gruaja e plakur kishte dy rrudha: njëra i niste thuaise nga mesi i faqeve dhe i varej poshtë dhe tjetra në gjerësinë e ballit, mbi vetull. Për çudi ajo kishte sy të ndritshëm, që tregonin se nuk duhej të kishte qenë aq plakë, paçka se futa e vjetër i jepte pamjen e hijes në atë dasmë, ku një nuse nusëronte e përreth i këndonin vajza të reja. Hija rrëshqiti midis ngjyrave e i vajti nuses pranë. I preku stolitë me dorë të drithëruar dhe i pëshpëriti: «Të trashëgohesh, motë!» Nusja u drodh e nuk foli, se ishte nuse. Një grua e plakur me dy rrudhëza në faqe e një në ballë, preku me dorë të dridhtur stolitë e nuses dhe, mandej, dora rrëshqiti u fut në gjirin e vet e nxori një mollë. I la mollën e iku si hije. Nusja e mori dhe e futi në gji. «Më tha me e hangër bashkë, Ujkan. Merre thikën e preje!» — tha nusja e re, kur ishin vetëm. Nusja kapi thikën nga doreza e majë e saj u drejtua nga Ujkani. Atij i vetoi syri dhe, për një çast, i erdhi një mendim i marrë; do të donte ta merrte thikën dhe.... «Marrina!» — tha Ujkani, dredhoi e u nis drejt dyshekut. Nuses i mbeti thika në dorë. Maja e thikës qe zgjatur nga Ujkani. «Preje mollën, Ujkan, preje!» Ujkani mori thikën e për një çast të dyja duart e kapën dorezën e saj. Pastaj maja e thikës u duk sikur qe e drejtuar nga nusja. Ujkani e shtrëngonte dorezën fort, që të mos i shpëtonte. «Preje, Ujkan, se ma mirë me dyshekun veç e me nderin në shtëpinë e babës!» Ujkani do ta priste dhe, simbas zakonit, do ta hanin të dy: dhëndri do t'i jepte nuses gjysmën e vet dhe nusja...

Ujkani e preu mollën «prám!»

Molla nuk kishte zemër!

Nusja e hëngri mollën e nuk vuri re.

Ujkani nuk mundej ta kapërdinte. Atij i imbeti molla në grykë dhe u mbush me djersë. Mori thikën, doli jashtë dhe hukati e vikati. Kur vjen dimri, thonë se bëhet ujk e bredh nëpër bjeshkë, se ka një hak për të marrë. Kur vjen pranvera, thonë se bëhet përsëri Ujkan e bredh i marramendur ndër bahçe mollësh, se ka një borxh për të larë. Brerina thërrret e fshihet nëpër gjethë, të mos e shohë rreze e hënës dhe ai bredh e nuk e gjen! Bridh e bridh dhe thonë se, kur vjen dimri, bëhet prapë ujk.

Dhe kështu jetojnë në bjeshkë ata, Brerina dhe Ujkani, të ndarë.

— E pse me na nda, Lorë?! — nxitoi e tha Rega në një çast, sikur t'i ishte marrë fryma.

— Unë e hangra mollën me të!

— Çfarë, çfarë??

— Ashtu asht nji zakon: hangra mollën me burrin natën e martesës dhe e lidhëm besën.

Regës ai i dukej më i miri i shokëve dhe sa shkonte ajo e donte më shumë, paçka se nuk e shprehte në prani të të tjerëve. Po edhe Gjoka i kishte dhënë fjalën se nuk do të ndahej kurrë nga ajo, se edhe në hekurudhë ai kishte ardhur me dëshirën e saj.

— Kush tha se do t'ju ndajnë?! Po ai edhe këtu kërkon të të mbajë nën urdhër.

— Unë jam nusja e tij. Nuk ban me na e prishë dashninë, — tha Rega nën zë dhe, kur pa Gjokën tek vinte, u çua në këmbë e pëshpëriti: — Kuku! Marre me na ndie kush.

Lora ndjeu se Rega mbetej një nuse e trembur në sjelljen e vet dhe mundohej të tregonte dashurinë ndaj të shoqit. Gjoka erdhi, la karrocën dhe qëndroi një hop në këmbë, trupgjatë e

i drejtë, me ftyrë eshtake e krahë të fuqishëm, që i varesin poshtë, të rënduar nga barra e punës. Rega, tek e pa vetullngrysur, nuk i foli.

— U lodhe, Gjokë? — e grishi Lora në bisedë.

— Ma tepër mërzitem, — tha ai. Lorës ai zë iu duk si rrapiellima e bronztë e ndonjë statuje të përblysur. — Andej nga ne grueja çapitet mbas burrit, Lorë!... Unë erdha mbas grues, si Ujkani.

— Cili the?! Ujkani?! — pyeti Lora papritur. Ftyra eshtake u kthyte nga ajo dhe po e vështronë me ngulm:

— Po pra! Si Ujkani, që dimnit bahet ujk. Lora pa se atij bebëzat e syrit po i dridheshin si në ethe. Zëri i tij iu duk se doli me rröku-limë nga dy buzë të trashura. Rega, tek mbushte karrocën, mbeti në përgjim. «Çka do me ditë, pra?! — tha Gjoka, kur pa se Lora po heshtëte. — Në pranverë ai bahet prapë Ujkan.»

— Përse nuk e le Regën të punojë me shoqe, Gjokë?! — ngulmoi ajo.

Regës diç i lëvizi përsëri në parzëm dhe frymëmarrja iu bë më e shpeshtë. Gjokës po ia lëpinte era ftyrën, po ia merrte mendimet e po ia shpérndante nëpër fushë. Asaj iu duk sikur dhe hijen e trupit era po ia fshihte nga trualli e po ia zhdukte fare nga traseja.

— Edhe budallit i duken ma të bukura mendtë e veta, Lorë! — tha ai.

— Ti ke frikë për Regën! — tha ajo.

— Unë erdha me Regën.

— Druhesh se mos qesh dhe ajo, si qeshim e punojmë ne, me shokët tanë.

Gjoka pa vëngër: «Unë jam malësuer dhe malet kanë krye.» Gjoka u úl galic dhe mbështeti shpatullat te këmbëza e urës. Ai harroi se në

prani të grave nderi e lypte të qëndronte në këmbë, përballë tyre. Veten e ndiente të lodhur dhe férkoi kapakët e syve. Lora bëri të largohej për te shokët dhe e la të çlodhej me Regën. Gjoka mori një gur dhe «tak-tak!», qëlloi me të një tjetër gur më të madh. Rëga kundronte me sy shqerre dhe shkoi e iu ul pranë. Gjokën e kishte marrë malli për malet. Malet ishin të ashpra.... Dhe Regën e kishte marrë malli, por nuk ishte mërzitur si Gjoka. Fusha ishte e gjerë, deri atje ku hante syri. «Dhe përtëj asaj mjegulle,» — tha Gjoka. Regës iu duk sikur Gjoka foli me zë të humbur. Ai tha se e ndiente veten të lodhur. Rëga u përmend në çast dhe rrahu kapakët e syve. «Pse nuk do me të ndihmues, Gjokë?!» Gjoka qëlloi gurin me gur. Mbi çizmet e tij qe formuar një shtresë e hollë dhe e bardhë guri.

— Tillyjen faqe njerëzish dhe më merr lopatën, — tha ajo, kur nuk mori përgjigje.

— Në Rrugën e Malësisë asht ma ndryshe, — tha ai, tjetër për tjetër.

— Atje tanë bie borë, — i doli Rëga ndesh.

— Bone?!, — Gjoka heshti një çast dhe hodhi gurin. — Bie borë, por asht ma ngrohtë, — tha si me mëlef. Rëga puliti sytë. Gjoka u quai vërkthi dhe rrëmbeu karrocën. Rrota e karrocës kishte dalë nga dërrasa dhe ai rëndoi mbi dorezat e saj. Rrota u ngrit paksa lart dhe ai u mundua ta rrotullonte karrocën mbi dy këmbëzat. Pastaj u kujtua dhe gjithë peshën ia la njërsë këmbëz dhe rrota hipi në dërrasën e udhëzës. Peshën e asaj karroce Gjoka po e mbante mbi shpatulla dhe të qarën ia shëmbellente me zërin e gjelatonjve: «kërli-kurli», por ata ishin në qìll dhe ai shtynte karrocën në anë të trasesë. Mbi trase lopatat shpërndanin dhé, tokma-

kët rrïhnin me forcë dhe era lëpinte pluhurin e thatë. Era ia mori shaminë njërsë vajzë dhe ajo nxitoi ta kapte. Ca qeshën e këlthiten së koti me habi, kur ajo po ndiqte shaminë dhe e kapi pranë Gjokës, që ngjiste karrocën. Gjoka pa kalimthi vajzën me flokë të shpupurishur dhe nuk e njohu. Ajo largoi flokët dhe i tha ta ngjittin bashkë.

- A ti je, Dilë? — pyeti ai, vetiu.
— Po! — tha ajo dhe filloi të lidhte flokët.
— A do me të ndihmue?
— Jo, se e ngjis vetë! — tha ai dhe rrota e karrocës e shtoi kërkëllimën në atë të përpjetë.

Te gropë e gërmimit dilte ujë dhe në atë copëz vend nuk mund të punohej më gjatë nëpër baltë. Në një çast qëdo shaka mbeti e pakripë dhe vullnetarët morën një pamje ngurrimi kur panë atë pikë burimi, që ngjante si syri i turbullt i një kau të therur. Lora hoqi nga kryet shallin e vullnetarit dhe e hodhi në njërin krah. «Djalli e mori!» — tha Kujtimi dhe, siç që ulur galic me bërrylin mbështetur në kofshë, brofi në këmbë. Të tjerët panë nga ai, filluan të lëviznin nëpër gropë dhe, tek mundoheshin të hiqnin ujin më një anë, rrïhnin dheun. Dheu u bë llurbë. Lopatat e kishin të vështirë ta lëviznin nga vendi. Gurgullima e tyre përzuhej me llapaçitjen e çizmeve dhe ndihej sikur përsërisnin njëra-tjetrën: «Gërrill... dall! Daaall!» Diskush tha se Sokoli ishte gati të vinte në ndihmë. Kjo u duk një shaka e rëndë. Tri ditë më parë atë e kishin dërguar në një tjetër kompani, për t'iu shtruar punës. Tani ai ofronte ndihmë. Ata panë lajmëtarin. Mbi ballin e vullnetarëve

piklat e djersës përziheshin me cërkla balte. Lajmëtari e ndjeu veten ngushtë, u pre në fytyrë dhe mblodhi supet. Kujtimi lëvizi dorën, sikur ta kishte përpara fytyrën e Sokolit dhe deshi ta largonte:

— Në djall vaftë dhe ai! Shko edhe merr kovat, Lorë!

Lora u nis rrëmbyer.

— Dhe thirr ndonjë nga shoqet e trasesë për t'i zbrazur! — porositi Arianë.

Ajo kaloi pranë Bujarit, i hodhi një vështrim të rëndomtë dhe iu duk se ai belbëzoi fjalë pa kuqtim, që nuk ia dëgjoi qartë nga era apo nga një thirrmë, që u ndje nga argjinatura. Sokoli, sa erdhi, la karrocen boshe dhe shkoi anës gropës, ku pa ca vegla, ujin që buronte dhe vullnetarët që zhgërrydheshin në baltë.

— Duhet të jetë prerë ndonjë damar, Arian!

— tha me zë të lartë, sa të dëgjonin dhe të tjerët.

Arianë nuk foli. Vështroi nga poshtë dhe Sokoli iu duk më i dobët dhe më i hollë sa që në të vërtetë, pak më i kërrusur dhe me duar më të gjata. Copërat e bisedave përziheshin me llokocitjen e ujit dhe llapaçitjen e çizmeve në llurbë.

— Dëgjon ti?! Damar uji! — tha rishtazi Sokoli.

— Rri, o për kokën tënde, me gjithë damar! — ia ktheu Kujtimi me mllef.

— Kështu është toka këtu, Kujtim. Me damarë. Në muajin shkurt këtu, në hekurudhë, është punuar në ujë deri më gju. Dhe e di ç'i thonë të bjerë nga lart e të burojë nga poshtë?!

— tha Sokoli dhe sakal iu dreitua Bujarit: — Aaa, shprehie e bukur, Bujo! Dhe ti ndodhesh midis dy ujërash. Këtu i ka apo nuk i ka dy pëllëmbë ujë dhe këta...

Kujtimi doli nga gropat dhe i ofroi lopatën: «Futu brenda dhe jep zemër!» — tha ai. «Bu-jari besoj e ka mbushur karrocën,» — gjegji Sokoli. Bëri dy-tre hapa dhe u kthye përsëri. Paska qenë një Tajar, që çdo natë i binte gër-netës fort të dëgjonin shokët e turnit se flam-u-rin e kishin fituar përsëri ata të brigadës «Qemal Stafa»... Trimëri turnesh.

Ariani nuk duroi më dhe, ashtu siç qe, një të hedhur i bëri lopatës dhe e baltosi Sokolin ku mundi. Dhe ndodhi që balta e zuri me fjalë në gojë. Të tjerët qeshën. Sokoli pështyu baltë dhe shau Arianin; kapi karrocën dhe iku. Pas një copë rruge dëgjoi ta thërrisnin. Ai qëndroi dhe filloi të pastronte rrobat. Qe hutuar e nuk po mundej ta largonte mendjen për sa i ndodhi: «Nuk mjafton vetëm të kesh mend, se varet nga... pthu! Varet nga lloji i mendve. Nuk kanë turp...» Kujtimi nuk vonoi. I tha të qëndronte aty me shokët dhe rrëmbeu karrocën e iku aq shpejt, sa Sokoli nuk pati kohë të kërkonte shpjegim.

Te gropat e gërmimit vullnetarëve u rëndon-te lodhja mbi shpatulla, duart i ndienin si të këputura dhe përsëri grupi i vogël nuk deshi të largohej. Ai jetonte me shqetësimin e madh në do të arrinte t'i ngulnin pilotat dy ditë më parë nga koha e duhur.

Lopatat, të rënda plumb.

Dheu, i rëndë plumb.

— Këtyre as u merret vesh, Bujo! — tha Sokoli me të arritur. — Të degdisin pér edukim dhe pastaj të thérresin. Kjo nuk është serioze. Pthu! — pështyu ai.

Bujari qeshi:

— Kaq shumë baltë paske ngrënë, a derëzi?!

— Jo, po seç m'u bë zakon e dashkam të pështyj!

Vendi ngjante si një rrethore, ku secili kryente një detyrë. Më tej Gjoka mbushte karrocën e Rega pranë dukej e trembur. «Ja, këtu plekset tragjikja me komiken, Bujo,» — hodhi një romuz Sokoli për pantallonat e ngushta dhe pulpat e Lorës. Ai deshi të pështynte, por u kujtua se mund t'ia merrnin për ters dhe e përmbytjeti veten. «A të hëngri meraku, Sokol?! Na!... — tha Lora dhe sakaq shqepi këmbëzën e pantallonave dhe e përveshi mbi gju. — Kovën, vajza!» Të tjerët qeshën. Sokolit iu duk sikur i ngeci pështyma në grykë, një pështymë tërë baltë dhe u mundua ta përcillte. Rega qeshte nën zë, kur pa Tushën të griste edhe ajo këmbëzën e pantalonave dhe ta përvishte mbi gju. Regës iu duk sikur iu drodh zemra dhe ndjeu fërgëllimën e saj. Tusha vinte nga malet, shqyente këmbëzën e pantalonave dhe... hihihi, nxirrte pulpat jashtë! Ajo pa nga Gjoka. Gjokës i kishte ngecur lopata në dhë. Nuk e kishte mendjen ta ngrinte e ta hidhje në karrocë.

— A e sheh, Regë? — trembi Gjoka një mendim.

— E shoh, Gjokë, e shoh!

— Eja, Regë! — e ftoi Lora sa mori kovën.

— E ka nji punë Rega, — tha Gjoka dhe përplasi lopatën në anë të karrocës.

Gjoka hidh dhë. Rega hidh dhë.

Lora mbeti në pritje. Heshtja mbeti pezull.

— Ti nuk i njeh malet, Lorë! — tha Tusha.

— Unë njoh Regën, Tushë!

— Rega asht grue burri.

— Mandej?

— Mandej, ma urtë!

Lora ndjeu një të përqethur dhe Regën e

ngjasoi me një lëkurë portokalli, të rrjepur nga dora e një burri inatç i dhe të hedhur tej, ku do të thahej e do të kalbej. Ajo shtrëngoi fort vegjën e kovës, sikur donte ta përkulte midis gishtërinjve. Teli e vran. Ajo ndjeu t'i shkëputeshin bulëza djerse nga shtylla e kurrizit, si edhe të ftohtët e erës në fytyrë. «Grua burri, the?!» — pyeti Lora.

— E ç'duhet ma tepër? — tha Tusha. — Kur shkonte çika nuse, nana e porosiste se kanuni asht fé dhe burri asht kanù.

Teli i kovës midis gishtërinjve i thellói Lorës një vijë të verdhë, pa gjak.

— Nuk duhet më tepër, jo! — tha Lora dhe hodhi kovën.

Kova kërciti me rrapëllimë. Atyre u dukej sikur po u dhembnin eshtrat nga një ethe që u merrte frymën dhe ato do të donin ta flakin tej. Marta mori kovën e hedhur dhe shkoi e iu përkëdhel Lorës: «Po ti mos u vraj, o burrneshë! Ma mirë Tusha me zemër të dashtun, se dashakeqi me fjalën e ambël!» Ajo e puthi paksa me cepin e buzës, puqi faqen e vet me faqen e Lorës dhe ia ndjeu të ngrohtët.

Në trase u hap lajmi se (gjaja!) Gjoka u frikësua nga pulpat e Lorës dhe të Tushës, prandaj nuk po e linte të shoqen të nxirrte ujë me kova. Duket ndonjë qe më i shpejtë në trill nga Sokoli, i cili e kishte humbur mendjen duke parë Martën që po përvishte edhe ajo pantallonat.

«Dielli si një kalorës, po ecën dhe po shkon...»
Qe një këngë dhe Sokolit i qe bërë zakon t'i kujtohej kohë e pa kohë, qysh së vogli. Dhe

tani, tek merrte kovën dhe ia përcillte Bujarit, heshtte dhe e mendonte diellin si një kalorës. Në të vërtetë dielli po varej: në ditët e vjesh-tës ai dukej si më i zbehtë e më i lodhur dhe sikur shpejtonte të kridhej a të flinte në det. Edhe ky qe një përfytyrim fëmijërie për diellin dhe për kohën: deti, si një shtrat i madh, do ta përkundte diellin në dallgë e valë, derisa t'a vinte në gjumë.

— E humbe?! — i tha Bujari.

— Jo! — tha Sokoli dhe i dha kovën.

Kova kaloi dorë më dorë dhe, kur u derdh, llokoçitja e saj u përzie me bisedat e vajzave e të djemve për atë pikë burimi, që ngjante me syrin e kaut të therur. Kovat mbusheshin me ujë e llurbë. Vullnetarët fshihnin duart anës pantallonave, të mos u rrëshqaisnin bishtat e lopatave, tek shpeitonin të vërvisin dheun sa më larg. Pëllëmbët e duarve u ishin trashur dhe gishtat përkuleshin me vështirësi e nuk mblidheshin dot grusht. Lodhien ata e ndienin më tepër te kofshët, se detyroheshin të qëndronin gjysmë të përkulur kur ngrinin një lopatë dhë apo përcillnin një kovë me llurbë. Disave balta u kishte rënë edhe në kokë, edhe në shpatulla.

Dielli po shpejtonte në rrugën e vet. Kujtimi ngjiti shkallën dhe, pa dalë mirë nga gropë, porositi Arianin të shkonte te batipali, ku e priste usta Petroja me Fatosin. «Mos harro edhe ti, Gjokë. Dhe ti, Agush,» — tha ai. Pas pak shkundi këmbëzat e pantallonave e u largua pa i pritur. Gjoka nuk i ktheu fjalë. Nga gropë vinin zëra të turbullt vullnetarësh. Mbi breg hidheshin lopata me baltë dhe dilnin e zbraze-

shin kova me llurbë. Diku u ndje dhe një zë i largët. Lopata e Regës u përplas anës karrocës dhe Gjoka u kujtua se duhej të shkonte te batipali: «Kthehem shpejt,» — tha ai.

Rega shtrëngonte bishtin e drunjte të lopatës, ndiente zérat gazmorë, shihte kovat që kalonin dorë më dorë dhe kalamendej në mendtë e veta... Heu! Lora doli nga grëpa... kambët dhe pulpat e saj tanë baltë! Ajo asht e fundit që derdh kovën. Uji ka nisë rrjedhën, ai asht ujë i zi, me baltë... Dhe ai budalla, Sokoli, di vetëm me qeshë... heu!

— Eja na ndihmbo, Regë, se vonohemi! — e thirri Lora.

Gjoka ndjeu grishjen e Lörës dhe gjithë sy e veshë nga ku përgatitej batipali, vërente dhe druajtjen e Regës... Heu! Rega lëshoi bishtin e lopatës.

— Kontrollo friksionin, Gjokë! — i tërhoqi vëmendjen ustai.

Të tjerët vazhdonin tërheqjen e kavos dhe turra e saj mblidhej mbi arganello. Duart i ri dienih të lôdhura dhe u dukej sikur u lëviznin vëtiu, të paurdhëruara. Gjoka përgjonte me mendje te friksioni dhe kujdes tek ustai. Atij i dukej sikur Rega do të përvishte këmbëzat e pantallonave dhe i davariteshin zëra të ndryshëm, që herë-herë nuk i dallonte dhe herë-herë i dukeshin si të njohur. «Po ti banu pak burrashë, o gruel!» «Burri neshë jam boll, oj Martë.» Gjokës iu duk sikur e shoqja e përkëdheli. «Sadruhesh me ndejtë me shoqe, besa!» Gjoka përpëlitet në mendtë e veta: «Me pulpa jashtë, Tu shë!» — shtrëngon levën ai, vështrimvrerët. «Me pasë drojë, nuk kisha ardhë në udhë hekuri,»

— tha Rega. Gjoka e ndjeu krenarinë e saj dhe nuk deshi të përrallitej më gjatë, se dhe vetë ai nuk kishte ardhur në hekurudhë me drojë(!). Përpara tij kavoja përdridhej e mblidhej në arganello si një gjarpër. Lora e ftoi Regën të merrte kovën. Ajo e falënderoi dhe i tha se andej, nga anët e veta, kuvendin e bënte bajraku dhe bisedën, konaku. Mandej, gjithë sy e vetull, pyeti në tha ç'ka deshi dhe hodhi hapin drejt Lorës. Zëri i saj u ngatërrua me trillet e Sokolit dhe të qeshurën e vajzave: «Oj, nène! Pesë mina në këmbëzat e urës së vjetër, nga dyzet kilogramë secila. Litari i varkës u këput. Dy nga minatorët dolën me not, i treti...»

— Fiksionin, Gjokë! — thirri ustai.

Gjoka mblodhi mendjen.

Shpesët e egra ndillnin dimër.

Atëherë, kur ndodhi ajo plasje minash, që buzë marsi. Malet shkrinin dëborën dhe frynin lumenjtë. Kishte rënë dhe shi. Për ngjarjen e urës shkruan gazetat, u botuan fotografi e dikush shkroi dhe një tregim, por secili nga vullnetarët përpinqej ta shtjellonte ngjarjen sikur të kishte jetuar vetë edhe ankthin, edhe gjëzimin e asaj dite.

Atë menatë Artini tërroqi derën e barakës me kujdes që të mos kërciste, por përsëri mentesha e vjetër qau mbas tij. Ai ndjeu një të përqethur dhe pa nga Tomori, se andej iu duk sikur vinte të ftohtët me athëtimën e dëborës. U mblodh mirë me xhupin e pambuktë, futi duart ndër xhepa, e me dy bërrylat shtrëngoi pak ijet. Qielli qe i qelqëtë dhe Artinit seç iu kujtua një varg përiqillin blu. Ai pa yjet dhe në atë të përqethur iu duk sikur po dridheshin nga të ftohtët e po

shuheshin një e nga një. Agu po zbriste dalëngadalë mbi luginë. Qenë ditët e para të marsit dhe lulekaçja kishte dalë buzë lumi.

Inxhinier Artini ndjeu nga mbrapa të koliturën e Petro, një kollë e thatë, sa pér t'i tèrhequr vëmendjen e pér t'i treguar se edhe ai asaj nate kishte mbetur pagjumë.

— Eshtë e ftohtë era e lumi, inxhinier! — tha Petroja si iu afrua pranë.

Artini ktheu kokën dhe e përshtëndeti. Një fjollë tymi i pështillej te kreu i cigares mbi buzë. Ai lëvizte flegrat vetiu dhe picërronte paksasyrin e majtë, merrte frymë me gojë dhe përpinqej të largonte tymin.

— Si thua, «inxhinier»? — pyeti Artini si të niste rishtazi një bisedë të lënë përgjysmë dhe pështyu bishtin e cigares. Atëherë ai ndjeu se balli i qe ftohur dhe po i rëndonte mbi vetulla.

— Mirë e bëre! — i tha Petroja. — Ti e pi shumë cigaren.

— More, lëre cigaren se ashtu e ka ajo, pihet dhe hidhet, por si thua?

Artini nuk e përmendi fjalën «inxhinier», me gjithëse Petroja e plotësoi me mend se, sa herë që e dëgjonte atë nofkë, kuptonte që inxhinieri do të ishte në hall dhe do ta donte pranë. Kështu e bënte gjithmonë Artini: në mos merrte, bluante mendtë e veta.

— E çfarë inxhinieri jam unë, një copë tekniku! — tha Petroja pér të ngacmuar më tej bisedën.

Gryka e lumi sillte nga mali fërfërimën e erës dhe mërmërimën e ujit.

— Je djall me brirë ti, Petro, nuk je teknik. Ke pesëmbëdhjetë vjet që pi ujë lumi si ari-xhiu.

Petroja u kollit. Artini kishte kohë që kishte humbur diç nga mirësjellja e zyrtarit dhe kjo Petros i pëlqente. Artini ndezi cigaren dhe flakëza e shkrepëses futi në rrëthin e dritës pjesën e përparme të fytyrës me dy buzët e trasha.

— E ç'vjen vërdallë si i përhënti,¹⁾ — tha Petroja.

Inxhinieri qeshi. Shkrepësja u shua dhe fytyra i doli nga rrëthi i dritës;

— Dhe ti kujton se për një piç këmbëze ure do të rrija pa gjumë?

— Jo, thashë, se u çove menatë.

— Nuk e sheh?! Po shuhen yjet, por ti je budalla, — e afroi ai fytyrën e vet pranë fytyrës së Petros dhe iu duk sikur pëshpëriti, por bregu i lumit ia solli zërin të tingullt. — Kam qejf të të hedh në lumë, Petro! — dhe sakqa e mbërtheu për beli. — Dhe ti do të mbetesh, kurbani i parë në këtë urë!

Petroja mbeti një çast i hutuar nga kjo tekë e inxhinierit dhe e ndjeu veten ngushtë nën shtrëngimin e krahëve të tij.

— Artin!

Artini e lëshoi:

— Nesër do të hidhet ura në erë, por mund të ndodhë ajo që ti nuk e di: të mirën e madhe njeriu e pret dhe i ndodh dhe dy herë në jetë, por e keqja...

— Ti je i marrë, inxhinier! Ka ditë që kam vënë re. Sikur të mos kemi ndezur ndonjëherë mina!

— Kanë ardhur ushtarët për të na ndihmuar

1) njeriu që çohet natën dhe kryen veprime në gjendje gjumi

në punë xheniere, Petro! Dhe i pret nëna, ashlu si të tjerët... Prandaj dola sonte të shoh se mos është fryrë lumi dhe ti, djalli me brirë, më re pas. Apo kërciti dera e barakës e të nxori gjumin?

— Nuk kërciti dera, jo!

Atë menatë, kur shuheshin yjet, flladi i erës ua sillte zërin të tingullt. Dhe me këtë zë Artini do të jetonte sa të binte drita mbi luginen e lumenit midis kodrave e të fillonte rishtazi zhurma e zakonshme e makinave, që gjithmonë, sa merrnin kthesën tek ura, i binin borisë. Pastaj, në mëngjesin e vonshëm, do të dëgjoheshin lajmet e ditës dhe ata tre minatorë ushtarë do të mbeteshin heronjtë e hipur në një varkë.

Varka vëtëm ëta të mbante! Ata të tre kishin dale më këmishën e ushtarit, një këmishë pa jakë, më mëngë të përveshura, më kokë të qethur, më kilota në ngjyrë jeshile, më këpucë si opinga e të lehtësuar nga çdo cikerrimë ngjanin si peshkatarë të shkujdesur mëngjesëve të ngrohta, ndonëse ai mëngjes qe i frëskët. Rrjedhja e ujit qe llogaritur mirë që t'i conte te këmbëza e urës së vjetër.

Ja, përpara tyre, me njëren dorë të futur në xhep dhe cigaren varur anëbuze, i parruar, qëndronte Artini. Xhupin e kishte hequr dhe ishte më shaketë kafe të mbyllur. Petroja e pyeti në vajti ora. Artini shikoi orën e dorës. Ora shënonë nëntë e tre minuta, por zakonisht vonesa, të tillë, në ngutje nuk llogariten.

— Vajti, vajti! — tha Artini me cigare nëpër buzë.

Lundra me djemtë e rinj kishte hyrë në rrjedhën e lumenit dhe shkonte atje, ku do të vendoseshin minat.

— Kujdës, 'djemë! — thirri Petroja dhe

bëri hapa drejt bregut si për të qenë më afër tyre. — Kujdes se mos kaloni këmbëzën e nuk ktheheni dot nga rrjedha.

Duket zëri i tij nuk arriti te lundra, se ata vozisnin e prisnin rrjedhën, sa në njérën anë në tjetrën, pa e ndryshuar sjelljen e vet. Lundra ndiqte rrjedhën. Këmburat e prishura, si copashkëmbi të hedhura në lumë, mbeturina lufte, me ca kapërthime betoni e hekurash... Bot e bot ushtarët! Nga larg ata ngjanin të tre njëlloj e nuk dallonin: të tre kokat i kishin të qethura, të tre kishin përveshur mëngët e këmishës së bardhë pa jakë dhe të tre seç bënë e morën, në lundër e zbritën. Ky qe një çast qetësie për vullnetarët që kishin lënë punën dhe vështronin përreth, një kureshtje për shoferët që kalonin dhe një pamje me interes për kameramanët. Pastaj, merr e jep ushtarët ndër gjymtyrët e copëtuara të urës të kalojnë lundrën në të kundërtën e këmbëzës, drejt rrjedhës... Lundra po lëkundej në rrjedhën e lumiit e lidhur me litar dhe ushtarët kaluan secili, në një këmbëz ure. Ata kishin shenjat e veta. I pari që ngriti flamurin qe ushtari i varkës. Pas tij ngritën flamurë të kuq dhe dy të tjerë. Ushtari i varkës e luajti flamurin dy herë. Dhe ushtarët e tjerë e luajtën dy herë. Të tre ishin gati për t'u vënë zjarrin minave... «Trak-trak! Trak-trak!» — tro-kisnin minutat.

Erdhi një çast dhe pamja mori një tjetër ngjyrë e formoi një tjetër ankth. Litari i varkës u këput! Dy ushtarë arriten të hipnin në varkë, ndërsa i treti u ngatërrua në hekurat e vjetër. Kameramani filmoi dy njerëz në një varkë, që i rrëmbente rrjedha dhe ata të dy mundoheshin ta kthenin; një njeri që përpiquej të griste këmishën e ngatërruar në hekura të

vjetër të mbetur që nga koha e gjermanit; dy vullnetarë që u hodhën në ujë dhe mundo-heshin të përballonin me not rrëmbimin e ujit; një dorë tek kapte flokët e vet; një gojë vullnetari duke thirrur dhe shqetësimin e gjithë atyre që prisnin gjakngrirë të dëgjonin, nga koha në kohë, buçimën e minave kërcënuese.

Usta Pëtroja ishte nxirë edhe më tepër në fytyrë sesa ishte në të vërtetë e, në rrugë e sipër, u përplas me kameramänin, që dukej si më gjakftohti në atë ankth, tek shpejtonte të filmonte pamjen e një shoferi që ndalë makinën dhe, si mësoi kohën e plasjes së minave, vrapoi drejt urës e u hodh në lumë, ashtu si ishte me gjithë rroba.

Vëmendja e turmës kaloi te shoferi në rrjedhën e lumiut, ndonëse ushtari çapitej e luftonte për jetën e vet. Ata përpigeshin t'i jepnin zemër shpëtimtarit të panjohur, që u shkëput nga rruga dhe u hodh në lumë. Kameramani futi në fokus të aparatit një ushtar, dy vullnetarë, që i kishte rrëmbyer rrjedha, një varkë të përplasur në brëg dhe një këmbë ure nga ku pritej çasti të shpërthente mina e parë... Trak-trak-trak! Dukej sikur ndihej e trokitura e orës në tërë atë kohë të gjatë e të paduruar. Minutat kalonin të vrashda... hë! Shoferi mundi të shkëpuste ushtarin nga ato hekurishte të vjetra... hë! Ushtari notonte me lëvizje të ngathëta. Trak-trak-trak! Minutat trokisin me zhurmë.

— A dëgjoni?! A më dëgjoni?! — thërriste Petroja me hinkën që mbante në gojë — Ngrijeni dorën, në më dëgjoni! Ngrijeni dorën! — dhe, sa pa shoferin që ngriti dorën, u tërhoqi vëmendjen të mos kishin frikë. — Kujdes, djema! Ka edhe katër minutë kohë! Kur t'u them të zhyteni, zhytuni menjëherë dhe mundohuni

të mos dilni deri në plasje!... Kujdes, vazhdoni t'i largoheni sa më shumë këmbës së urës dhe kini mendjen tek unë!

Dhe ata filluan të notonin. Asnjë nuk e ndiente zhurmën e lumit dhe zërin e shokut që kishte pranë. Në mendje mbeteshin vetëm dy pamje: një shofer e një ushtar, që i largohe-shin rrezikut dhe një këmbë ure, e mbetur aty që nga koha e luftës, kur gjermani linte mbas vetes tërbimin e humbjes. Mbi ato gërmadha do të ngrihej ura e trenit. Inxhinier Artini vështronë orën dhe minutat, «trak-trak-trak!» Ai ngriti dorën përpjetë.

— Gati!... Kini mendjen, djema! — tha Petroja.

Turma mehu frymën.

Kameramani regjistroi dy njerëz me duar të hedhura krahaqafë, tek mundoheshin t'i qëndronin rrymës.

— Zhytu! — thirri inxhinieri më tërë fuqinë e vet dhe uli dorën e pas tij dhe Petroja.

Ata u zhytën. Turma u përkul, si për t'iu ruajtur ciflave të betonit, që mund të vinin deri aty, duke pritur ç'do të ndodhte më ata dy djemtë.

Plasja ndodhi. Kameramani filmoi dhe kokat e atyre të dyve, që i shkundnin mbi ujë. Turma duket u mësua me gjendjen, u çlirua nga ankthi dhe vetëm ndiqte urdhrat e inxhinierit, duke përfytyruar në ato plasje zhytjen dhe daljen e atyre dy njerëzve në lumë... «Trak-trak-trak!» Kaq se dhe njerëzit e ndien veten të fortë, kur ata të dy, shofer e ushtar, dolën në breg. Reporterët iu turrën ushtarit dhe shoferi gjeti rast e u largua pa u ndier, se, duket, kishte ende rrugë të gjatë e deshi t'u shmangej pyetjeve të pafundshme të gazetarëve. Në mendjen

e njerëzve ai mbeti si një rrugëtar i zakonshëm mbi timonin e një makine ku, herë pas here, për t'i ruajtur udhëtarët nga rreziku, tërhiqte vëmendjen me një bori.

Kjo ishte ngjarja e hershme. Në fillim trilli i **Sokolit** përshkoi si një puhizë në atë ankth që përbante vetë ngjarja dhe, mandej, erdhi një çast e të tjerët qeshën: «Minatorit i vajti mendja dhe «fup», nën ujë. Mina plasi. Minatori nxori kokën dhe buzëqeshi. Pikë.» E qeshura undje edhe tek ata që punonin te batipali.

— Ua prishi mendjen! — tha Kujtimi.

Zëri i tij mbeti i belbët. Gjoka përgjonte andej nga Rega qeshte me turp, dhe nuk ndiente më as të qarën e arganellos, kur rrëth saj mblidhej litari. Vullnetarët kishin përveshur mëngët dhe ndër llërët dukeshin damarët e tendosur dhe dejet e fryra nga gjaku.

— Friksionin, Gjokë! — tha Petroja.

Gjoka u përmend dhe luajti friksionin.

Arganelloja u fiksua.

Atyre u zienin pëllëmbët e duarve dhe u dukej sikur po ua pickonin mizat përdhese. Lëkura e pëllëmbëve u qe vrarë e trashur dhe ata hapnin e mblidhnin gishtat për t'i shpirë. Dielli qe varur dhe koha po ftohej.

Te gërmimi vullnetarët as qeshnin dhe as flisnin. Lopatat i ngrinin me një tendosje të përgjithshme të trupit dhe ato u dukeshin dy herë më të rënda. Edhe kur mbaroi gërmimi, askush nuk brohoriti. Vetëm një kovë u hodh pa kujdes, por dhe rrëpëllima e saj nuk tërroqi vëmendjen e currkujt. Ariani shau si plakat «Djallli e mori stihinë!», por edhe atë të sharë askush nuk e dëgjoi. Vullnetarët shpejtonin të pastroheshin nga balta. Gjoka gjeti rast të shkëputëj

nga shokët dhe i preu rrugën Lorës. Përpara tij ajo qëndronte me këmbëzat e pantallonave të shqepura, të përveshura mbi pulpa. Lorës vështrimi i tij iu duk i ethshëm.

— Hë, Gjokë?! A je lodhë? — e pyeti ajo me të folurën e tij.

— Lodhë e dobësue, besa! — nënqeshi Gjoka dhe nën mollëzat e faqeve iu dukën dy të prera, si të prera brisku, në ngjyrë të verdhë. — Sa edhe grueja nuk po ma ndien ma zanin.

Në një çast ata panë njëri-tjetrin dhe nuk folën. Lora uli sytë dhe, kur i ngriti përsëri, nuk ia pa më ato dy të prerëzat nën mollëzat e faqeve. Gjoksi i tij ngrihej përpjete dhe sikur zgjerohej në çdo frymëmarrje. «Ti shtiresh, Gjokë?!» — i tha ajo. «Po, shtirem!» — i tha ai me mllaf.

— Ne kemi ardhë me punue, Gjokë, — tha Tusha me të qeshur.

Gjoka hodhi një romuz për këmbëzat e pantalonave. Tusha kafshoi buzën, sikur duronte një dhimbje, dhe guxoi ta vështronë Gjokën ngultazi në sy. Të dy kishin sy të fortë dhe kjo angëshi do të vazhdonte shumë, po të mos qe afruar Marta e ta merrte Tushën për krahu:

— Eja, Tushë, me u la!

— Ke shitë burrni, Gjokë! — tha Tusha prishaqejf dhe u largua.

Gjoka mbeti si i goditur në fytyrë nga grushti i një gruaje.

Rega kundronte e nemitur burrin e inatosur. Ai ndiente të qeshurën e vajzave në largim dhe nuk dinte ku ta hidhte vështrimin.

II.

Qe e shtunë vjeshte. Gjethja fërgëllonte mbi krerëzit e degëve, shkëpütej, lëkundej e binte diku. Mbi mezhdën e kanalit, matanë xhadesë, kavakët përplasnin me njëri-tjetrin krahëzit dhe era e përzier e sillte zhurmën e tyre në trase.

Së shpejti do të fillonte ngulja e pilotave. Nata e së hënës do të mbetej një natë betoni: qyteza nuk do të flinte dhe secili asaj nate do të kalonte trasenë me ëndrrat, shqetësimet, dëshirat dhe mbresat. Trasenë e copëtonin trarë të drunjët. Mbi ta do të lidheshin shina të hekurta.

Vende-vende traseja ndërpriste Rrugën e Vdekjes, një rrugë këmbësore, që dikur kalonte buzë kënetës së Tërbufit. Thonë se një kalë i hazdisur i pati rënë përmes kënetës, por doli i ngordhur në breg, aq shumë ushunjëza i ishin mbledhur rrëth trupit dhe i kishin thithur gjakun, prandaj udhëtarët, kur shkonin nëpër kënetë, këmbët e kafshëve i mblidhnin me lecka. Këtu kurbetonin banorët e fushës në tre muajt e verës dhe korrnin kashtë për të mbuluar kassollet e tyre. Edhe ata i mblidhnin këmbët me kallca, si kafshëve e, sa ktheheshin nga Rrua e Vdekjes, sillnin me vete dhe ethet. Thonë për një burrë që, kur u kthyen nga rruga e kashtës, pyeti në shtëpi: «Të kujt janë këta gushtarakë¹), moj nënë?!» «Janë zogjtë e klloçkës, or bir! Kur ike ti, sa i çeli.» «Po këta kaçula?!» «Fëmijtë e tu, or bir! A nuk po i njeh?!» Fëmijët po i përkëdheleshin nëpër gjunjë. «Hej, kurbet, Tërbuf, të dhjefsha zotin ku e ke!» Ai kishte ethe dhe

1) zogj që çelin në muajin gusht.

nuk mbante mend ç'fiste. Kur vdiq, kënduan një këngë që njerëzit e qeverisë së asaj kohe deshën ta ndalonin, ndonëse ishte këngë e vjetër:

O Tërbuf, o kashtë e keqe,
Mbushur plot me mysybete,¹⁾
Do t'i qajë hallet me derte:
Me ushunjëza nëpër leqe.²⁾
Korra kashtë e mora ethe,
Mora varrinë me vete.

Thoshin se kënga kishte pasur dhe dy vargje të tjera, që njerëzit i sillnin ndër mend. Flitej dhe për një varr të madh që do të hapej, prandaj këngën e ndaluan.

Rrugës së Vdekjes gjatë verës kalonin turma gjarpérinjsh, që zbrisnin nga kodrat të zhuritur nga vapa për të pirë ujë me etje në kënetë. Më vonë ajo rrugë nuk u rrah më nga banorët e kësaj ane. Madje, tregojnë për një piktor se, kur hidhte mbi telajo pamjen e fundit të kënetës së tharë, Rrugën e Vdekjes e përfytyroi si një rrugë me gjarpérinj të ngordhur për ujë. Atëherë thanë dhe fjalë jo të mira për piktorin, se i kishte harruar njerëzit, por piktori kokëfortë nuk kishte pranuar dhe kishte shënuar nën tablo: «Ruga e Vdekjes, 1945». Dhe kështu mbeti ajo, një rrugë me gjarpérinj të ngordhur. Aty nga viti 1966 gjatë piketimit atë rrugë vendevënde e ndërpren traseja dhe vende-vende e mbuloi.

Rega shkoi pranë të shoqit. Linja e bardhë, e dalë mbi pantallona, ishte zhyer ca me baltë, por Gjoka as e vuri re. Atij i dukej sikur e

1) (turq.) e keqe e madhe

2) leqet e këmbëve

ndiente ende tē qeshurën e atyre vajzave. Rega ia ndjeu gazmendin dhe vuri dorën nē parzëm, se diç e gudulisi nē thellësi. Ajo kishte dëgjuar dhe fjalë dashurie nga Gjoka, por ndonjëherë ato i patën shëmbëllyer si zëra tē gërvish-tur. Ndofta ky përfytyrim i kishte mbetur ngaqë fjalët ishin pëshpëritur shpesh me një tingull tē luhatur: «Të duuuue, Regë!»

— Gatiti teshat. Nesër ke me ardhë me mue!

Regës i ngriu gjaku. Ajo e pyeti «ku?». Ai i tha «në malësi».

— Para shokësh?!

— Po!

— Nuk ban me u nda.

Gjokës iu duk Rega më e urtë dhe kyçet e nofullave nuk i lëvizën më. «Po me u nda burrit?!» — pyeti ai. «Po, Gjokë, ashtu asht!» — tha ajo zëbutë. Gjoka e ndjeu dobësinë e gruas.

— Atëherë?! — nguli këmbë ai.

— Gjokë, unë nuk kam me ardhë! — tha ajo aq e qetë, sa Gjoka nuk deshi tē besonte më nē ishte vërtet e urtë ajo grua. Atij mend iu zu fryma dhe vetiu kroi kraharorin me pëllëmbën e madhe tē dorës. Gjoka ndiente se diçka po ndodhët me tē dhe me Regën, sikur ajo po nxitonte dhe ai donte ta arrinte, ajo përsëri i shpëtonte nga duart dhe ai.... përsëri një pështjellim mjegulle dhe ai niste ta kërkonte përsëri atje ku kishte humbur nē turmë tē vajzave dhe nuk i dallonte më as tē qeshurën, as zërin, se i dukej sikur ajo qeshte dhe fliste me zërin e shoqeve.... dhe, ndonëse erdhi nē hekurudhë t'i tregonte botës se ai, Gjokë Çani, i biri i Çan Buçajt, e ka kuptuar jetën, ai përsëri çdo ditë e më tepër deshi tē qëndronte më pranë saj, duke e këshilluar tē mbetej e urtë dhe e sjellshme... se fusha ishte e gjerë

dhe se aty, vite më parë, ajo kishte qenë një kënetë dhe këneta ishte tharë.... se një rrugë, që ishte quajtur Rruja e Vdekjes, nuk ishte më dhe aty po ngrihej traseja me gjithë ata njerëz, që vraponin në turma, secili me një mendje më vete, që shqyenin këmbëzën e pantallonave dhe këngët e trimërisë i këndonin si këngë dashurie, me ca zëra djemsh e vajzash së bashku, që ngjanin si zëra hutash.... dhe iu duk e pabesueshme që Rega i foli aq e qetë se nuk do të shkonte mbas tij.

— Si the?!

— Nuk ban me u nda shokësh, Gjokë!

Gjoka luajti vendit. Në Hiraj do të thoshin se një nuse e re kishte dalë mendsh dhe nuk mblidhej as ditë, as natë. Ajo kishte qenë fjalëpaktë... Gjoka u çua vrik dhe e la Regën cungël në vend. As dinte nga shkonte dhe iu ngjit kodrës përpjetë e, përmes shkurreve, u largua aq sa nuk po ndiente më zë dhe qëndroi e u mbush me frymë. Që andej ai pa një pikë të zezë që mezi dallohej, tek lëvizte në thellësi të fushës.

Rega kishte një hundë pak të hequr dhe, tek buzëqeshte për të krijuar përshtypjen se ishte e qetë, sytë e saj formonin rrudhëza të lehta në të dy anët. Ajo i ndjeu ata hapa të rëndë të Gjokës që u larguan dhe u çua e shkoi pranë shoqeve. Tusha po tregonte se i fejuari e kishte ndalur në rrugë dhe i kishte thënë ta linte shtëpinë e babës e të shkontakte me të. «E më kapi për dore, budalli, me më marrë!» — qeshi ajo dhe sakaq u çua e shkundi pantalonat se i qenë bërë me dhé. Pas saj u çua Marta me Regën.

— E ti, Tushë, a thirre? — pyeti Marta dhe drejtoi trupin si për të mbledhur veten.

— Ç'me thirrë, moj?! I thashë se e kisha prishë fejesën dhe e lashë e ika.

Vullnetarët ishin shpérndarë në pika të ndryshme. I gjithë ky vend ngjante me gërmime për zbulimin e ndonjë qyteti të lashtë. Nëpër ato dredha udhësh kalonte dhe Kujtimi me usta Petron. «Ja, Rega!» — i tha ai ustait dhe në çast e kapi për krahu. Petroja vështroi vjedhurazi. Tek kundronte për Gjokën, me qafën pak të zgjatur, ajo ngjante me një shpend në përgjim. Era ngrinte pluhur. Një shtjellë kaloi përpara tyre dhe dredhoi jashtë anëve të trasesë. Ata të dy kalonin drejt batipalit. «Lora, dashur pa dashur, mbron qëndrimin e një fanaticu, usta! Thotë se nuk ka të keqe në rri Gjoka përherë me Regën. Apo harron ajo se...» Ustai dëgjonte copëra bisedash.

— Lora ka të drejtë! — tha ai, në një çast të papritur.

Kujtimi u gjend si i kapur në befasi:

— Aaaa, të lutem! A mos Lora kërkon t'i hapë rrugë vetes?

— Rrugë vetes?! — pyeti Petroja në mëdyshje. Çuditërisht Kujtimi, me atë bluzë vullnetari që i rrinte lirshëm në kraharorin e ngushtë, iu duk më trupvogël. Edhe hapat sikur i hidhte më të nxituar. Ajo fjalë, e thënë si me përcëmim për Lorën, Petros iu duk si një halë peshku që ngec në grykë.

Kujtimi iu shmang një përgjigjeje të drejt-përdrejtë.

— Epo djalli e mori, thuaj, usta! Djalli!... Djalli, — mbeti ai të gjente fjalën e duhur, për t'i dredhuar bisedës ku dhe u fut padashur.

— Prindërit na kanë dërguar të ndërtojmë vepren e të edukohemi në punë dhe jo në...

— Dashuri, — plotësoi Petroja.

— Po pra! Dhe në gjithë këtë që po ndodh qëndrimi ndaj Gjokës nuk mbetet më një qëndrim pér vete. Nuk e di, por të përkrahësh Gjokën, pér të shfajësuar veten?... Kjo është pér të qeshur.

Në trase era ngrinte pluhur. Dukej se koha do të prishej. Ustai picërroi sytë t'i ruhej pahut.

III

Aty, te batipali, Gjoka bën kuven me Gjokën: «Në kërshanaⁱ) jetojnë hijet e bjeshkëve që, ba' me i shkelë, ta thithin frymën e të lenë vdekun. Ja, kaq asht njeriu pér bjeshkët!... Tek rrëxohet ujëvara, thonë se, në ajri, kur del dielli, lahen floçkat me këmishë dhe e mbulojnë trupin me flokë të gjatë e s'i shef dot. Ba me i pa ato (s'ka gja se kanë këmishën), harron me folë pér tanë jetën. Ato lahen dhe në lumë, atje ku ka trofta, me ujë bore. Atëherë heqin këmishën dhe e fshehin në dhé në breglumë, mos me ia gjetë kush, se, ba me ia marrë, ato vijnë në shtëpi dhe bahan njerëz.... Lindin dhe fëmijë e flasin, si flasim na, shqip, por nuk thonë dot fjalët me «r» ... Rega, Ega! Kuku, druhesh me takue gruen tandem! As kanë dashtë ndonjëherë malet me u ba fusha. Ega, Rega! Fusha ka shtjella ere... Ega, Rega!» Gjokës iu duk sikur shtjellat e erës po ia merrnin frymën, drejtoi trupin dhe vetëm atëherë ndjeu se vërtet qe i lodhur, duke ndenjur vetëm, galiç, aty te

1) shumësi i kreshtës, në metatezë

batipali, ku shkarraviste me një copë shkop në shtresën e dërrasës ca viza të kota. Përreth nuk kishte njeri.

Në trase Genci shpejtonte të derdhëte karrocën e fundit. Dy të tjerë shtynin një vagon nga ata të minierave. Ca rrıhnin dhé me tokmak. Te Gjoka arrinin të qeshura dhe, në tërë atë gáz të papérmbajtur, ai ndjeu hidhërimin e shpotisë së Sokolit tek i vinte me ca zëra të shkëputur dhe ai tiposte në mendje ca fjalë të ngatërruara për shiun, për vajzat dhe gratë... për komandantin e brigadës së Tiranës që nuk kishte dashur t'i linte vajzat në punë dhe mu-shamatë e tyre ua kishte dhënë djemve. Vajzat u mblohdën dhe e nxorën komandantin e brigadës me mbeturina. «Kush është kundër gruas, është kundër emancipimit. Pikë.» Sokoli qeshi. Gjokës i vinin fjalët prerazi. Emancipimit. Pikë. Kundër gruas. Mandej gazi u shfry dhe çdo gjë ra në qetësi. Gjokës i dukej se dhe lumi ujëshumë këndeje rridhte hijerëndë dhe pa potere. Në male edhe rrjedha më ujepaktë qe më zhurmëmadhe e të grishte në lodra të marra, zevzeke. Atje ku laheshin floçkat, ujëvara davaritej si pëlhirë e trashë uji, shkulmohej e thërrmohej në stërkala dhe ngruhej në pah të freskët mje-gulle nën këmbët e Pllajës së Zogajve, ku çel-nin lule bore dhe thonë se Ujkani ruante delet.

Aty zbriti Marka Beci me dymbëdhjetë krushq, një krushkë dhe Regën nuse. Thonë se i ati i Marka Becit kishte vdekur, duke mbetur cung mbi fron, si të qe i gjallë midis gjindjes në kuvenç dhe kishte ngrirë si qiri. Kur vdiq, thonë, la hijën mbrapa dhe është e vështirë të shkelësh mbi hije të vdekurish, se ato ta marrin frymën dhe bëhen zëra bjeshke. Dhe Marka Beci nuk kishte shumë fjalë. Krahëzit

e mustaqeve të thinjura i jepnin një hije të rëndë burri. Rruga qe e gjatë, e lodhshme, rrugë e parrugë. Rega zbriti nuse nga Fusha e Lojës, që disa e quanin dhe Fusha e Erës, se atje frynte shumë erë. Të tjerë i thoshin dhe Fusha e Djallit për ashpërsinë e saj: një vënë midis malesh të egra, me shtrojë të gurtë, që nuk shihte veç dy-tre dynymë diell. Marka Beci me dymbëdhjetë krushq, një krushkë dhe Regën nuse, shkrehu pushkën. Ujëvara ia rufiti krismën e thatë dhe e nxori nga gryka e shkëmbit me rrapëllimë krismash. Në mendjen e Gjokës, aty te batipali, në atë krismë pushke u rrrokullisën dhe të tjera këngë e vargje të barinjve të atyre bjeshkëve: «*Heu, moj e mira në hije të blinit! Të qenka grisë këmisha...*» Gjoka mendonte he-shtazi e nuk deshi të thoshte fjalën «*prej gjinit*». Ai ndjeu angështi.

Petroja po afrohej i vetëm. Gjoka as u kujtua për praninë e tij. Petroja u kollit. Gjoka u përmend dhe ndali hapin. Petroja e pyeti se ç'po bënte. Ai i tha se po përrallitej.

— Përrallitesh?!

— Po, besa! Përrallitem në marrina, — tha Gjoka në të qeshur.

Petroja e pa me habi. E qeshura e Gjokës u shua ngadalë dhe ai nuk dinte ç'të bënte: priste fjalë dhe fjalë nuk kishte. Pa dy-tri herë me vështrim të shkëputur, por ustai përsëri nuk foli.

— Kam dhe unë marrinat e mia, usta! — tha ai. Ballin e ndjeu të rënduar.

— Edhe ime shoqe andej është, asaj ane, — tha Petroja, qetë, sikur të mos ndodhej fare në bisedën e tij. — Malësi.

Gjokës iu duk sikur i humbi mendimi;

— Ka le andej?

— Lerë dhe rritur... Ju jeni trima, — tha Petrojá.

Gjoka po e harronte rëndimin e ballit. Hetoi ustanë se mos bënte shaka në atë biscedë, të hedhur majë më majë, dhe i tha se trimëria nuk donte mend, donte zemër. «Do zemër, do!... Zemër dhe mend,» — tha Petroja. «Po, besa! Marria nuk ka mend,» — tha Gjoka dhe përtheu shkopin e deshi ta hidhte tej. Sakaq Petroja i tha se dhe ai qe trim.

— A do me u llafitë, usta?

— Çfarë?! — pyeti Petroja.

— Me bëllafe, — tha Gjoka.

— Je trim, se ke ardhur në aksion me gjithë gruan, — tha Petroja.

— Trimni e madhe, besa,... hë! — përfoli Gjoka veten. — Me u çapitë mbas grues.

Ai përdrohdi dy gjysmat e shkopit dërisa ato u shkëputën dhe i hodhi në dysheme. Dy copérat filluan të zhëridheshin.

— Po të doje, ti nuk kishe ardhur, prandaj je trim. Dhe bëre mirë. Po të vinte vetëm Rega, tundimi yt në malësi do të që më i madh.

— Po, besa!

— Rega me shoqe, them.

— Po!

— Dhe, besoj, këtu po e do dhe më tepër gruan.

Gjoka pa nga ustai dhe fjalën e tij e quajti burrëri. Mandej ustai e pyeti në e kishte larg fshatin e Shkurtës. «Nuk e di. Larg, thonë. Larg,» — tha Gjoka. Biseda dukej e shkëputur e nuk po lidhej në një fill. «E ke parë si e mban kazmën? — tha Petroja dhe po vetë iu përgjigj: — Lart. Dhe grushtin dhe kazmën. Dhe ti ashtu mbaje, lart!» — tha ai. Këtu e një vit më parë kishte ardhur në hekurudhë një djalë me sy

të hirtë. E thërrisin Sandër. Flokët i kishte të rënë, trupin mesatar. Qe skulptor, dhe deshi të bënte një bust me kazmë lart. Usta Petroja, qe guditur përsë e donte ashtu, se kazmat gërmimonin dhe nuk mbaheshin lart.

— Po, gërmojnë! — tha Gjoka.

— Dhe unë, ashtu i thashë, gërmojnë. Hë, kur të mbushet mendja, thuaj.... Është më e fortë nga çdo gjë/mendja, or mik! Ta bën dhe hatanë dhe kalanë. Të dyja: dhe hata dhe kala, prandaj...

Atij i shkëlqenin sytë, kur fliste për mendjen. Qe vjeshtë. Vjeshta lozta me ngjyrat. Andej nga kodrat puhiza përshkonte gjelbërimin e përhershëm të degëzave të ullirit. Gruri breronte në fushë e thua se ishte rritur ndonjë pëllëmbë. Petroja tregonte se skulptori flokë nuk kishte, por mend... Në fillim kishte skicuar pamjen e një vajze me ca viza të ngatërruara dhe niolla hijesh. Dhe me një kazmë të shtrënguar fort në ije. Duket nuk i kishte pëlqyer, kishte parë Petron në sy dhe kishte përplasur lapsin në tavolinë. Gjoka padashur hodhi sytë në dy copat e shkopit të këputura me forcë e të hedhura në dyshemenë e skelës. Mandej skulptori kishte marrë lapsin e kishte hequr përsëri viza. Përsëri Petros i qenë dukur të ngatërruara. Mandej skica kishte marrë formë: një fëmijë, i vogël ngrinte lart e lart një tufë lule, si drejt qellit. Dhe fëmija dukej sikur çohet lart, me lulet. Petroja heshtte, shihte dhe tundte kokën. Skulptori e kishte pyetur në i pëlqente. Petroja kishte mbledhur supet, se ajo mendja, e atypëratyshme e skulptorit nga kazma te lulet dhe ajo fëmija i vogël, që nuk ishte vullnetar, sikur e kishte hutuar dhe i ge dukur ca e ngatërruar. Skulptori i kishte dhënë të

drejtë dhe i kishte thënë se nuk mund ta përfytyronte dot. «Dhe kështu, éshtë, Gjokë! Po nuk qe i zoti ta marrësh me mend si do të jetë një gjë, nuk të duket mirë.... Ja, ti e theve shkopin, kur bisedoje për Regën.» «Po! Mandej?!» «Mandej?! Ma e madhe marria nga mendja, mandej!» «E pse?! Se due me ndejtë me gruen?!» — tha Gjoka. Përsëri frysëmarrja e tij qe më e shpeshtë. «Jo. Ajo éshtë trimëri, Gjokë. Të zemërohesh me gruan, éshtë marri.» Kapuç i hirit u shkëput nga kryet e cigares, ra poshtë dhe u shkërrmoq. Petroja e kishte harruar cigaren dhe iu desh ta thithë dy-tri herë e t'i shtypte pak kokën, pa të digjej:

— Unë e pashtë se po përpëlitez. Ai tha: «Kupton, Petro? Busti nuk duhet të shpjegohet. Ai duhet të flasë vetë». I thashë unë: «Eja të dalim!» Tha ai: «Ja, këtu kam ngecur!» I thashë unë: «Eja, pra, të dalim!» «E ku do të vemë?!» — tha ai. «Të pimë kafe në shtëpi. Të mbledhim mendjen dhe pastaj të gjejmë atë që do ti!» Kështu i thashë.

Petroja nuk deshi të fliste më.

Gjokës i dukej sikur ai herë fliste për vete dhe herë për të.

— Eja të ikim dhe ne, Gjokë. Të mbledhim mendjen më parë dhe mandej....

Gjoka heshti.

— Eja, pra! — tha Petroja dhe u nis.

Gjoka ngurroi një hop, mori dy copat e shkopit, i hodhi në rrjedhën e ujit dhe nxitoi të arrinte ustanë. Ustai bëri sikur nuk e pa. Mbi faqen e ujit, dy copat e shkopit herë puqeshin dhe herë ndaheshin. Gjoka dhe Petroja ecnin mbi shtresën e batipalit.

— Si thua, Gjokë? — pyeti Petroja. Fjala qe për gruan.

— Njeriu ka mend boll. Dhe pér tē mirë, dhe pér tē keq, — tha Gjoka.

— Unë e dua gruan time, — tha Petroja.

Gjoka pati dëgjuar se sherri vinte nga grua- ja, fëmija dhe dhia. Atë sherr ai po e mbante mbi shpinë... Në rrjedhën e ujit dy copat e drurit ngecën dhe nuk u panë më.

Në trase Rega kuvendon me Lorën: «Nuk kam me ardhë, i thashë, Lorë!» Ajo foli buzë- dridhur, shpërndante dheun dhe nuk deshi ta ngrinte trupin. Druhej se mos ia shihte Lora pikën e lotit. Bisedat e vullnetarëve vinin tē ngatërruara me zhurmën e punës. Rega shpër- ndante dheun, pa e pasur mendjen. Shtresa formohej diku e hollë, diku e trashë.

— Shumë mirë ke bërë! — dha zemër Lora.

Rega mblodhi mendjen dhe pa nga ajo, se iu duk si zë i huaj, i padëgjuar ndonjëherë deri asokohe. Ajo la lopatën dhe drejtoi kurmin. Lora ia pa syrin e përlotur tek i shkëlqente dhe ndjeu dhimbje. «Ti je budallaqe, Regë! — i tha ajo dhe e përqafoi. — Ne vetë do luf- tojmë pér jetën tonë.» Rega mbeti me pikën e lotit në sy. Pér herë tē parë ajo po i thoshte një shoqeje se nuk kishte vepruar sipas dë- shirës së burrit dhe, aty pér aty, iu duk se «emancipimi» na qenka kur gruaja nuk bën si thotë burri (!). Kjo nuk i pëlqeu dhe iu duk vetja si e kobuara¹), që braktis familjen dhe, tek e mendoi, ndjeu dhimbje koke e loti i rrëshqiti në trase.

— Druhem se ka me ikë, Lorë!

1) e rënë në gabim padashur

— Do të të çojmë ne, vajzat, në fshatin tênd.

Lora foli me rrëmbim. Regës iu duk si një zë i trembur nga ndonjë e papritur. Dhe mendimi iu duk i çuditshëm: ajo kishte shkuar me krushq në shtëpinë e Gjokës (dymbëdhjetë krushq dhe një krushkë), ndërsa tanë, e mbrojtur nga një tufë shoqesh, do të çelte derën në shtëpinë e burrit... heu! Po Marka Beci u shkëput nga Bjeshka e Hirtë e ra lajmës në Fushë të Djallit dhe kërkoi njérën vjazë për nuse, në njérën nga ato tri shtëpi, që ishin në afërsi të fushës, faqemali, përballë njëra-tjetrës... heu! Marka Beci me dymbëdhjetë krushq dhe një krushkë e solli në rrugë të parrugë dhe shpërndau haré dasme, kur gjindja këndonte bukurinë e saj dhe lutej të clodheshin në shtëpinë e tyre. Regës iu duk se edhe lopatat, tek shpërndanin dheun, nxirrnin ca tinguj, që ngjasonin me nisma këngësh të kënduara në dasmën e saj. Dhe seç e kapi një ngërç e përcollë përshtymën. Ato qenë këngë të marra, që i këndonin barinjtë, kur mbeteshin vetëm e vinin vërdallë nëpër bjeshkë. Ja, si shtjellat e erës në trase... heu, jetimzeza! Asaj iu duk sikur dhe ajo po mbetej jetime. La lopatën, drejtoi trupin dhe pa përreth me qafëzën ngritur si një shpend që përgjon vëmendshëm rrezikun:

— Me ikë Gjoka, the?!

— Po, Regë, po! Ne jemi kaq shumë vajza, sa do ta bindim dhe babën dhe nënën, dhe Çan Buçin dhe Gjokën se ti ke të drejtë.

Regës i dridhej e qeshura ndër buzë dhe pika e lotit i rrođhi në trase. Tek mbylli sytë, ajo ndjeu vetëm të rrahuarën e tokmakut dhe seç i vegoi me zë të thellë ai zëri i barinjve të vetëm në mal: «Jetimzeza, çka po lip...». Ajo

zbriti më Gjokën nga Bjeshka e Hirtë në qytezë
dhe, pas tri javësh, derdhë një lot në trase.
Atë lot nuk e vuri re kush: një gërmonte, një
sillte dhë, dheu shpërndajahej në trase dhe ngji-
shej më tokmak.... «Tok! Tok! Tok! Jetimzeza,
ç'ka po lip?!!»

Vullnetarët e kishin ballin të djersit.

IV

Gjatë rrugës për në qytezë, Gjoka ndjeu t'i
ngacmonte hundët era e peshkut të tiganisur.
Duket ndonjë amvisë gatuante peshk. Shushuri-
ma e kavakëvë, anës rrugës, përzihëj më zëra
harabeli: Një djale i vogël hodhi frenjën e rru-
shit dhe nisi të vraptonte pas një rröte të hekurt.
Ai e shtynte rrotën me një tel të kthyer në
majën e vet, ti formë të lakuar. Duket e ndiente
veten shofer, se përpinqej të ngjasonte zhurmën
e makinës... Ja edhe sheshi. Një grumbull shtë-
pizash, të lyera me gëlgere, me nga dy dritare
të vogla me perde të qëndisura. Një pullaz i zi,
me tjegulla si të myshkura. Në gardhin e obo-
rrit, rroba të ndera: këmishë të porsalara, të
linjta.... 'Gjeli matkuar'¹⁾ shkriftonte dheun me
çaponjtë, klluçiste me zë të trashë e ftonë pulat
për ushqim. Tri pallate hedhin hijen së larti
dhe ato, shtëpizat, duken si të trudhura nga të
ftohtët. Gjoka i ngjasoi me ca blaca nën kë-
mbët e lisave ku, dimrit, fshihen ferrakë dhe
«cicërhojnë» e tundin bishtin.

1) gjel i madh, i lënë për racë

Dimri ende nuk kishte ardhur. Drurët ende lozni me gjethet e verdha dhe vjeshta ngjante sikur hiqte qerpikët e vet e i lëshonte rrugës. Tri-katër dele kullosnin në mezhdë. Aty kishte bar. Dhe sheshi kishte bar; kishte dhe grumbull gurësh për themelet e hapura të një ndërtese. Aty qe ulur një plak, xha Stefani. Me dorezën e briskut rrihte lëkurën e një dege shelgu, të prerë anë e qark në dredha. Ai po i bënte të nipiit një hotë¹⁾). Gjoka i shihet vetëm lëvizjet. Herë-herë plaku ngrinte sytë për të parë në kullosnin ato tre bishtra delesh në mezhdë. Djali, çakërrsy, ndiqte lëvizjet e duarve të plakut tek zhvoshknin lëkurën e shelgut me kujdes të mos këpütej dhe sa s'fluturoi nga gëzimi, kur e pa të dilte si një rrip i gjatë e të përdridhej rrith vetes. Mandej xha Stefani e mblodhi lëkurën në formën e një borie dhe i vuri në krye një pipëz. Djali thua se ia rrëmbeu nga duart dhe filloj t'i binte me tërë bulçitë: «Ho-ho! Hoto-ho! Ho-ho!» Gjoka i gëzohej dhe fëmijës dhe gjyshit. Kjo e bëri edhe më të fortë trishtimin në shpirtin e tij.

Qe ditë me diell, qelli qe i kthjellët dhe i mërrmë. Në fund të horizontit kishte copëra resh të kuqërrrema. Gjoka qe ndarë me Petron dhe po kthehej në qytezë.

Mbas pune qyteza gjallërohej. Rrugët e saj ngjanin me rrugët e një panairi, ku njerëzit lëviznin në drejtime të ndryshme. Edhe atë pastite ca shkonin në dyqan, një nxitonte të arrinte shokët në shëtitje, të tjerë hynin e dilnin nëpër bujtina. Nga athëtima e mbrëmjes vajzave u skuqej lëkura e faqeve. Sokoli përpinqej t'i mbushë mendjen Bujarit për një krahasim letrar, të

1) lloj borie për fëmijë, lodër

gjetur me shije e bukuri: dy gërsheetat e vajzës zgjaten si dy shina të hekurta dhe koka e saj prin përpara si lokomotivë. Bujari gajasej. Sokoli ngazëllehej. Figura poetike do të qe dhe një mendim i madh për një skulptor: dy gërsheetat, koka. Diçka moderne e gdhendur në gur. Kujtimi paskësh thënë se figura qe idiote dhe autor i duhej vizituar nga trutë (!). Kjo e dëshpëronte Sokolin: «Më qafsh, Bujo! Kanë rrjedhur.... Ja, thuaj ti, bëhet kjo?! Dhe as duan të dinë për prirjet e reja të artit, Bujo! Dhe na paskan zgjedhur të këndoka një vajzë: *Duart me baltë, djalo, i kam, /Me pantallona veshur jam, /Në një çanak të dy do ham, /Ohohohahaha-haaa!*» Ai i stisi këto vargje për të zhdukur përfytyrimin e vërtetë të një këngë të dëgjuar ato ditë: kënga bënte fjalë për një dashuri të lindur në trase dhe ngjallte ndjenjën e kohës kur binte shi:

*Binte shi.
Shiu njante pikë loti.*

*Çapkënia dashuri vendosi të ngrejë fole:
Pëlhura i mungonte....
Unë, me çiltërsinë që më dhuruan njerëzit, e enda;
Në themel i vura burimin e dëlirësisë njerëzore...
Kështu e ngrita unë folenë dashurore,
Por këtë askush nuk e di,
Ndonëse fijëza mora nga çdo zemër.*

*Shiu binte pikë loti.
Lotë gazi në dashuri.*

Këto thoshte kënga. Sokoli përbehej për figurat e veta. Bujari i përsiati ato figura, të sho-

qëruara me ritmin e trenit në ecje: Ram-tam-pam! Ram... Sokolit po i ngjanin si krisma pushke 'në lodra fëmijësh, ku më shumë ndihej thirrja se e shtëna: Pam-pam! Atij i shkoi një e rrëqethur dhe iu duk sikur vërtet figurat e krijuara po jepnin shpirt në tërë atë gjallëri dhe zhurmë të qytezës që, mbas turneve, merrte një pamje të shëndetshme ku kapërthehesin mendime, sjellje, zakone, veshje e karaktere nga më të ndryshmet. Ja, Genci, kishte një karakter të veçantë dhe i pëlqente t'i mbante flokët si të lëpirë. Sokoli shkoi dorën në flokë. Genci i priste te shtylla e drunjtë, pranë portës së daljes. Kur vinin vullnetarë, roja hapte portën. Ai i dallonte nga shalli, nga veshja, nga sjellja dhe nuk ua kishte kohën përfjalë të tepërtë e paraqitje të stërholluara. «A u lodi?» — pyeste roja. «U lodi? ca,» — përgjigjej ndonjë. Kompania kalonte. Linte veglat në armaturë, lahej, çlodhej...

Në qytezë Gjoka hyri i vetëm.

Genci u largua nga shtylla e drunjtë dhe të tre, me Bujarin dhe Sokolin, u përzien në rrjedhën e të tjerëve, që kalonin në rrugë, anës lulishtes. Me ta u bashkua dhe Kujtimi me një tjetër djalë, pak zeshkan, që njérën dorë e mbante në xhep. Në rrugë kishte shumë vajza dhe djem. Gjoka pa dhe Lorën, por mandej se ku i humbi me Marianën. Mariana shkruante vjersha përdashurinë... Gjokës i vinin bisedat disi të largëta. Kujtimi tha se, po të mos e merrnin dhe atë radhë flamurin, do të mbeteshin me turp. «Tekniku është beratas,» — ia priti Sokoli. «Dhe pastaj?» — pyeti Genci. «Nuk i zihet besë,» — tha Sokoli. «E pse?» — pyeti Kujtimi. Sokoli u qudit: «Dhe kaq nuk e nuhat?» «Varet nga lloji i hundës, — gjegji Bujari. — Ç'ëre ndien hunda

jote, Sokol?!» Të tjerët qeshën. Sokoli seç tha një fjalë té papëlqyer nëpër dhëmbë. Gjoka nuk e ndjeu, por qeshi me zor dhe nisi të fërkonte gjoksin eshtak.

Në sheshin e rreshtimit buzëmbrëmja zbriti me një gajde. Dikush e nisi, kapi shokun përdore dhe u formua një varg vullnetarësh, që sillej rrëth gjadexhiut qerrata, se dhe ai filloi të kercente me të tjerët. Kishin ardhur dhe të moshuar për të parë bijtë e tyre e për të punuar disa ditë me ta.

Meloditë plekseshin me bisedat.

Gjadexhiu ngjante si një ari me bulci të fryra. Ca e rrëthuan dhe e kundronin, ca as deshën të dinin për bulçitë e tij e lozni me top në oborr. Në një qoshe të vetmuar diç bisedohej si heshtazi: «... dhe iku nga stoli.» «Ç'të bëjë e shkreta! Ka rënë në dashuriii, hihi!» «Pse qesh ti, çapaçul!» Rega tërhoqi të shoqin nga dora. Dhe ata po kalonin andej, nga ajo qoshe e vetmuar.

— Cfarë ka?! — tha Gjoka.

— Po flasin për Lorën. A po ndien?

— Për Lorën?! — pyeti Gjoka dhe përgjoi.

Ata të dy nuk ia përmendën më emrin Lorës dhe në çast u duk sikur iu krekosën njéri-tjetrit: «Dëgjon ti?! Kujt i thua çapaçul?» «Ty të them. Kalama, në ke ardhur këtu për të mbushur ujë, mbush ujë! Oj, vjen i biri i botës, nga anë e anës, t'u japë ujë vullnetarëve kur kanë etje dhe... Di të flasësh dhe ti për dashuri!» — shfryu ai gjithë inat dhe iku. Pas tij u përzje më turmën e vullnetarëve dhe tjetri.

— Ata nuk folën për Lorën, — tha Gjoka.

— Unë i ndjeva, folën për dashninë dhe ai çapaçuli qeshi, — tha Rega.

Gjoka u kthye e pa nga ikën ata të dy. Turma gjallonte në copëra bisedash dhe këngësh, në të qeshurën dhe këlthitjen e herëpas-hershme të gajdes. Të nesërmen do të digjej dhe Krishti. Turma sillte zhurmë.

— Nesër, më duket, do shfyttyrojnë Krishtin, — tha Gjoka.

— Si, me i marrë fytyrën?

— Nuk e di. Me ia prishë.

— Ashtu?... Unë pata ndie se në kishë të Laçit Zoja ka lëvizun sytë, — tha Rega. Asaj sikur iu zverdhën faqet.

— Patën thanë, po!

Në kishën e Laçit ndodhi lodra e mashtrimit. Qe viti 1949 dhe etërit e shenjtë bënin çmos të têrhiqnin besimtarët (legjenda e gungaçit qe vjetruar: e kishin prurë me tezgë dhe ai kishte ikur me këmbët e veta. Pati nga ata që e njo-hën dhe deshën ta rrihnin. Dhe i verbri, që kishte parë dritën e diellit, nuk qe dukur më.) Atëherë priftërinjtë te kryet e Zojës, mbi shtatore, nxorën kryet e Magdalënës. Thoshin se e quanin Marie dhe, që të mos e ngatërronin me Zojën, e thërrisin Magda. Thanë se kishte mëkatuar dhe kishte ardhur në kishë të Laçit të shlyente mëkatin (po kjo nuk qe e gjithë e vërteta: ndodhte që ati i shenjtë hynte në dhomën e saj, kur Magda zhvishte rrobat e veta dhe vishte të Zojës së Bekueme...) Mandej ngjitej ndër shkallë, futej në shtatore dhe nxirrte vetëm kryet e vet te kryet e Zojës. Dhe qëndronte pa lëvizur një.... dy.... tri sekonda, minuta. Dhe lëvizte sytë, vetëm sytë. Kështu e kë-shillonte prifti: të përballonte çdo tundim, për aq kohë sa do të ishte Zojë e Papërlyeme, atje

lart në shtatore. Nën këmbët e Magdës luteshin besimtarë. Turma lutej nën këmbët e saj. Ajo rrrotullonte sytë: diç kërkonte me sy. Prifti kujtoi se mos ajo donte të mëkatonte me djem. Po Magdës i rrodhën lot. Lutja e turmës u duk si një lebeti. Magdës i thanë të mos nxirrte më lot. Ditën e tretë ajo pa priftin dhe buzëqeshi. Magda i buzëqeshi priftit në një kohë kur një nënë i lutej Zojës për ndihmë: «Edhe unë jam nën si ti: im bir po vdes.» Nëna e pa nëpër lot se si ajo buzëqeshi. Dhe e njoju Marien, që kishte ikur nga shtëpia të shlyente mëkatin. Mëkat: turma ngucej e lutej për Magdën apo Marien. Zonja e Papëriyeme buzëqeshi, kur nëna lutej t'i shpëtonte të birin. I biri po i vdiste: ajo klithi nga tmerri, iku me vrap e tha se Maria ishte e përdalun... Qe një histori e shëmtuar. Priftërinjtë thanë se Zoja kishte lëvizur vetëm sytë.

Gjoka e dinte këtë histori dhe e kishte biseduar shumë herë me të shoqen. Ai e kapi për krahu.

— Si thue, Regë?

— Mundet të mos jetë e vërtetë, — tha Rega dhe iu afrua të shoqit më pranë.

— Në Laç, mundet... Nesër bahet gjama.

Petroja rrugës vetëm sa i kishte thënë se do të shkonin diku.

Në turmë ndihej e qeshura, kënga dhe zhurma. Dhe klithma e gajdes. Përpara bibliotekës Lora vazhdonte të lozte me majën e këpucës një gur të rrumbullakët. Ai kalonte me rroku-llimë sa në një vend në tjetrin. Gencit, aty pranë, nuk i erdhi mirë dhe deshi ta kapte atë djallo gur e ta flakte prapa diellit, të mos i gjendej më nam e nishan. Aq të rëndë e ndiente rrapëllimën e tij, sa i dukej sikur po i vërtitej në stomak. Po fol, të shkretën, e

mos u përdridh, se nuk bie në lak,» — tha ai. Lora vështroi prerazi. Në thellësi të syve i dalloheshin disa pika ngjyrë kafe. «Apo nuk të lë nëna?!» — nënqeshi Genci. Ai kishte dëgjuar të flitej me shaka për Lorën se nuk e linte e ëma të binte në dashuri. Njëherë ajo kishte ngjasuar dhe zërin e një gruaje të shqetësuar: «Hap sytë, bijo! I ke si njerëzit e shtëpisë.» Fjalët e Lorës u shtjelluan dhe midis shoqesh u ndien pësh-përima të fshehta. Njëra kishte thartuar buzët dhe na paskësh luajtur pëllëmbën pérpara hundës së vet: «Pfff! Sikur nuk e njohim!» Tusha shikohej në pasqyrë. Fryma ia kishte veshur faqezën e pasqyrës me një cipëz të hollë mje-gulle dhe s'e linte të shihte qartë gërshtetin, që i rrëshqiti nga dora dhe iu shthur vetiu: «Boll e mirë asht Lora!» — i kishte dalë krah ajo. Rega e kishte tërhequr nga mënga për t'i thënë të heshtte. Mandej se kush kishte thënë që Lora nuk dinte vend e kuvend e, prite ndonjë ditë, kur t'u priste dhe kokën, pa lëre më gërshtetat... Gencit i qe dukur e pakuptimtë ajo bisedë, trill apo e vërtetë, prandaj dhe pyeti në i druhej nënës. «Dhe lëre atë djallo gur!» — tha ai. Lora buzëqeshi dhe i ra gurit me majën e këpucës. Ajo deshi të dinte si e quante ai qëndrimin ndaj Gjokës.

— Gjoka?! E ç'punë ka Gjoka me ne?!

— Ka! — tha ajo.

— Si ka?! — pyeti ai.

Nuk kishte diell dhe drurët nuk dukeshin më në ngjyrën e vet: barakat qenë si më të zbehta dhe pllakat e etërnitit që mbulonin pullazet ngjanin me shtroja të përhime resh. Lora e ndiente se fliste së koti.

— Ai ka një grua, Genc! — tha prerazi.

— E di, e quajnë Regë.

— Dhe e do.

— Bën mirë që e do. Kjo nuk ka lidhje me ne.

— Ka! — nguli këmbë ajo.

— Hë, ka! — u tall ai.

Lora e ndjeu se Genci nuk deshi ta besonte më. Ajo e shihte tek tundte kryet dhe buzë-qeshte shtrembër. Dhe tha ai: «Ti nga Gurani e Gjoka... Gjoka nga shejtani!» — nuk mundi të kujtonte ai bjeshkën prej nga qe ulur Gjoka. Lorës ai zë iu duk i vrazhdë.

— Gjoka është i ndershëm, — tha ajo.

— E di që është i ndershëm. Po ti kërkon tek ai botën tënde?! Secili ka jetën e vet.

Ai mblođhi supet e ngriti pëllëmbët e duarve, pa e kuptuar gjithë atë shqetësim. E ç'qe nevoja për tërë ato fjalë të përziera e biseda të ngatërruara?! Lora deshi përsëri t'i shmangej: «Dëgjo, Genc!» Ai pyeti me kureshtje: «Ç'të dëgjoj?!» Ajo nisi të tregonte aq thjesht dhe aq natyrshëm, sa Genci e harroi Gjokën dhe po dëgjonte sikur Lora na paskësh marrë një letër nga dikushi, që e lëvdonte si të mirë, të bukur dhe të dashur.... Ajo kishte kundërshtuar dhe diali na paskësh thënë një fjalë të vrazhdë... hë! Mbeturinë në socializëm. Dhe kjo asaj i qenka dukur një politikë e trashë në dashuri.

Genci qeshi nën hundë:

— Bukur! Po tjetër?

— Tjetër?! — puliti sytë aio dhe sakal lar-goi një ble të shfrenuar flokësh, që gjithmonë i binte mbi ballë. Gencit iu kaplua mendia dhe iu duk sikur Lora i pëshpériste për dikë të panjohur dhe nuk e kuptoi në iu mbaruan fial-lët apo i përtypi. Sytë e saj qenë të gjallë, të thellë dhe plot guxim. Atij iu dukën të turbullt dhe, për një çast, mbeti i harruar kur e pa tek u largua duke e përhëndetur me dorë.

Ai i thirri nga pas. Gajdja nxori një klithmë që u ngatërrua me zërin e tij dhe nuk e la të dëgjohej. Pastaj u dëgjua një e qeshur e thatë. Zërat e vullnetarëve i vinin si të largët dhe njerëzit që i kalonin pranë i dukeshin si të njobur.

Kur hyri në bujtinë, Lora ndjeu zërat e vajzave që po përgatiteshin për mbrëmjen e vallëzimit. Tusha kishte veshur fustanin e sjeillë nga bjeshka dhe cullufen e flokut e kishte rregulluar në anë me një kapëse. «E, si po të dukem, Lorë?» — e pyeti ajo. Lora e puthi: «Bukuria vetë!» Tusha ndjeu ngazëllim, dhe harroi se ç'duhej të bënte tjetër... Lora veshi fundin me pala dhe trikon blu. Kur u pa në pasqyrëzën e saj, te kreu i krevatit, dalloi se qe dobësuar pak dhe fytyra paksa e ashpër sikur i qe mbuluar me një puhizë pluhuri që, sadotai lante, nuk do t'i hiqeji. Ajo preku fytyrën dhe ndjeu në lëkurëzën e saj ashpërsinë e gishtave. Qe gënjiyer nga ngjyra e grurit. Po edhe buzët iu dukën paksa, të ashpra dhe i lëpiu me njëratjetren.

— Po ti? — pyeti Rega. Ajo deshi të dinte si qëndronte puna me të.

— Asgjë! — tha Lora dhe filloi të rregullonte anët e flokëve. — M'u duk fytyra e dobët.

— Jo, të ka rrahë era e të ka prekë dielli. Dhe të duket sikur ke tjetër fytyrë, — iu largua Rega bisedës. Ajo ndreqi cullufen, pasqyrën e vogël e të rrumbullakët e la nën jastëk dhe doli nga bujtina me Martën. Marta i pëshpëriti se i kishte ardhur një kushëri i burrit dhe se ndiente frikë e i dridhej zemra.

— Kush të tha? — pyeti Rega.

— Tusha.

— Rri me mue.

— E mandej?

— Unë jam grue e martueme, — tha Rega.

Rega dhe Marta ishin nga fshati Hiraj: Rega nuse, Marta bijë. Rega kishte veshur xhamadanin dhe ai ia shtrëngonte gjoksin. Marta, jo! Ajo po dilte me rrobat e punës e do të humbte mes vullnetareve të tjera, që të mos e dallonte «ku-shërini sydalë». Ajo nuk e kishte parë kurrë dhe, për çudi, e mendonte fytyrëhequr, me sy të më-dhenj, me qepalla si gjuhë gjarpri dhe mustaqe si krahu i korbit, që pinte duhan me çibuk dhe, në kokë a në qafë mbante të lidhur një peshqir.

Në valle printe një gramshot, që as larë e as ndërruar, por ashtu siç kishte ardhur nga puna, që futur në të e po kërcente me çizme llastiku. Kërceu sa u lodhi dhe vendin ia la Martës. Ajo u mundua të shkëputej nga kreu i vargut e të shkonte mbas djalit gramshot, por Tusha ia shtrëngoi dorën më fort:

— Ec, Marta!

— Nuk mundem me pri!

— Ke me u mësue.

Marta u ngatërrua një çast dhe iu duk sikur faqet po i bulonin gjak. Gajdexhiu e vuri re dhe ia pruri avazin mbas këmbës, derisa ajo e mori veten dhe doli nga ai turbullim.

Në një çast zëri i gajdes u pre dhe, në atë melodi të këputur, vullnetarët u hutuan nga tringëllimi i çiftelisë. Pranë shogja-shoqes dy malësoret e ndienin veten të sigurt në atë lodër guximi, që hidhnin përpara tyre tre pukjanë, iballas, duke u përpjekur të vinin në dukje forcën dhe qëndrueshmërinë, kush e kush më qartë, më prerë, më bukur. Njëri në një çast e kapi Tushën për dore. Ajo që veshur më rrobën e bjeshkës dhe dukej si atë ditë kur zbriti në aksion. Për iballasit thonë se janë «të marrë», por

Tusha nuk ia hoqi dorën dhe e la të kërcente vallen e Iballës përpara saj.

— Tushë! — tha Marta dhe kafshoi buzën.

— Po, Marta! — tha Tushë flakë e borë.

Tusha zbriti nga Bjeshka e Kreit po me atë linjë të gjatë, jelek të ujgjelbër dhe opinga të thurura bukur, që përfundonin në dy qafa çorapesh. Nga ruba cullufet i dilnin anash. Ndër banorët e asaj ane, ajo kishte thurur përrallën e vet. Qeonjë fshat malor në Krojet e Fjetuna, që quhej Morena. Andej nuk kalonin makina. Kishte pyje, male, burime. Në këto male banorët luftonin e nxirrin bukë dhe nga guri. Që një vajzë në Morenë, që prindërit e fejuan që së vogli. Tusha as e mbante mend kur ishtë dhënë ajo fjälë e kur ishtë ngrënë ajo gosti. Dhe zakoni pastaj e mbështolli më pështamallin e vet. Djali, thonë, nuk ishte i keq, prandaj fejesa nuk kishte përsë të prishoj. Atë e njihte babai, e njihnin të afërmit dhe askush nuk ia dontë të keqen vajzës. Tusha e re jetonte me èndrrat e vashërisë, ndonëse nuk e kishte takuar të fejuarin dhe as e kishte parë. Thoshin se që të dy ishin të mirë për shokushokun... Ishte prilli i një viti më parë. Në Morenë bëhej fjälë për vullnetarë që do të shkonin në udhë të hekurt. Një darkë në shtëpinë e Tushës u shtrua një kuvend. «Po shkojnë vullnetarë», — tha Tusha. Baba nduku mustaqen, se ajo qe e tjetërkujt, e Pjetër Cakut. Tusha guxoi: «Ma parë e Partisë, babë!» Dhe fjala shkoi në vesh të Pjetrit. Ai ishte i ri. Dhe ajo ishte e re, më e re se ai. Ai dëgjoi se e fejuara e tij dontë të shkonte vullnetare. Prilli qeshi, Pjetri u vrenjt. Dhe, një ditë prej ditësh, ai ia behu në shtëpinë e Tushës. Babai tha «mirë se erdhe». Pjetri ishte i shqetësuar. Diç e bren-

te në shpirt, po të shkonte Tusha vullnetare. «Qofsh shëndoshë, Pjetër!», — tha babai i saj... Pjetër Caku rrudhi ballin dhe ia behu në rrugë: «Ma parë në shtëpinë teme; Tushë, mandej...» Dhe deshi ta kapte për dore. Frynte erë. Jo, qe vapë: ishte turp!

Kjo qe përralla e vet. Tani një iballas e kapi Tushën për dore dhe ajo e pa flakë e borë. Ndërkohë, aty pranë, diku u dëgjuat një fizarmonikë dhe një def. Dy evgjité, që banonin në afërsi të qytezës, kapërcyen gardhin e shkuar midis vullnetarëve. Vëmendja u përqendruat tek ata dhe vallja ndryshoi. Djemtë filluan të kërcenin në çifte, ashtu si ishin kthyer nga puna, tërë baltë. Vajzat vështronin me cep të syrit.

U ndje një bubullimë e largët. Si dukej ato shtjellat e paradites në trase do të sillnin shi. Iballasi, si mbaroi vallja, i tha Tushës me shakanë e padruajtur të atyre malësorëve, që hutojnë në lojë mysafirin e shtëpisë:

— A po vjen në Iballë, o Tusha e Krojeve të Fjetuna?

— Drue se ke nanën të egër; o iballas «i marrë! — qeshi Tusha, duke e parë me faqe të përskuqura nën cullufe.

Marta e tërhoqi dhe ato shpejtuan e dolën nga rrithi i valles.

Petroja pinte një lloj duhanji të vërdhë, duhan vendi, të grirë hollë me brisk. Duhani nuk që i fortë. Gjatë verës Petroja e nxirrtë në vërandë apo në pezul të dritares që ta zbutë

vesa. Dimrit e spërkaste me ujë. Edhe atë mën-gjes duhanin e grirë e nxori nga arkëza e dërrasës, ku e mbante dhe e përziente herë pas here, për ta rrahu rrahu ajri e drita.

— Dëgjo, nuse! — i tha së shoqes dhe shtriu duhanin në napë.

Elenës i pëlqente kur Petroja e thërriste «nuse». Kur mblidhte flokët topuz, dukej im-cake në fytyrë, si të qe shtatë vjeçë më e vogël. Pa edhe kur qeshte i mblidhte buzët paksa dhe anës syve i formoheshin ca rrudhëza të holla si fije floku. Dhe gishtat i kishte të hollë e të gjatë... Ajo u shtir sikur nuk e dëgjoi të shoqin. Petroja spërkati e përzjeu duhanin dhe përsëri i thirri «nuse». Ajo përsëri bëri sikur nuk dëgjoi. Djali ende nuk qe zgjuar dhe asaj po i pëlqente të luante me të shoqin. Petros i erdhi mirë:

— A do të vish me mua sot?

— Ku të vij?! — pyeti ajo.

— Të djegim Krishtin.

Elenës seç i kaloi një si fërgëllimë në zemër dhe, aty pér aty, sikur ndjeu frikë. Frika iu duk e çuditshme. Thanë se njëri, që kishte hedhur kazmën i pari pér të prishur tëqenë, na paskësh ngrirë. Elena e kuptonte se ai mund të kishte ngrirë nga frika, por ja që ajo ndonjëherë qenkësh aq e fortë. Petros Elena iu duk si me tjetër fytyrë, si e zbehtë e në ngjyrë të duhanit.

— Po.... Sikur qeveria nuk ngatërrohet me këto punë! — tha ajo nxituar.

— E pse nuk ngatërrohet?!

— Po.... Se Krishti nuk është i qeverisë, prandaj.

Zëri i saj qe më i tendosur, nuk qe më i këputur, si ato fijëzat e duhanit, që lidheshin me njëra-tjetrën e tirrnin topilthin në ajër. Petros iu bë qejfi që ajo po e merrte veten.

— Ti kujton se nuk e di qeveria?! — tha ai.

— Çfarë di qeveria?! — pyeti Elena dhe ndërkaq i shkoi nëpër mend se bëri një pyetje prej budallaqeje.

— Kurrikund në botë nuk veprohet pa qeverinë, Lena. Dhe atje ku mbrohet Krishti, dhe atje ku digjet. Dhe atje ku e vënë nëpër shkollë, dhe atje ku e heqin.

— Po, vërtet! — tha Elena dhe ndjeu se i kaloi një avull, që i mbështolli trupin, por në çast u fstillua: — Më parë ka qenë dhe mësimi i fesë.

Ajo kishte mbetur si e humbur dhe po mënjanton pjetën me ushqimin e djalit aq shumë sa po e derdhte. Petroja me kast e mori lugën e vogël dhe po hante në pjetë.

— Po ti, ç'bën ashtu?! — u përmend Elena.

— Domethënë qeveria...

— More, lëre qeverinë, por ti po ha ushqimin e djalit?!

— Epo, ç'të bëjë burrëziu, kur gruaja hutohet dhe nuk sjell mëngjesin?! — qeshi Petroja. — Domosdo do të ushqehet si bebet.

Elena ia donte këto të papritura e ndodhi, se e glodhnin. Ajo shpejtoi t'i sillte mëngjesin; përblooi me mendje shakanë e Petros dhe qeshi.

— E kujt t'i lutemi, the?! — pyeti si e nemitur dhe i shtroi të shoqit pjetën. Petroja vuri re se Elenës ende nuk i kishte ikur të zbehtët e fytyrës dhe zëri i saj iu duk i druajtur, sikur deshi të shprehte një pafajësi.

— Po unë nuk thashë gjë, Elenë! — u mundua ta qetësonte ai. Ajo e ndjeu se mendimet e veta po i ngatërronte me bisedat e të shoqit; mbylli e shtrëngoi sytë dhe pëllëmbët e duarve i vuri mbi faqe. «Më humbi mendja,» — tha ajo. Vështrimi i Petros që i ngrohtë. Elena në vegjeli

kishte mësuar dhe një lutje. Pati parë dhe një Krisht të kryqëzuar nën dritën e zbehtë të një kandili me vaj dhe në mendjen e saj tani luhatej ikona e nxirë, tërë zhul nga tymi i vajit të djegur. Nën pëllëmbët e duarve ajo ndjeu t'i digjeshin faqet. Pêtroja qeshi dhe ndërroi bisedë:

- Na gatuaj një drekë të shijshme sot, Elenë.
- Mish dashi, ë? — u këndell ajo!
- Mos harro tavën!

Elena buzëqeshi dhe bëri shenjë me kokë. Ajo e gatuante mirë mishin e dashit, në tavë me patate e gjethë dafine, ashtu si i pëlgente të shoqit. Tavën do ta linte pa larë, se Petroja vinte i lodhur dhe, më parë se të shtrohej buka, do të donte ta ngjyente kafshatën e tafshinte fundin e tavës.

Nga dhoma e fjetjes u dëgjua e qara e Klinonit.

— U zgjua djali, — tha Elena dhe nxitoi për tek ai.

Djali sikur ia hoqi me dorë fërgëllimën e zemrës dhë ajo u shtri pa kujdes mbi krevat, sipër shtresave ende të parregulluara. Po e shihte dhe e shihte të birin dhe as pati mendjen të mbulohej paksa, të mos e shikonte Petroja, se i qe ngritur pak fundi.

— Gugu-gu! Babi dò të shkojë të djegë Krishtin! Babin e kanë porositur si komunist... Uuu, për çfarë e kanë porositur?! Ai nuk më tha çfarë e kanë porositur si komunist... Uh, po! Të djegë Krishtin! Guuu! Kliti i mamit! Zoçka e mamit! Guguuu-gu!

Djali qeshte, gugatej dhe mundohej të kapte fytyrën e Elenës. «Sa budallaqë që jam!» — tha Elena, duke menduar shakanë e Petros. «Guguuu-gu! Babi do shkojë të djegë Krishtin!» Dalëngadalë Elena po qetësohej. Gjithmonë Krishti qe

përfytyruar i kryqëzuar dhe shëmbëlltyra e tij e mbërthyer me një kryq, me një fytyrë të verdhë. Të verdhë shenjtori. Të gjithë shenjtorët ashtu ishin, të verdhë e pa gjak, për të mësuar nga vuajtjet e tyre e për 'të qenë të 'duruar. Elena kishte dëgjuar se xhelati kishte pasur katër gozh-dë, për ta mbërthyer mirë, dhe në secilën këmbë, por njérën sekush ia kishte vjedhur. Atëherë xhelati qe detyruar t'ia mbërthente Krishtit të dyja këmbët me një gozhdë. Dhe kur i kishin thënë se ai që vodhi gozhdën qe nga Mirdita, asaj i erdhi për të qeshur. Prandaj kishin të drejtë mirditorët të vidhnin në kishë tri ditë në vit, se paskëshin shpëtuar Krishtin nga një gozhdë: «Feja, éshtë fé, padre! Hajnia, hajni!»

— O të keqen mami! Babi do ta djegë Krishtin! — nanuriste ajo të birin.

Babani e Elenës, Thaçasin, e mallkoi dhespoti.

Ai lindi tri goca: Martikën, Teutën dhe Elenën.

Elena u martua me Petron...

Ajo ditë qe dita e mallkimit të madh, se Tha-nasi kishte thënë që e trëta e barit, të mos i jepej më kishës: «Të mbjellën e rrit njeriu përvete, dhe barin zoti për kafshët! Zoti, mëshirë-ploti! Njerëzit kanë dhe gojë e mëkatojnë, por kafshët?! Kush rrëhi kafshën e pagojë, loka, thënë zoti, bën mëkat! Zoti e do kafshën e pagojë!» Të gjitha këto Elenës i vinin si një fërgëllimë erë. Një prift shkonte para dhe merrte, ujë Krishti nga një kusi e bakërt dhe e shpërndante më një tufëz borzilokù, duke pështyrë tri herë në njérën anë dhe tri herë në tjetrën. Dhe besimtarët pështynin nga tri herë: Pthu! Pthu! Pthu! Pastaj dhespoti kishte thënë ca fjalë të pakup-tuara që mbaronin me idhos dhe imenos. Që atëherë e éma, Donika, u bë fetare dhe i ushqeu vajzat me fé dhe thoshte se frika të ha edhe

burrin. Kur kujtoi se frika tē ha dhe burrin, Elena u drôdh e deshi tē humbiste mendjen me djalin, por dukej që djalit vetém sa i fliste: «Shhsht, Kliton! Bukurosh i mamit! Babi do ta djegë Krishtin!» E éma atéherë kishte qëndisur dhe një Krisht tē kryqëzuar me kokën varur si pér gjynah, me këmbët tē mbërthyera në një gozhdë. Ashtu i thanë dhe ashtu bëri pér tē larë mëkatin e burrit. Thanasi e kishte marrë Krishtin dhe e kishte hedhur jashtë. Donika e kishte futur përsëri brenda, pa e kishte fshehur tē mos e gjente njeri.

— Eh, nënëza, Kliti! E urta nënëzë!

Kliti po nxirrte nga goja kojen dhe ajo po mundohej t'ia jepte përsëri. Ajo jep dhe Kliti nxirr! Jep e nxirr, derisa djalit e fruqi kojen dhe spërkati t'ëmën. Elena filloj tē fshinte gjoksin e cirkëluar me ushqimin e djalit: «Do tē tē këpus buzën, dëgjon?!» — dhe me dy mollëzat e gishtave ia kapte dhe ia shtrëngonte buzët me përkëdheli.

Një ditë i ati i kishte thënë Martikës (këtë ai e kishte si djalë) sé prifti i manastirit tē Ardënicës kishte vjedhur Krishtin. Atéherë Elena që e vogël dhe i dukej çudi. Ajo dinte vetëm se ai kryqëzohej, vdiste dhe ngjalëj përsëri në ditën e tretë tē vdekjes, por tē vidhej e tē digjet manastiri.... Në manastir na ndodhej një Krisht prej floriri, i mbërthyer në nië kryq prej floriri. Qe një Krisht lakuriq, që vetëm pjesën e poshtme tē turpshme e kishte tē mbuluar. Dhe atë me rrrobë prej floriri.

Dhe kupa e kungimit që prej floriri:

Vodhën dhe kokën e shenjtit Kozma, sé edhe ajo që prej floriri. Dhe zoti, mëshirëploti! Dhespoti (të gjitha fialët që mbaronin me oti Elenës se si po i nxitnin nervat) mallkoi Thana-

sin për barin e kishës. Prifti, siç thoshin nën zë, e vodhi vetë Krishtin dhe tha: Antikrishtët... «Mallkuar ata që vodhën Krishtin dhe dogjën shtëpinë tënde, o zot! Mos paçin varr as shtëpi! Ju shterpëzoftë barku e mos lindshin më fëmijë! Amen! Ashtu qoftë!»

Mallkimi qe i madh.

— Gugu-gu e gugu-gu! Babi iku të djegë Krishtin!

Atë menatë, sapo këndoi gjeli i parë, papa Llazi u çua dhe, kur pa priftëreshën që dridhej nën linjën e bardhë, e pyeti në bënte të ftohtë. Ajo nuk iu përgjigj.

— C'qe kjo kështu?! — pyeti priftëresha.

Prifti gogësiu: «Ohooo! Shpëtona nga i ligu!» Prifti se si ndjeu një drithmë dhe kërciti dhëmbët. Priftëresha tha përsëri: «C'qe kjo që na gjeti, uratë?»

— Kërcasin dhëmbët nga të ftohtët, — tha ai dhe me njérën dorë kapi mjekrën e me tjetërën gërshetin e flokëve. — Do të na bien dhëmbët, grua!

Ai u mundua të kërciste rruazat e qafës dhe pastaj u shtriq, lëshoi prapa gërshetin e vëtëm të mbledhur topuz dhe i tha së shoqes t'i krihte flokët. Priftëresha mori krehrin e brirë dhe e vuri në gojë. Kështu e mbante krehrin ajo, sa herë që i plekste dhe i shplekste gërshetin priftit. Flokët e tij qenë të thinjur dhe mbli-dheshin shuk mbi krehër. Dhe mjekra e tij qe e thinjur dhe e dendur.

— Po ti, akoma gjallë je?! — i tha priftëresha.

— Eee! Gjallë jam, pse?! — tha ai dhe, aty

për aty, u kujtua se ku e pati fjalën kadëna, siç i thërriste së shoqes. — Na kanë thënë të qethim mjekrat.

Ai ktheu kokën përpara.

Ajo ia lidhi mirë gërshtetin dhe ia mblodhi topuz.

— As ke ç'e do mjekrën, po nuk qe prift! — tha ajo.

Papa Llazi mori krehrin dhe krehu mjekrën. Gjithmonë ai qe kujdesur për të dhe, më parë se ta krihte, e lagte me ujë. Dhe atë mëngjes ai fuste gishterinjtë në gotë e, si i ngjyente me ujë, fërkonte mjekrën. Prifti u ngrit e vuri kamillafin, mori shkopin dhe u nis për në kishë. Qe dita që po nisej më herët, se i kishin thënë të dorëzonte çelësat.

Rrugës së pazarit kishte lëvizje. Njerëzit shkonin si më parë, por priftit i dukej sikur atë e vështronin të gjithë dhe nuk e përshëndesnin. Ai, sa shihte, luante kokën. Dhe gjithë rruga ashtu i kaloi, derisa hyri në oborr të kishës. Në oborr nuk pa njeri. Duket ishte ende herët. Papa Llazi qëndroi pak, sa u mbush me frymë, se u lodh nga e përpjeta e rruqës, dhe pastaj hapi derën për të fundit herë. Dera kërciti me zhurmë. Ai e mylli mbas vetes dhe brenda atyre mureve, në tërë atë hapësirë të madhe që formonte salla me nafilet dhe ajodhimën, ndjeu shungëllimën e hapave të vet. Pa nga shenjtorët. Ata ishin të zverdhur, sikur vuanin nga pagjumësia. Asnjëherë nuk i qenë dukur shenjtorët aq të zbehtë sa atë ditë, apo këtë e ndjeu ngaqë kisha ishte bosh e vëmendja qe e përqendruar. Priftit iu bë, sikur ndiente zërin e vet në psallmën e fundit dhe i hyri një frikë se mos e dëgjonin. Papa Llazi pa anash. Shenjtorët e vështronin ftohtë e vetiu iu duk sikur shën

Maria i buzëqeshte. Papa Llazit i erdhi keq dhe shkoi në ajodhimë. Aty nxori nga një arkë petrohilin, e shpalosi dhe preku lehtë një kryq të vogël, të mbledhur me një copë leckë, të vjetruar. Kishte harruar se kishte dalë nga ajodhima dhe ndodhej te vendi i kungimit. Të gjithë shenjtorët i shikonte me fytyrë të verdhë dhe, për një çast, i shkoi mendja se të gjithë shenjtorët ishin të vdekur. Edhe Krishtit, paçka se u ngjall së vdekuri dhe shkoi drejt qillit e pritej të kthehej për të ndarë gjyqin e të pasurve me të varfrit mbi dhé, po ia digjin shëmbëlltyrën satanatë. Të gjithë... të gjithë ishin të vdekur! Prifti mori e ndezi fundin e një qiriri mbi shandan, ndjeu erën e dyllit të djegur dhe, përpara tij, flakëza e zbehtë e qiririt filloi të luhatej me ca rrathë të shprishur drite. Atij iu duk sikur figurat e shenjtorëve qenë pa formë dhe vinin duke u dridhur nga një humbëtirë. Prifti kapsalliti sytë e drodhi paksa kokën mbi qafë të mblidhë veten. Vetëm djalli, ai satani, nuk vdiste; atij se si i shkoi mendja se dhe ai qe shenjtor dhe u bë i pavdekshëm. «Pram!» i ranë priftit çelësat nga dora dhe tringëllima u përhap në të gjithë kishën: «O zot, o zot! — tha papa Llazi, duke kujtuar se mos i shpëtoi e ra kryqi i vogël. — Sesi po vdesim kështu!»

Krishti i kryqëzuar, nga lart, dukej sikur e përjetonte vdekjen dhe hidhite hijen e vet. Prifti vuri kryqin në xhepin e pantallonave dhe shpejt e shpejt vendosi në tavolinën, pranë derës së kungimit, kamillafin, temjanin dhe petrohilin. Tha prifti me vete: «Ende jemi gjallë, biri im!» Nuk e mori vesh kujt iu drejtua me fjalën «biri im», por duket ashtu i erdhi për mbarë. Në shtëpi urata jetonte me priftëreshën, me një

mace dhe një kone, që lehte gjithë ditën. E shkreta priftëreshë kishte ndodhur shterpë dhe, sado u mundua të lindte, nuk mundi. Papa Llazi e përsëriti fjalëzën lehtë, por përsëri ajo iu duk sikur i mbeti si psherëtimë shenjtorësh nëpër qoshet e skutat e ikonave: «Ende jemi gjallë, biri im!» — përmendi ai dhe u kujtua se po vinte koha të dorëzonte çelësat. Hapat e tij shungullonin nëpër kishë. Atij i bëhej një zë sikur duhej të vdisnin të dy dhe nga kryqi: «Nuk është ndonjë gjë e madhe të vdesësh. Fundja, edhe sikur të mos e mendosh, një ditë do të të gjejë...» Për të nuk kishte më rëndësi në jetonte dy vjet më shumë apo tre vjet më pak. Ai po mbetej jashtë kohe dhe nga shpirti, si në çaste të fundit, po i rridhët urrejtja e vrazhdë: «O zot! O zot! Se si po vdesim kështu! Edhe Stalini i egër nuk e dogji Krishtin! Po këta sikur nuk janë nga ata të gjallët e tu, që krijove ti, o zot, në ditën e gjashtë të arratisjes së botës!»

Prifti doli jashtë.

Litarët e kambanës qëndronin varur. Kishte ditë që kambanari nuk u qe afruar. Qe e diel, por papa Llazi nuk do ta falte më të kremlten, ndonëse pëshpériste: Ende jemi gjallë, biri im! Ende jemi gjallë... e mundohej të mos e çonte nëpër mend atë fjalë të paudhë: «afér vdekjes». Në oborr të kishës ai u afrua te litarët. Qenë dy litarë: një për kambanën e vogël dhe një për të madhen. Priftit, sa preku atë të kambanës së madhe, litari iu rëndua, gjuhëza goditi lehtë mbi kambanë dhe shungullimi atij iu duk qetësues e sikur me valëzim po i hynte në shpirt. Nga kambanorja fluturoi një lakuriqës. Papa Llazi tha me vete: «O zot, o zot! Kështu janë lakuriqësit! Kohën e tyre e kanë natën. Ai nuk mund të jetojë pa natë, o zot! Po na vdes

kohal!» Papa Llazi lëshoi litarët dhe shkoi andej nga preheshin të vdekurit. Kryqet ndër varre ishin të zbërdhylëta. Atij iu dukën të verdha, nga myshku mbi gurë. Ai mori dhe përplasi skeptrin mbi kryqin e varrit. Koka iu thye. Ai zgjati dorën, mblodhi copërat dhe u mundua t'i bashkonte, por nuk mundi: skeptrin e kishte sjellë me kokë nga një manastir i Aion Oresit¹⁾ dhe do ta dorëzonte pa kokë, bashkë me çelësat. Atje, në manastir, nuk kishte as varre, o zot! Kishte vetëm priftërinj, që përvuanin shpirtin e tyre, në lutjet e ditëve të shënuara... Amin! Ai po ndiente qetësinë e varreve dhe vetiu pëshpëriti: «Frika është më e fortë se arsyaja, biri im! Ata nuk i provojnë dot të mirat e zotit, prandaj duhet të mendojnë të ligat e ferrit. Tregoju besimtarëve tmerret e ferrit dhe ke për të parë se ata do të të besojnë.... Krisi.»²⁾ Qe një bisedë e hershme, me dhëspotin e manastirit të Ardënicës.

Të rintjtë e qytetit kishin nisur rrugën e po ngjisin bogët e vogël,iku qe ndërtuar kisha. Me ta kishte vullnetarë. Gjoka po kalonte më pas nga të tjerët dhe dëgjonte të bisedohej për kishat. Për prishjen e tyre qe folur shumë. Edhe kur preheshin nga lodhja e punës.

Fe. Politikë dhe fe.

«Feja është pleh,» — tha një.

«Jo, ore! Eshtë politikë,» — tha i dyti.

1) një ndër tre gadishujt e Selanikut ku, në Malin e Shenjtë, ndodhen dyzet manastire, të ndërtuara që në kohë të Kostandin Paleologut. Priftërinjtë që përgatiteshin në to, bënin jetë eremiti. Aty nuk lejohej të futej femra, për t'iu larguar tundimit shpirtëror, që mund të sillte ajo.

2) teolog

Gjoka ndiente sikur po i dridhej diçka e pa-kuptueshme në shpirt, që i dukej sikur kishte të bënte me mëkat.

«Pleh! Pleh! — u çor përsëri Gazmendi. — Është pleh. Një nga ata baballarët... nga ata shehlerët e tyrbeve, seç thirri në teqe ca nga ata besimtarët në një ditë fetare. I thirri veç e veç, burra dhe gra. Dhe i nxiti që të duronin tundimin, me dritë të shuar, kur të përziheshin me njëri-tjetrin. Burra dhe gra. Tundimin e djalit...»

Sa më shumë po i afroheshin kishës, aq më shumë Gjoka po e ndiente tundimin e mëkuar nga brezat.

— Fort po e rrën veten! — i tha Gjoka atij që tregonte.

— Pse?! — pyeti Gazmendi.

— Do të qe marrë vesh.

— Hël!... Ti as ke për ta marrë vesh!

— E ti?! — pyeti Gjoka.

— As unë! — tha Gazmendi. — Është sekret. Dhe kjo u zbulua rastësisht: në atë tundim një nga burrat kishte kafshuar...

Të tjerët qeshën. Gjokës iu duk si një rrëfenjë e çuditshme.

— Po, po! Nuk gënjej. Të nesërmen po ky njeri i pa së bijës shenjën e kafshimit në parzëm. Ajo u mundua ta mbulonte, por mbeti kur vuri re se të atit po i zmadhoheshin ninëzat e syve.

Gjithkush ndjeu dhimbje të brendshme dhe nuk guxonë e nuk mundej ta shpjegonte. Dhe as deshi ta besonte diçka që nuk qe njerëzore. Po Gëzmendi tha se ai burri u çmend. Në oborr të kishës prifti dukej shtrëg i zi, me dy duar të kryqëzuara përpara si në mort. Atij iu afruan pesë të rinj, ndër të cilët dy vull-

nëtarë. Papa Llazi, tek futi dorën në xhepin e rasës që të nxirrte çelësat, shtypi kryqin e vogël të mbështjellë me copë të zezë dhe ndjeu një therje në shpatullën e djaththë.

— Kujdes, more bir! — tha prifti.

I riu mori çelësat.

— Për çfarë të kem kujdes?! Se mos do të bjerë çatia e do të përbysjet në kokën time?!

Iliri kishte ftyrë eshtake, pak të hequr, flokë të butë që nuk i qëndronin e i binin paksa anash mbi ballin e gjerë dhe ai shpesh detyrohej t'i ngrinte me dorë. Papa Llazi e njoihu: i ati i Ilirit kishte qenë partizan.

— Jo, për vlerat thashë.

— Ti i re kambanës? — tha Iliri.

— Unë. Më shkoi dora për të fundit herë.

Besimtarët panë se prifti nuk bëri fjalë. Pastaj ndodhi ajo që ndodhi. Iliri përdrohhi çelësin dhe e hapi derën e rendë, duke e shtyrë me forcë. Të rinjtë hynë brenda. Ikonat shihnin me sy të ftohtë.

Trok-trok-trok! Papa Llazi zbriti rrugëzën e oborrit të kishës dhe që atë ditë, thonë, ai nuk doli më nga shtëpia.

Kisha që ngritur në bogë. Përpara dyerve qëndronin dhe besimtarë dhe kureshtarë. Kur hapën derën, Stefan, Jorgji iu duk, sikur i ranë me shqelm. Ai bëri kryqin dhe tha: «O zot! Ne hynim me kokë e dilnim me shpresë! Këta hyjnë me bythë...»

— Ha-ha-ha! Nuk ka zot, xhaxho!

— Kal! — tha Stefan Jorgji dhe një cirkë jarge i shpëtoi e iu var mbi buzë. — Ka, more bir, ka!

Stefan Jorgji që i shtyrë në moshë, por mbahej drejt dhe vijëzat e vrazhda në ftyrë e mustaqet e bardha përanësh e tregonin të ashpër.

Aty përreth u mblozhën të tjerë dhe po vështronin. Plaku ndjeu se po i rëndej fryma. Brenda nga kisha vinte uturima e përbysjeve. Gjoka ndiente shungullimën e kishës, ku seç thyhej, seç rrëzohej, seç përplasej pa kujdes e përzihet me zëra e urdhra të rinjsh. Ai pa se Stefan Jorgji turfullonte dhe i dridheshin qeskëzat e syrit:

— Ka, more, ka! Dhe zot ka! Dhe djall ka!

Turma e të rinjve qëndronte si në the. Përballë Stefan Jorgjit qëndronte djali që qeshi e tha se nuk ka zot. Ai kishte një fytyrë të lëpirë. Ata vështronin njëri-tjetrin si të provonin cili që më i fortë.

— Zoti po vdes! Ha-ha-ha! — qeshi djali.

— Zoti po vdes!

Stefan Jorgji i ndjeu shpatullat të rënduara. Tre-katër besimtarë po afroheshin ngadalë të vrenjtur. (Rreth kishës kishte varre: Selvi dhe varre, që miklonin mendimin e prehjes së përjetshme. Aty kishte vdekje. Të lindurit, sa sillëshin, i pagëzonin dhe pastaj çdo gjë harrohej. Thua jse dhe vetëjeta humbëllonte dhe kisha mëkonte madhërinë e amshimit njerëzor.) Petroja hapi turmën, e përfshiu atë djali përzverku dhe e shtyu tej, me tërë forcën e krahut.

— Ta marr shpirtin; — e kërcënoi Petroja.

Djalit iu rropullitën këmbët marramenthi dhe përsëri u kthyë e qëndroi përballë Petros. Fytyra e tij dukej e pagjak, si fytyrë meiti. Vetiu të pesë vullnetarët erdhën dhe iu afrouan ustait. Petroja pa Sokolin pranë vetes dhe i buzëqeshi.

— Usta! — i tha Sokoli dhe i shtrëngoi dorën.

Petroja pa dhe të tjerët. Dhe fytyrat e tyre qenë të zbehta dhe atij iu duk sikur ata merrnin frymë e nuk ngopeshin, apo mundoheshin

të dihasnin lehtë. Gjoka qëndronte buzëvarur me vëmendje të djali, që nuk tha as emrin dhe nuk u mor vesh kush që. Djali bëri përparrë. Gjoka shkoi dhe e kapi për krahun: «E çka don ti?! Me u rrahë me ustani?» Djali ia shkëputi krahun dhe iu hakërrua: «Nuk kam punë me ty!»

— Kam unë me ty, — tha Petroja.

— Lajmëroni policinë! — sekush tha aty pranë.

— Nuk është punë qeverie kjo, vëlla! — tha një tjetër, dhe iu drejtua Petros në mbrojtje të shokut. — E, di, ç'do të thotë revolucion? Nuk përgjigjet njeri për kohët tuaja.

— Përgjigjem unë, — tha Petroja.

— Cili je ti?!

Petroja nuk thoshte dot se që komunist. Komunisti Petro, që kishte lënë gruan me fëmijë në shtëpi, më porosi që t'i ruante të rintjtë nga paudhësitë, erdhi këtu midis tyre dhe u ngatërrua.

— Vullnetar! — tha Petroja.

— Komunist! — tha Sbkoli.

Petroja e përkëdheli me vështrim.

— Allah, o Krisht! — u tall ai që tha se revolucioni nuk përgjigjet përkohët e pëleqve.

— Komunist që mbron fenë?!

Petros i vetëtiu njëri sy, por u mundua dhë e përbajti veten. Tjetri tha: «Lutju zotit të të zhdukë paragjykimet!» Kjo që një shaka e rendë. Petros i hipi gjaku në kokë dhe, papritur, e mbërtheu në të dy anët e xhaketës... Dhe më pas as, që e vuri re nga e quan atë djalë. «Qen e bir geni! — tha Petroja. — Me këta do të merret qeveria! Maskarenjtë!» Njerëzit përreth mbetën si të hutuar: një komunist shtynte e grindej më një që shante fenë(!). Gjo-

kës i shkoi një e rrëqethur në rrënjet e flokut dhe frymëmarrja iu zbeh. O zot! Një aty pranë tha për Petron se duhej të ishte i Sigurimit, por nuk e jepte veten. Gjoka shihte Petron se i dridhej buza. Dhe ndjeu se dhe atij vetë po i dridhej buza: «Edhe kuvendi, që asht kuvend, nuk e ka një mendje, por këtu... Dhe lodra, që asht lodër, nuk do të shtjellohej kaq shpejt: do dhe ajo kohën me u luejtë.»

— Kush i solli ata këtu?! — pyeti Petroja dhe ende po i dridhej buza.

— Nuk janë tanët, — tha Gazmëndi. Ai qe ngarkuar për të ruajtur objektet me vlerë arti, të zgjedhura më parë nga specialistë. — Morën vesh se do të shembet kisha dhe... Kaq të drejtë e kanë ata. Dhe çdo njeri.

— Aq, po! Për më tepër...

— Për më tepër, le të përgjigjet vetë, — tha përsëri Gazmëndi. — Seç nuhasin ndonjë kërmë dhe kujtojnë ata se, po të dinë ndonjë të vërtetë....

— Maskarenjtë! Kërkojnë t'i japid ngjyrë vandalësh lëvizjes.

Stefani ndolli hundët dhe me cepin e shamilë hedhur anëqafe fshiu sytë e përlotur nga era. Petroja i afroi kutinë e duhanit. Stefan Jorgji ia mori kutinë dhe i dha uratën. Petroja ia miratoi urimin vëtëm me një vështrim.

— Ma zbardhe faqen mua, që nuk kam veçse tri ditë jetë! — tha Stefan Jorgji, kur e pa se Petroja nuk i ktheu përgjigje.

— Do të kesh' më shumë e do të gëzohesh, — i erdhi krah Sokoli. — Ai që foli që vërdallahanës.

Stefan Jorgji e pa në i kishte fjalë mendjeje,

se thoshin që rinia nuk përmbahej ato ditë
dhe shkaterronte çdo gjë që gjente pérpara.
Sokoli u 'afrua dhe më, për të qenë më afër
bisedës. Stefani u ngroh e tha së ashtu do të
qe më mirë dhe ai do të donte të vdiste me
zofin, por ku të linte «biri i gjarprit»! Ai
ndolli hundët dhe pyeti Petron në qe komunist.
Petroja luajti kokën. Stefan Jorgji e kuptoi dhë
ia kthëu kutinë e duhanit:

— Më paç uratën! Nuk e mendoja që në ple-
qerinë time... — ai lagu anën e letrës së ciga-
res, ia kafshoi paksat me dhëmbë dhe e pësh-
tyu. — Unë e di që ti nuk kë zot.

Petroja i buzëqeshi.

— Më dhe cigare dhe nuk po më flet?! —
tha plaku dhe qeskëzat e syrit po i lëvižnin.

Gjokës iu duk sikur diç i lëvizi në anë të
ballit.

— Po ç'të flas?! — mbloodi supet Petroja.

— Të them se nuk ka zot, do të grindeshim
kot si me atë djalin. Po edhe me babanë... —

hapi pëllëmbët anash Petrója dhe priti paksat.
— E kush grindet me babanë?! Apo kush mund
të rrihet, desha të them!

Plaku hodhi një vështrim të atillë, që thoshte
se qenkësh djale i zgjuar dhe ditkësh ku
ta vënëkësh vetë në rrezik.

— Tani ik në shtëpi, së nuk është mirë! —
tha Petroja.

— Çfarë nuk është mirë?!

— Të shohësh se ç'do të bëhet!

Stefani nuk i ktheu përgjigje, ndonëse e men-
ndoi se ç'mund të bëhej.

— Do të mërzitesh shumë, — tha Petroja
përsëri dhe u cua në këmbë e pa andej nga ki-
sha, nga u ndien të vinin zëra.

Stefan Jorgji mori të zbriste të përpjetën

dhe hapat po i dukeshin të rëndë: «Dëgjo ti, more! Se nuk ta di as emrin..., komunist!» — thirri ai pa kthyer kokën. Petroja qëndroi dhe e përshtëndeti:

— Mirupafshim, xha Stefan!

— Eja nga shtëpia!

Petroja luajti dorën ta falënderonte. Dera e kishës u hap dhe prej andej dolën tre veta. Gjoka pa Bujarin që mbante në krah kryqin e drunjtë me Krishtin e mbërthyer dhe po e çohin drejt zjarrit, që digjej në shesh.... Ai u trondit kur Krishti ra dhe për një çast i mbylli sytë: «O zot, si u lëpi, e u përpj nga flakët kryqi me Krishtin e kryqëzuar dhe si digjej e kërciste në zjarr! Qe dru i thatë dhe duket boja e djegur sillte erën si të plehut të kalbur.

— E, Gjokë?! — i tha Petroja.

Gjoka e pa.

— E vështirë, por megjithatë u arrit, — tha Petroja.

Gjoka nuk iu përgjigj dhe seç pati një të geshur të vraparë. Ai qe zbehur apo ashtu iu duk Petros.

— Eja sonte andej nga unë, Gjokë!

— Kemi mbramje, — tha Gjoka,

— Ndonjë ditë tjetër. Merre dhe Regën.

Gjokës dalëngadalë po i vinte fytyra. Ai e ndiente se po ftillohej dhe Petrojë nuk iu duk aq i rëndë.

— Me pritë ti tanë vullnetarët.... khë! — tha Gjoka ndër hundë.

— Po, në mos kemi raki, fjalën e mirë do ta gjejmë.

Gjoka e ndjeu se Petroja po e ftonte me gjithë zemër.

Rrugës bëhej fjalë.

Fjalë. Fjalë. Fjalë.

Fjalë për politikë dhe fe. Sokoli tha një vjershë: ky qe dhe qëllimi i ardhjes së tij, të bënte një vjershë:

U ngrit një mëngjes, zoti Krisht

Dhe pa se bota nuk kishte bisht!

Tha bota: «Ç'është zoti Krisht?!»

Një koqe cjac, mjekërpulish...

— I ngatërrove, more hajvan! — tha Bujari dhe ia krisi një të qeshuri, të papërbajtur.

— Po ato të ngatërruara kanë qenë prej vitesh!

— Mjekërcjac; thuaj.

Sokoli përsërithi fjalën e vet. Dhe, në donte të dinte Bujari, kështu ngatërroheshin fjalët në vargjet moderne, ndryshe nuk kishin vlerë. «Vlerë dhe... Pikë. Ti ma prishei frymëzimin,»

— tha ai. Gazi i të tjerëve kishte mbetur si në ankth. Gjoka mendonte se si Sokoli mjekrën e Krishtit... të atij, cjiaptime... Ai trembi mendimin, se e pa që e ngatërroi më keq. Mbas tyre usta Petroja mendohej si do të përgjigjej përvatë që ndodhi, nëse do ta thërrisin ndokund: «Po, si komunist! Si komunist!» — tha me vete dhe mandej ngriti zërin: «Çuna, kemi punë. Lufta është e gjatë, ne kemi punë edhe me veten!» Ata morën rrugën për nga qyteza. Nga lart zërat e ushpesëve sa vinte e fashifeshin: Petroja ngriti sytë nga qielli.

Vjeshta qe e vonët dhe shirat ende nuk kishin filluar mbarë.

Gjatë atij muaji ngjarjet po zhvilloheshin aq vrullshëm, sa ata e kishin harruar qetësinë dhe, kur të largoheshin nga qyteza, do t'u dukej vetja e shurdhët. Fletërrufetë shprehnin mendime nga më të ndryshmet. Në njërën, një frazë e fundit qe shkruar me bojë të kuqe, duket nga ndonjë gaztor apo për të tërhequr vëmendjen: «Ju lumtë, shokë! Ne ju pamë në qytetë me turinjtë gjithë baltë!» Qe një fletë lavdërimi për kompaninë e Lorës. Përbajtja e saj kishte të bënte me transportimin e shinave në një ditë shiu. Ditët e shiut bëllnetarët i mbanin më shumë mend.

Qielli derdhë shi.

Balta ngjiste.

Cizmet e llastikut rrëshqisnin.

Edhe në karrocë dhë më tepër në truse.

«Edhe këta që kércejnë, do t'i kenë pasur turinjtë me baltë! — mendoi e buzëqeshi Gjoka me vete. Rrotullimin e çifteve në këtë mbrëmje vallëzimi ai po e kundronte më me qetësi. Atij nuk i kujtohej se kush hyri atë ditë në fjetore dhe tha se mbi urën, te rruga kryesore, duheshin shtruar patjetër shinat për t'u lidhur traseja e treni i punës të kalone lirisht për zhavorrumin e saj, deri në thellësi, në afërsi të Kordës së Buallit... Përpara Gjokës dilnin vijëzimet e valles dhe atij i dukej sikur ngjishej baltë: një, dy, tre! Nën ritmin e muzikës me përcjelljen e një të qeshure të vazhdueshme, këmbë që zhyten në baltë, kapërtthime duarsh në kërcim dhe darësh, tek ngrenë shinat dymbë-

dhjetëkuinalëshe: një, dy, tre! Jepi! Balta e Myzeqesë është baltë e rrahir dhe duhet të kesh kujdes, se rrëshqet.

Marta diç çuçuriti. Rega pa Tushën dhe vërtet iu duk sikur ajo po dridhej në duart e Bujarit: një, dy, tre! Dora e Tushës qe e brishtë, me një lëkurë të butë, me gishta të hollë, të gjatë e të pastër, që përpëlitez në pëllëmbën e Bujarit, si zemra e një zogthi. Tusha dhe fytyrën dhe duart i lante me sapun erëmirë. Ajo e vinte atë edhe në valixhe. Dhe rrobat mbanin 'erë të mirë sapuni. Ajo do ta çonte sapunin edhe në shtëpi. «Po Marta a di të kërcejë?» — e pyeti Bujari për t'i hequr druajtjen. «Ajo asht e fejueme,» — tha Tusha dhe fshehu vështrimin. — Punë e madhe dhe në është e fejuar! — tha ai.

— Nuk asht mirë me hedhë valle larg tij. Ka ardhun dhe një i kushërini i të fejuemit...

Tusha nuk dridhej më.

Muzika binte dhe Gjokës i ngatërhohej me të qeshurën e Sokolit. Dhe shputat do t'i duke shin të rënda në atë kërcim doradorë e dorabel, se ai donte dëlirësinë e valles, ku të ndiente si i dridhej maja e këmbës në të njëjtën kohë me supin e pushkës.... Prandaj e kishte më të lehtë edhe të mendonte se shinat ishin të rënda-e mund t'i shtynin rrëshqitazi nëpër baltë: një, dy, tre!

Shiu binte «vuuu!»,

Tetëmbëdhjetë vullnetarë.

Duhej të ngrinin tetëmbëdhjetë kuinalë hekur.

«Dara ime nuk punon dhe rrëshqet si djalli!»

«Hidhe tej!»

Binte shi. Duar tē forta malësori kapën shina tē lagura, tē hekurta dhe, kur hodhi këmbën, i njau se mori me vete një copë tokë: «Një, dy, tre!» Hopaaa...»

Një, dy, tre! Po kërcen Sokoli. Sokoli dhe Bujari janë shokë tē mirë. Në ritmin e asaj muzike Gjoka ndien dhe rrapullimën e një treni, shinat e tē cilit ai i mban në duar me dy këmbë tē ngulura në tokë, që tē mos rrëshqasë. Bujari erdhi dhe i tha Martës tē kërcenin. Gjoka lëvizzi vendit. Marta i ra pas e druajtur, se nuk dinte tē kërcente. Ai i kapi dorën: një, dy, tre!

— Po dal e po marr pak ajër, — i tha Gjoka Regës.

— Nuk ban, Gjokë!

Gjoka heshti. Mandej u ndje një zë i belbët që thirri Martën. Marta shtangù, pa thënë «tre». Regës iu duk sikur Gjoka hukati më zë tē thellë. Një burrë u shkëput nga radha e vullnetarëve dhe i bëri tē tjerët tē ndaleshin. Malësori iu afria. Ai ishte thatim, por jo i rrreshkur. Dhe sytë nuk i kishte tē dalë, as edhe qepallat si gjuhë gjarpri, ashtu si e kishte përfytyruar Marta. Kishte sy tē thellë me vështrim therës. Bujari e pyeti se cili që. Ai tha së ishte i kushërir. Sokoli u vajti pranë. Rega kafshoi dorën dhe i shpjegoi tē shoqit se ishte i kushërir i tē fejuarit. Gjoka u çua.

— Pse thërret? — tha Sokoli (dhe ky mbeti i vetmi çast trimërie që ai tregoi në aksion).

— Kisha punë me Martën.

— Ne sikur jemi parë sot në mëngjes, — tha Sokoli.

Malësori vetëm kundroi. Atë mëngjes, kur hyri në oborr tē qytezës, ai nuk pa lëvizje.

Vullnetarët ishin nisur me kohë në punë dhe ata të paktë që kishin mbetur, ende bënин pastrimin. Thatuku (kështu i mbeti nofka, se nuk ia dinin emrin) pa disa vajza që lanin fytyrë, gushë e parzëm. Atij iu duk sikur e goditën me gurë në ballë dhe ktheu rrugën i hutuar. Sokoli u mënjanua të mos përplasej me të. Ai e pyeti në e njihet Martën, të zbritur nga Hiraj. Sokoli ia lavdëroi dhe i tregoi vendin e punës: «Dil nga dera dhe nisu rrugës së hekurt!» Burri kishte qylaf të bardhë, xhaketë me pikë laramane dhe pantallona të gjera. Kur po largohej, Sokoli pa dy shpatulla, si rrasha guri, dhe ato, pikat e xhaketës, i vranë sytë.

Përpara malësorit shtrihej traseja, që zgjatej e zgjatej. Atij iu duk se fundi i dy anëve afrohej më shumë e sikur mbyllej në një pikë nga ku nuk mund të kalohej më tej. Ai nuk kishte parë të tillë rrugë në male: ato ishin të thyera, ku zbrisje e ngjiteshe dhe kjo jepte përshtypjen e rrugëve të shkurtra, që nuk mbylleshin në një pikë. «Hé! Fusha t'i shkurton kambët,» — mendoi ai dhe nxitoi hapin të arrinte sa më parë mbylljen e asaj pike, por, sa më tepër shpejtonte, ajo pikë largohej më shumë dhe traseja zgjatej e zgjatej. I vetëm në atë trase, ai ngjante si një kunj:

— Ka me u prishë fejesa, Martë! — nxitoi e tha Rega si heshtazi.

Marta ndjeu frymëmarrjen e Tushës që e kapi për krahu; pa fytyrën e žverdhur të Gjokës, që diç bluante në mendje për atë që guxoi të kërcënonte përpara tij një vajzë të Bjeshkës së Hirtë; pa Sokolin shumë të qetë e të gatshëm për të dhënë alarmin e për të ngritur në këmbë gjithë qytezën në mbrojtje të saj; pa Bujarin që i shkaktoi dhimbje padashur... Asaj diç iu mblodh

në grykë dhe u mundua ta përcillte. Dora i qe tulatur në pëllëmbën e Bujarit dhe i dridhej si gjethë. Marta ndjeu t'i dridhej edhe trupi dhe u mundua të mbahej.

Çiftet vallëzonin. Marta i shtrëngoi dorën Bujarit dhe i buzëqeshi dridhshëm: «Nji, dy, tri!» Ajo pamje e ngrirë filloi të çlirej. Gjoka i tha malësorit se dhe ai qe nga Hiraj. Thatuku vështronte me sy të -picërruar. Gjoka i shtrëngoi llërën me kërcënim se nuk qe mirë të grindej burri në valle. Thatuku pa me sy të ethshëm, ia kapi dorën Gjokës dhe ia hoqi me qetësi:

— Vërtet ajo asht bijë Hiraj, por asht dhe nuse konaku e Krojeve të Fjetuna.

Çiftet vallëzonin. Bujari me Martën po kërcenin bashkë. Marta po mësonte: Një, dy, tri!

Eja të dalim e të marrim pak ajër, — tha Gjoka. — Këtu nuk të len muzika me bisedue.

Malësori i shkoi mbas. Jashtë moti u duk i ftohtë dhe ata ngritën jakat. Qielli kishte re të dendura, të ngarkuara me shi. Gjoka e pyeti si e kishte emrin.

— Ukë! — tha malësori.

— Ukë apo Ujkan?

Thatuku qeshi: qe mugët dhe nuk u duk si u ngërdhesh.

— Asht përrallë ajo e Ujkanit.

— Përrallë, por këtu nuk luhen përralla, Ukë!

Uka u vrenjt dhe filloi t'i lëvizte cepi i buzës. Po të ishte vetëm, do ta kishte kafshuar e do ta kishte këputur copë.

— Cili do me luejtë?! — pyeti Uka në angështi.

— Ba me u ankue Marta...

— Unë nuk desha me randue kurrkend.

— Eh, ti nuk ke pa si digjet Krishti, Ukë! Sot Krishti u dogj.

Uka kishte vënë gishtin e madh nën mjekër dhe me gishtin tregues lëvizte buzën e poshtme. «Cilët e dogjën Krishtin, vullnetarët?» — pyeti ai. Gjoka tha se dhe ai vetë kishte qenë atje. «E dogji ai, që kërceu me Martën.» «Shuej, he burrë!» — tha Uka. Gjoka tha se nuk bënte burri ashtu si bëri ai. Uka qeshi përsëri, por ajo e qeshur u duk e mbytur dhe si e dalë për hundësh.

— Me çka po shof, ke me qenë rreziku i vetes, — tha Gjoka, duke kërkuar në mugëtirë sytë e malësorit.

Uka u çua «vrik» nga stoli.

Gjoka tha prerazi: «Shko ku të të zejë nata! Do të më kesh mik për tanë jetën.» Dy shpatulla u zhdukën në muzg të asaj mbrëmjeje. Pikat laramane nuk dallonin më në atë xhaketë. Qylafi i bardhë dukej që përtej.

Nga salsa dëgjohej muzika.

Gjoka ecte me hapa të rënduar. Ai solli ndërmend Krishtin që digjej dhe atë mugëtirën në sytë e Ukës.

Bujari e Sokoli dolën nga mbrëmja. Sokoli kishte mendimin se vigjilencia në qytezë kishte rënë, prandaj ajo duhej organizuar, se të vinte e të futej armiku i klasës, ta gjente pikën e dobët dhe ta merrte kalanë nga brenda: «Ja, mua ma hodhi Thatuku!» — tha ai. Muzgu përhapte të qeshurën e Bujarit dhe ajo ndihej si një tingull metalik.

— Duhet formuar dhe një patrullë zbulimi, vëlla! Bile t'i zhëp dhe në dru, — tha Sokoli. — Pikë!

Ata ec e qesh. Kur iu afruan stolit, sa njéri-tjetri, filluan t'u tregonin Lorës dhe Gencit përsa ndodhi me Martën. Mandej Sokoli, me vështrim kureshtar mbi Lorën, pyeti përse ata të dy nuk po vinin në mbrëmje.

— Më vonë! — tha Lora.

— Pse vështron? — pyeti Genci.

— Thonë se ju dûheni, prândaj, — tha Sokoli qetë.

Lora u skuq. Genci kafshoi buzën. Bujari ndjeu një drithërimë dhe u nemit.

— Edhe për ju... Thonë, mistreca! — shfreu Genci. Ai gati u çua nga stoli.

Lora mbeti në ankth. Bujarit iu duk sikur iu meh fryma. Sokoli u mbillaçit e nuk po përcillte dot pështymën:

— Unë fjalë dashurie thashë.

Bujari e têrhoqi Sokolin, sa desh e rrëzoi.

— Padashur, Lorë! Na fal! — mori frymë lirisht ai.

Gjatë rrujës Sokoli shpjegonte se Genci qe ogic. Tërë ditën ogic! Vinte pas njerëzve ogici, duke blegërirë, që t'i jepnin bukë e kripë: «Dëgjo vëllanë ti! Nuk e di budallai se vajza është si hija e trupit: po e ndoqe, të ikën; po ike, të ndjek! Pikë! Dëgjo vëllanë ti! — ligjéronte ai.

— Ka nevojë për mend. Pikë!»

Nuk kishte hënë. Kishte re. Lora qeshi kur mendoi të papriturën e Sokolit dhe ndjeu freski. Genci e ngjasoi me një fëmijë që godet me gurë të vegjël dashnorët dhe nuk largohet andej, po të mos e shajnë. Ata nuk qëndronin më të mbështetur te stoli. Ajo se ku kishte gjetur përsëri një gur dhe filloi të lozta me majën e këpucës.

— Më têrboi! — turfulloj Genci dhe qeshi nën hundë, për të fshehur shqetësimin e vet. Ajo deshi ta qetësonte dhe i tha se Bujari i kishte

folur mirë për të. Nga salla vinin tingujt e muzikës. Lorës i shkrepit në mendje të kujtonte vargjet e një vjershe të harruar:

*Se ty fajin s'ta ka këmba,
Që po ecën si ndër gjemba!
As ta ka ty fajin...*

Ajo nxitoi dhe i ra përsëri gurit me majën e këpucës dhe e hodhi tej, se nuk deshi të thoshte që s'ia kishte fajin «mezi», në s'e nxënkkësh edhe brezi! (Ajo nuk përmëndi as emrin e vajzës në këngë: «Moj Marinë!») Sa herë kujtonte këto vërgje; Lorës i ndrydhej gjoksi: nuk deshi të besonte se në to ndihej ankesa e Marinës së braktisur. Prandaj dhe i ra gurit me forcë.

— Po çështja jonë si do të bëhet? — tha ai me mërzi.

Lorë e pa drejt, kaloi duart anës kokës, mblo-dhi flokët tufë në njérën dorë dhe, mandej, dora i rrëshqiti e flokët iu shpërndanë përsëri mbi supe. Muzgu qe i hirtë e, dalëngadalë, sikur po fundosej në hapësirë. Tingujt e muzikës joshnin në vallëzim.

— Të tjerët këndojnë e kërcejnë, Genc!

— Le të kërcejnë!

Lorë u largua. Gënci u kthyë e u ul te stoli, mbështeti bërrylin mbi parvaz dhe shtrydhë ballin me mollëzat e gishtave. Muzgu ra i plotë në oborr të qytezës dhe dritat elektrike u ndezën. Koha ishte për shi.

Kur hyri brenda, Lorë ndjeu frymën e ngroh-të të sallës, ndonësë ajo që e madhe, e lartë dhe me dritare thuajse të hapura. Muzika ngatërrrohej me bisedën dhe të qeshurat e atyre që nuk kërcenin. Ajo ndenji një çast te dera, pa ditur nga të shkonte. Rega e pa dhe i bëri shenjë.

Lora nxitoi e iu ul pranë. Rega ia mori dorën në pëllëmbët e veta dhe i tregoi se Gjoka po kërcente me Bujarin. Sokoli me Tushën dhe Marta kishte shkuar të flinte. Lora i tha të kërcenin bashkë. Rega u tremb, largoi duart dhe i hodhi në prehrin e vet. Lora u çua dhe e kapi pér dore. Rega ndiente të rrahurën e zemrës dhe flakë e prush i vajti pas e druajtur. «Ma jep dorën, — tha Lora dhe të vetën ia shkoi në bel.

— Tjetrën mbështete në krahun tim!» Rega e harroi Gjokën dhe... nji, dy, tri! Iu duk sikur me zërin luhatej dhe ajo në krahët e Lorës. Rega ngatërhojej në hapin e fundit dhe, aty pér aty, vinte në vete: tri! Sytë i mbante ulur në hapat e vet dhe i dukej sikur salla e vështronë e fliste me zë të përbashkët: Ashtuuu... Figurat e kërcimtarëve kalonin prerazi anës saj dhe humbisnin në sallë. Hapi i fundit po i dukej më i vështirë. Rega ngriti sytë dhe pa Lorën: kishte sy të hutuar e, në thelli si, dukej sikur i dridheshin bebëzat. Me to dridhej dhe vetë ajo në duart e Lorës.

— Ma mirë me u ulë, Lorë!

— Pse?!

— Më ardhka randë!

Rega ndjeu zërin e të shoqit, sikur i hukati mbas shpine. «Ma lehtë mundem me kërcye valle e shpatave, Bujar! Nuk qenka valle burrash kjo, dorabel,» — tha Gjoka me shpoti. «Sa të mësohesh e mandej.» «Boll grueja!» — tha ai dhe u shkëput nga kërcimi. Rega qe ulur në vend më parë se i shoqi. Mbrëmja ruante druajtjen dhe dëlirësinë e cifteve në vallëzim. Ajo kishte dhe një pamje nazike. Njëra nga vajzat qe zbukuruar me kapetin¹⁾ e cullufes, që i dilte

1) palëza e flokut e kapur midis dy karficave

anëballit. Tjetrës i derdheshin' flokët mbi supë. Sekujt i qe zhdredhur paksa i vetmi gërshtet. Fustanet e fundet me ngjyra të përziera, jeleku me temina dhe përparësja e stolisur mbi linjën e bardhë, që davaritej e mbulonte qafat e çorapeve të leshta me ca zigzage ngjyrash, i jepnin mbrëmjes një pamje të thyer dhe tërhiqnin vëmendje. Me to përziheshin xhakavento dhe pantallona të vullnetarëve. Gjoka ende nuk ishte ulur në vend, kur Lora e ftoi të kërcenin. Atij iu dukën shputat e këmbëve të rënda. Rega e vështronë me sy shqerre dhe kujtoi se do të dridhej në duart e Lorës: «Gjoka,.. Nuk ka me u dridhë, jo! Ai asht malësuer dhe dora e Lorës asht e vogël në atë pëllëmbë të Gjokës... Dhe shtati i saj as ndihet i randë në krahun e tij, hihih! Gjoka ka me e sjellë Looorëëën në atë muzikë me atë krahun e ti...»

Lora i shtrëngoi dorën Gjokës dhe i dha bel. Malësori e ndjeu ballin të djsersitur. Ai nuk po fliste: njëqind shina hekuri do t'i lëvizte më lehtë. Lora ia ndjeu druajtjen:

— Lëshoje veten, Gjokë! Ashtuuu, ja! Sikur ecën! nji, dy...

— E keni parë Bujarin? — pyeti Sokoli.

— Ka dalë përjashta, — tha Gjoka. Atij iu duk sikur shpërtheu tërë grahmën që mbante përbrenda.

— Të vaftë mbarë, Gjokë! — tha Sokoli dhe i shkeli syrin.

Gjokës iu duk sikur iu mbarua fryma në atë «dare kërcimi», doradorë e dorëbel, që e kishtë kapur dhe nuk po e lëshonte. Ai deshi të shkëputet. «Eshtë turp ta lësh vajzën gjatë kërcimit, Gjokë! — qeshi Lora. — Hajt, nji, dy, tri!» Gjoka përçollti pështymën, vështroi majat e opingëve dhe iu bë sikur ato po i ngatërrroheshin e po takonin

me majat e këpucëve të Lorës. «Kur ka me mbarue?» — pyeti ai. «Ashtuu! Rrotullohu. Gjokë!» — tha ajo. Dhe sakaq mori kthesën së bashku me të. Në atë kthesë, Gjoka e ndjeu veten ngushtë.

Kur shkoi Tusha në bujtinë, Martën e gjeti symbyllur, të shtrirë në krevat e të mbuluar me batanije, ashtu si kishte dalë nga mbrëmja, me gjithë pantallona. Marta kishte qarë te jastëku dhe kishte dihatur me frymë të nxehjtë. Në shtjekëzën e syrit i kishte mbetur ende një pikë loti, si një bulëz e harruar. Tusha pranë ia ndjeu ngashërimin dhe i tha me pëshpërimë: «Nuk është mirë me lanë mbramjen dhe shokët.» Marta shtrëngoi sytë: «A iku ai?»

— Bisedoi Gjoka me të, — tha Tusha.

Ato dukeshin sikur flisnin buzë më buzë:

— E, ç'tha?

— Asgja! Iku. Po ti, e marrë je??!

— Pse?

— Hajt, çohu! — ia largoi Tusha batanijen.

— Shpirtin e kemi tonin dhe s'ia kemi shitë kurrikujt!

Marta u çua, irregulloi shpejt bluzën e bardhë dhe mori pasqyrën. Mollëzat e faqeve iu dukën të fryra. I preku sapak dhe filloj të ndrejtë me gishta tufëzat e flokëve. Balli iu duk i rënduar. Ajo vuri pasqyrën nën jastëk.

— Ti thue se ka me u prishë fejesa, Tushë?

— Ma mirë fejesa, se me u prishë jetë! — tha Tusha tërë millef. — Tanë jetën gjakprishun kemi ndejtë.

Jashtë derës ndihej freski. Era shkrittonte retë. Edhe Martës ia përthau atë bulëz loti të

harruar. Ajo ndolli hundët pa të keq, me nga-shërimë, dhe u rregullua. I doli Tushës përpara dhe e pyeti. «Si molla je,» — i tha Tusha dhe e kapi për dore.

Kur hynë në sallë, Marta dukej si një sor-kadhe e trembur. Tusha i hodhi dorën në bel dhe ato filluan të kërcenin bashkë: Nji, dy, tri!... Kur zbritën nga malet, në qytezën e re ende nuk kishte filluar turni. Ato as trenin nuk e kishin parë. Nji, dy, tri... Rrugët i përshkuan natën dhe përfytyrimi i tyre për trenin qe i ndryshëm: një tren i veçantë, që vjen me zhurmë si ortek e kalon si rrufe, nji, dy... ndonjëra e mendoi edhe me krah, për të ecur më shpejt. Të nesërmen ato u kapën dorë për dore. Vë-shtronin vullnetaret e ardhura nga qytetet e tiera, nxënëset e shkollave dhe shtrëngonin shoqia-shoqen. Nië ditë (ato ditë kishte rënë shi dhe kishte baltë) Marta rrëshqiti dhe u rrëzua përtokë. Lora ndodhi me dy shoqe të veta dhe e ndihmoi të çohej. Kështu filloi vizita në bujtina. Dukej në këtë qytezë sikur dy familje të mëdha prisnin e përcillnin njëra-tjetërën e fjaloseshin si gatuhet spinaqi, si bëhet reçeli me kumbulla e qoftet me erëza dhe, po të laheshe me sapun «Pranvera», fytyra të qëndronte gjithmonë e freskët... Thanë se njëren e kishte zënë «qomyri». Malësoret në fillim mbetën të habitura, por dalëngadalë e kuptuan përsë ishte fjala, qeshën të skuqura dhe, duke mbyllur sytë të turpëruara, kafshuan buzën... Nji, dy, tri! Mandej Tusha preu gërshtetin. Dikush qeshi. Një thartoi buzët. Të nesërmen njëra nga vajzat mori gërshëret dhe vajti i tha Lorës: «M'i pre, por jo të shkurtër. Aq sa të tutë.» Ai gërshtet ngatërroi dhe Sokolin, që sajoi një figurë letrare të gërshetave që zgjateshin e zgjateshin...

Gjoka dhe Rega dolën nga salsa dhe nxituan nëpër muzg. Fresku i erës ia lau fytyrën dhe syrin ua përloti paksa. Ai i tha së shoqes të mblidhej dhe u mbush me frymë. Rega, duket nuk e pati mendjen, e kapi për dore e deshi ta ndalonte.

— Ku shkojmë, Gjokë?! — i tha ajo si me pëshpërimë.

— Kurrkund. Eja!

Rega u çapit mbas tij:

— Tusha po kërcente me Martën, a e pe?

— Ma ngadalë, se të ndien nata.

— Cila?!

— Nata. Natën ndihet zani ma fort.

— Uh, po! — tha Rega dhe heshti një hop.

Ajo ia shtrëngoi dorën Gjokës me mendje se duhej të fliste me zë të ulët, por harroi dhe e ndjeu veten të vetme krah tij. — Marta u ngatërrua... hi! — sa e nisi gazin ajo dhe iu struk Gjokës pranë. — Mue më erdhi me qeshë.

— Praj, ma! Ende asht herët, — tha Gjoka.

Rega nuk e kuptoi përsë ishte herët. Nga larg atyre u vinte një bisedë, që humbiste rru-gës si një pëshpërimë dhe nuk dallohej mirë kush fliste te këndi i bujtinës. Frynte erë e përzier. Shiu qëndronte varur. Rega u bë kureshtare:

«Pashë Lorën që erdhi vetëm. Ti je budalla,» — tha Bujari dhe mandej diç mbllaçiti një fjalë, që ajo nuk e mori vesh.

Ata kaluan pranë. Genci vështronë nën vellulla:

«Unë nuk vij!»

Genci ishte i mërzitur. Bujari i shqetësuar,

Era nuk merrej vesh nga frynte.

Me të hyrë në sallë, Genci shkoi gishtat në-për flokë, por flokët përsëri i mbetën të ngaterruar; ndërsa Bujari qëndroi një çast, se ajri i sallës erdhi e i zuri frymën.

— Po ç'u bëre, Bujar?! — tha Sokoli sa e pa. Ai nxitoi pranë dhe i pëshpëriti: — Kam gjetur një bori.

— Bori??!

Sokoli i shkeli syrin dhe i bëri shenjë të shkonin mbas perdes së skenës, ku do t'i tre-gonte madhështinë e idesë së vet: do t'i binte borisë, për të hutuar Kujtimin (me ta dëgjuar, ai do të urdhëronte të shkonin të gjithë në punë). Genci nuk i pa më. Ai qe mbështetur me shpatull mbi paretin e murit prej pupuliti, aty afër derës, dhe filloi të kërkonte me sy Lorën. Ajo po kërcente me Kujtimin. Atë mbrëmje Kujtimi kishte veshur një xhakavento në ngjyrë gri, ku spikaste një këmishë në ngjyrë të pjetrit. Ata kërcenin të heshtur. Lora e ndjeu veten ngushtë: «Kam një kallo në dorë,» — tha ajo. Kujtimi i kërkoi të falur dhe ia mbajti dorën lirshëm. Genci kishte mbetur i harruar dhe dukej sikur po mbante mbi shpatulla paretin prej pupuliti të barakës. Të tjerët kërcenin dhe zhurma e melodja ndërthureshin me njëra-tjetren në ritme të tillë sa, çuditërisht, nuk mund të kuptoheshin veçmas. Lora kaloi pranë Gencit dhe, për t'iu larguar dyshimit që mund të linte te të tjerët, e ftoi tërë shend që të kërcenin së bashku.

Kur u ndërpri muzika, zhurma u ndje e fortë. Njerëzit e dalluan qartë se ajo ishte e vrazhdë dhe paskësh qenë e fashitur nga tingujt.

— Të shqetësova? — tha Kujtimi.

Ajo i tha se kishte vërtet një kallo në dorë dhe u largua. Kujtimit iu duk vetja si ai gjah-tari që, në vend të dhelprës, mban në dorë

bishtin e saj, për t'u treguar shokëve se është nishanlli i mirë. Vetëm bishti i duhej për ta varur në oxhak dhe atë ia këputi dinakes me një të qëlluar.

Genci mbeti përsëri në këmbë, afër derës. Këpucët i kishte me baltë. Muzika filloi dhe Lora sakaq u gjend përpara tij. Ajo e çorodiste me të papriturat e veta dhe Gencit herë i dukej e druajtur dhe herë e vendosur. Thonë se vajzat me vetulla të përziera në shtegun e tyre ruajnë për vete zilinë dhe dinë të të kundrojnë si të pafajshme dhe të të hutojnë në çaste gazmore.

— Ti e dërgove Bujarin? — pyeti ai. Genci e dinte që kjo nuk ishte e vërtetë.

— Unë Bujarin?! Ku?

Ajo mbledhi supet dhe ndjeu se si një damar po i rrihte në anë të gushës nga vërvshimi i papritur i gjakut. I vinte inat me Bujarin (dikur na i paskësh thënë se e kishte dhe motër, hë!). Gencit iu tha pështyma. Ato të përplasura këmbësh i ngjanin si rrapiullima e latij guri, me të cilin Lora lozta me majën e këpucës atë mbrëmje në oborr. Një, dy, tre! Sa e vështirë, te numri tre ngatërroheshin të gjithë ata që nuk dinin! Dhe ai e kishte ndalur Lorën: një... dy... katër! Dhe ai kujtdo mund t'i thoshte të vërtetën. Dhe ajo iu tha se nuk u pukej rrezja e syrit.

— Cila? — pyeti ai si një meit.

— Rrezja e syrit, thonë andej nga ne! — tha ajo. Lora la kërcimin e mbeti një hopë përballë tij. Deshi t'i thoshte dhe diç tjetër.

Genci kishte vështrim të thekshëm. Ajo i afroi rishtazi dorën e shkëputur. Genci mbeti i heshtur. Ajo buzëqeshi përtë fashit ur zémërimin e tij. Ai iku papritur dhë të tjerët mbetën në përgjim, kur e panë të largohej me ma-



dhështi. Çifte kureshtare lanë kërcimin dhe, pa e shkëputur dorën, vështronin Lorën, tek buzë-qeshët vetëm. Marta i pëshpëriti në emër si e nemitur dhe ia mori dorën në pëllëmbën e vet për ta ftuar në kërcim. Ndërkohë muzika u pre. Ato mbetën me duar të shtrënguara. Sokoli i ra borisë dhe doli në skenë për të mbajtur ligjërimin: «*Rak e tak, një tokmak...*»

“Shiu erdhi pa bubullima. Në fillim që me pikat të mëdha dhe, nën dritat elektrike, dukej si litarë uji që zbrisnin nga lart. Rega deshi t'i ledhatohej të shoqit dhe, aty nën strehë, i kapi gishtat, por dorë e tij e vrazhdë dhe me kallo nuk po ia ndiente shumë përkëdhelinë.

— A ke me u ba gati, Regë?

E shoqja nuk i ktheu përgjigje. Gjoka iar-goi dorën, se dikush kaloi aty pranë, pa nga atë dhe, për t'iu ruajtur shiut, e mbajti fryshtat të dera e bujtinës së vet.

— Ti a po ndien se çka po të thotë burri?

— tha Gjoka.

— Na pô e kuvendim, Gjokë, — tha ajo. Përtë parën herë mbas martese iu duk se po bisedonte me Gjokën, si të bisedonte me Lorën përqëndisma. Ajo deshi t'ia kapte përsëri gishtat te gishtat e vet. Gjoka tha rëndë: «Kur nuk ftillohet kuvendi, burri ban si di vetë!» Gishtat e Regës u mblodhën vetiu, si të harruar: «Nuk ban, Gjokë! E tanë hekurudha ka me folë për ty dhe për mue,» — tha ajo. «Ban mirë me fjetë dhe me e mendue hollë!» — tha ai.

Shiu ngjante me ca fije të këputura uji. Gjoka mbeti nën strehë, derisa Rega u fut në bujtinë.

SHTJELLA E ERËS

Edhe inxhinier Artini banonte në një barakë prej pupuliti. Në dhomë kishte një dollap rro-bash, dy krevate të drunjta (në njërin flinte vetë dhe tjetrin e mbante për ndonjë mik a të ardhur), një tavolinë ku zakonisht linte pasqyrën, veglat e rrojës, ca libra dhe fotografinë e së shoqes. Kishte dhe një furnelë elektrike, që e përdorte për ngrohje, se me të ai nuk pati gatuar kurrë, dhe enët që i kishte dhënë e shoqja i kishin mbetur në një anë të dollapit. Dhoma mbetej shpesh pa të zotin. Ai të shumtën e herës e ghinte në barakën e vogël prej dërrasë, ku kishte ca thasë çimentoje, ca grumbuj të vegjël zhavorri, vegla të pakta pune dhe një, krevat të drunjtë, të mbuluar me tri batanije, të leshta. Aty ngrinte konuse betoni, u vinte nga një peshë përsipër, dhe pastaj llogariste matjet. Ishte inxhinier i zoti dhe i vlerësuar nga Gjadri¹⁾ në një simpozium shkencor.

Artini prishi konusin e betonit dhe doli e u mbështet në anë të derës. Kishte kohë që merrej me provat për të fituar një markë betoni të qëndrueshme dhe ato ditët e fundit po e ndiente veten të lodhur e gjithmonë dukej si i pagjumë.

— U mërzite, inxhinier? — i tha Petroja nga brenda barakës. — A të të bëj një kafe?

1) konstruktor i dëgjuar i urave në vendin tonë

— Lëre, se Konusi i Abramsit¹⁾, na... na... na e djallosi! Duhet çimento e markës 600, ndryshe...

Ai la të kuptonte se ndryshe nuk ka urë dhe plas kokën, po deshe të dalësh nga gjendja, si e kishte plasur ai e nuk po nxirrte gjë në krye! Artinit i dridhej bishti i cigares në buzë. Petroja i ofroi kafen:

— Do t'i ndërtojmë me gurë, inxhinier.

Artinit i erdhi të qeshte me hamendjen e Petros dhe mori të pinte kafen.

— Kë do të ndërtosh me gurë, urat?!

— Jo, kushinetat, — tha Petroja i getë:

Inxhinieri kishte kohë që nuk mund të duron të qetësi dhe i dukej çudi kur i flisnin qetë; problemet ia shtronin gjithmonë me zë të lartë; si një prirje, gjoja, për t'i dhënë të drejtë vetes. Ai qeshi nën hundë dhe vetiu ndjeu një boshllék:
— Hë!... Ja dhe i gjete përmasat e duhura, Petrooo, një gur sa, një dhomë. Hajt e lëvize nga vendi!

— Betonin e kushinetës do ta mbrujmë me gur, Artin, — gjegji Petroja në çast dhe rufiti kafen. — Dhe do t'i lidhim, ashtu si lidhen urat e gurta. Dhe kjo do të jetë një vepër arti në këtë urë, paçka se...

Usta Petroja deshi të thoshte: «Paçka se sot për sot nuk jemi në gjendje të prodhojmë atë markë çimentoje.» Ai shkoi brenda dhe la filxhanin. Nga larg u ndje një klithmë e veçuar shpendi në ajér.

— Mundet! Duhet parë madhësia e gurit dhe format e tij të thyerjes, — tha ai dhe u afroa pranë Petros.

Klithma e shpendit u ndje përsëri. Duket

1) një ndër mënyrat për matjen e vlerës së betonit

kishte humbur tufën dhe klithte me grahmë.
— Do të thyejmë gurë, inxhinier.

— Nuk thyen dot gurë ti, jo! Do të lajmë-rojmö ministrinë të na sjellin gurë të fortë nga Burreli apo nga ndonjë vend tjeter. Duhet të fitojmë fortësinë e betonit me çimento të markës 600, ndryshe... — dhe ai përsëri deshi të thoshte: «Ndryshe nuk kemi urë.» — Sidoqoftë sonte kthehemë në shtëpi. — Grahma e shpendit u ndje përsëri, por më e thellë. Artini mori rrugën. Këmbëzat e pantallonave i kishte të futura në qafat e çizmeve. Petroja mylli derën e barakës dhe nxitoi ta arrinte. Toka e lagësht furonte¹⁾ mbas hapave të tij. Gjethet e pemëve kishin rënë, zogjtë kishin kohë që kishin arritur në vendet e ngrohta, harabelat nuk lodronin më nëpër pëlepa, por hynin e dilnin ndër strehë tjegullash e fshiheshin në mullarë bari dhe vetëm mëlljenjat, çerret, gushenjtë e shaptoret ndillin dimirin, duke bëredhur nëpër gjerdhe. Artini kishte kohë që mendonte për kushinetat mbi këmbëzën e urës.

Një natë... qe muaji korrik. Inxhinier Artinit thua se i kishte mbirë cigarja në buzë dhe, vetëm kur i lagej duhani, ia ndiente hidhërimën e fillonte të pështynte:

— Na helmoi djalli, Petro, na helmoi!
— Punët si venë, inxhinier, punët pa...
Inxhinieri i zvarrise fjalët, se buzën e po-shtme e kishte pak të trashë dhe dukej sikur përtonte të jepë përgjigje të shpejta:
— Punët?... Hë! Ç'të bësh me punët! Gjer-

1) Zhurmimi i tokës së papunuar (livadhi, fëngu, ugari) mbas shirave të para, kur ende është e pangopur. Kjo quhet dhe si një frymëmarrje e tokës.

manët nuk pyetën për Mërshin¹⁾. Nuk e sheh si ia kanë shkatërruar urën?! I shkreti Mërsh, që deshi të ndërtonte!

— Hë!... Më fal, inxhinier, por ata shkatërruan urat tonat.

— Sigurisht, Petro. Dhe një ushtri që prish urat jeton me frikën dhe ka marrë fund. Nuk prishën partizanët ura, bille ndërtuan ura të drunjta përbri atyre që prishi gjermani... Është shumë e vështirë të ndërtosh një urë, më e vështirë nga çdo ndërtesë.

Ndërtimin e urave Artini e ngjasonte me vlerën e shpendit të përrallave, që mbante mbi shpinë të vet njerëzit dhe i kalonte nga një vend në tjetrin. Dhe kush prishte urën, u prishte njerëzve rrugën dhe u ndalte kohën.

— Kështu!... Ç'të bëj që nuk kemi beton për kuzhinat e këmbëzës së urës, këtë më thuaj!

Petroja qeshi:

— Beton?!

— Beton të markës pesëqind. Dhe mës qesh!

— pështyu ai cipëzën e letrës së cigares që i ishte ngjitur mbi buzë. — Dhe për ta arritur këtë, cimentoja duhet të jetë e markës 600. Hë de! Qesh tan! Bota e prodhon me vështirësi e në sasi të paktë, ndërsa ne, tani për tani, përdorim të markës katërqind. Hë, qesh tan!

— Do ta bëjmë, inxhinier, — tha Petroja në besim të kotë, ashtu si ishte bërë zakon të thuhej për çdo gjë të pamundur.

— Ç'do të bësh, mo?! Kulaç në hi? — përqeshi Artini dhe pastaj, për t'i dhënë të drejtë

1) Konstruktor gjerman i tipit të urave me hark, simbas tipit të të cilat u ndërtua Ura e Mifolit, e Matit dhe ajo e Rrogozhinës. Këtë të fundit gjermanët e shkatërruan plotësisht.

vetes në ato netët e pagjuma të punës së lo-dhshmë, plotësoi aty për aty: — Pol Edhe unë e di që duhet ta bëjmë: ja, unë; ti, vullnetarët, me një fjalë ne! Po me se?! Dhe po nuk u bënë kuzhinat me atë rreze e markë, duhet ritokuar konstruksioni i urës dhe kjo hap avaze. Hë! Avaze! — përsëriti ai, ndërkohë që nga dritarja u dëgjuat zëri i së shoqes, Luljetës, ta thërriste në emër. Ajo kishte ardhur në aksion me nxënësit dhe, kur ata u larguan, e dërgoi djalin tek e motra e martuar në Pogradec dhe vetë qëndroi të kalonte pushimet verore me Artinin. Luljeta e thirri për së dyti dhe pamja e saj mbeti në dritare si një kornizë në sfondin gri të natës.

— Mirëmbërëma, Petro!

— Mirëmbërëma, Luli! Po të thërrret gruaja, inxhinier E humbë?

— Ah, po! Na është bërë mendja bëton, qeshi Artini.

— Është vonë. Ka kohë të mendojmë nesër,

— foli Petroja dhe u nis për të dalë.

— Po, po! Dhe do të përtërijmë truditën e vjetër! — dhe, nësa po mbillte dritaren, i tha së shoqes ta priste nga dëra. — Ai që bënte urën, në provën e parë qëndronë nën urë. Po të që se shembej, duhej që edhe mijeshtri të pësonte rrezikun e punës së vet. Urat kanë të bëjnë me fatin e njerëzve, prandaj.

— Është vonë, Artin, dhe mendja e natës... Mua më presin fëmija dhe ty, — tregoi ai Iuljetën që kishte mbetur në krye të derës dhe bu-zëqeshte e qetë, me vetulla të ngritura për të përzënë gjumin.

— Lëre projektin, Arti! Është ora tre e natës. Edhe pak e vullnetarët çohën për punë; ti nuk ke fjetur fare.

— Hë, djalli e mori! Po ja dhe ti, Luli... — tha ai dhe përplasi lapsin mbi projektin e kushinetave, pa mundur të kapte fillin e mendimeve: «Hë, shqetësohen gratë dhe duan të na çlodhin që të jemi në gjendje të bëjmë ura të fortë», i vetoi një mendim dhe pastaj iu drejtua së shoqes: — Do të vish me mua nën urë, kur të kalojë treni i parë?!

— Nën urë?! — u habit ajo dhe pa nga Petroja. — C'dua unë nën urë?!

— Të kalojmë bashkë provën e rrezikut.

— Ooo, patjetër! — buzëqeshi ajo. — Patjetër!

Artinit iu duk sikur ëndrra e tij zuri vend dhe bëri fole në gropëzat e fajes së Lulit. Aso-kohe ishte korrik dhe nata dukej e qelqtë. Më të hyrë në dhomë, Luljeta e pushtoi Artinin, ia gërshtetoj gishtat anës qafe dhe... kur ia ndjeu frymën pranë fytyrës, i pëshpëriti me frikë se mos e dëgjonte kush: «Hë, tani bjer, e fli!...» Ishte natë korriku dhe nga pjesa e sipërme e xhamit të dritares Lulit i dukej sikur lëviznin yjet. Qielli ngjante me një gravurë të sjellë nga lashtësia. Në qyterë një dashuri thurej dhe tjetra jetonte me shqetësimet e projektimit të urës.

Përpara, se të vinte vjeshta, ai krevat thuajse mbeti i vetëm, se inxhinieri herë shtrihej në të dhe herë-herë gdhihej në barakën e vogël pranë objektit, ku me usta Petron, provonte betonin për kushinetat.

— Ah, jo, Petro, jo! Prishe tani, dregi e mori, prishe! — klithte ai nëpër natë.

" Në bandën e murit, në anë të oxhakut, dy zogj në degë, me krahë paksa hapur dhe pupla paksa kërleshur anëqafe, dukeshin sikur çuçurisnin dhe sikur çukiteshin sqep më sqep e nuk merrej vesh në grindeshin apo jetonin në dashuri. Ky që dhe i vëtmi zbukurim që tërroqi vëmendjen e miqve në atë dhomë, ndonëse kishte plot fotografi... Petroja ishte në njérën qoshe. Hërë-hëre, pranë tij, Gjoka shkëputej nga biseda dhe vështronë zogjtë.

Stefan Jorgji fërkoi gjurin të lehtësonte sadopak dhimbjen. Kishte kohë që vuante, i pat vënë dhe qeska me kripë, por nuk kishte gjetur shërim. Sekush i kishtë thënë ta lyente dhe me helm akrepi të tretur në vaj, apo të merrte e t'i vinte bletë t'i pickonin gjurin. Ai pyeti Gjokën, që rrinte i druajtur mes tyre, se kë dëgjonte më shumë, babën apo ustani. Pastaj mori pirunin dhe u afroi miqve mëlgjite e zogut. Petroja ngriti gôtën, piu raki dhe kafshoi qepë. Në vatrë luhateshin flakë e shkëputeshin xixa, që merrnin oxhakun dhë pastaj përbireshin me tymin. Plaku, mend e veshë nga Gjoka, luajti urën e zjarrit dhe nxori më shumë xixa.

— Dhe babën dhe ustani, — tha Gjoka. — Baba është babë dhe ustai komunist, — u mundua t'i përshtatej ai sjelljes që donte kuvendi dhe të mos jepte përgjigje të nxituar.

Petros iu duk sikur iu hoq një gllomçkë, që i lidhte fytin. Dhe Stefanit i erdhi mirë që ai, Gjoka, nuk po i ndante dhe i besonte komunistit si babës së vet dhe babës... (kur kujtoi Krishtin, xha Stefani shkrepit urët e zjarrit, se

iu duk mendim i ngatërruar e desh rrëshqiti në fjalë të pamenda!)

— Ju maliësorët burra jeni, por rakinë e fortë s'e dashkeni, — tha plaku dhe çakërroi gotën.

Gjoka nuk foli. Ai rrinte e vështronë konfijjtë e ndezur në oxhak.

— Dhe rrushi andej është i paktë, prandaj!

— tha Petroja e mori krahthin e zogut dhe e kërpiti. — Ndryshe Skrapari e Përmeti, kanë hardhi dhe vreshta.

Stefani tundi kokën. Macja përhimej e mble-dhur në vatër, kotej me ngérrez dhe, nga të nxehjtët, herë-herë, ngjante se i dridhej një copë lëkurë në brinjë. Stefani i foli dhe lëvizi mashën. Macja u largua e trembur e, sa shkoi në mes të odës, u shtriq me bishtin përpjetë, duke shpirë nofullat e duke lëpirë buzët.

— E kanë dhe të fortë dhe të dashur, — tha plaku për rakinë.

— Po edhe në thashë ndonjë fjalë të pamend... — tha Gjoka.

Plaku nuk foli. Doreza e derës lëvizi dhe bren-da hyri një grua, thua në të dyzetat. Plaku e pa. Ajo u përshëndet me miqtë, sipas zakonit, me dorë në zemër, nxori macen jashtë, mbylli derën dhe qëndroi në këmbë me duar të kryqëzuara mbi përparësen e vet, gati për të shërbyer.

Plaku e pa përsëri.

— Deshët gjë, baba?! — pyeti ajo.

— Jo! Miqtë kanë meze.

Stefani luajti kokën. Ajo e kuptoi se nuk kishte ardhur ende koha t'u pritej biseda burrave e të shtrohej buka. Mori tabakanë e mezeve, mbetur mbi tryezë, dhe doli pa u ndier, duke lënë derën paksa hapur. Ata pinin dhe bisedonin përfé dhe për politikë. Të dyja kishin ligjet e tyre

dhe duhej t'u përbaheshe. Bile më e rrezikshme për Stefanin qe feja, se nuk hante shqip dhe nuk falte mëkatin: «Falna fajet tonë, sikurse ua falim ne fajtorëve tanë, dhe jepna...» Deri në amshim. Në politikë edhe merreshe vesh. Petroja e nxiti edhe më tej bisedën:

— Hë, Gjokë, kujt i beson? — tha ai. — Zottit apo komunistit.

— Nderës së mikut! — ngriti gotën Gjoka pér ta parë edhe të tjerët. — Dhe armën nuk e mbaj në brez në shtëpinë e mikut.

Ai piu, një gllënjkë dhe çukiti meze.

Plaku nuk piu raki, mori mashën dhe me majaçat e saj po gërvishitte në vatër.

— Gjoka piu pér shëndetin tënd, xha Stefan! — tha Petroja.

— Ah, po! Më fal, or mik, por nuk e kisha mendjen. Se mendjen e mban koka, nuk e mbaj në këmbët. Apo jo, or mik?! — iu drejtua ai Petros dhe çoku gotën me të Gjokës.

— Nderës jote! — tha Gjoka dhe mori gotën.

— Qofsh me jetë! Me të dashurit e të afërmimit, — uroi xha Stefani. — Gëzuar, Petro!

— Gëzuar!

— Dhe mos ma merr pér të keq, or mik! — iu drejtua ai Gjokës, sikur t'ia ngulte fjalët një pér një në kokë. — Mua më është përdhosur mendja. Me ndër mendja. Dhe, kur të përdhoset mendja... Ti pi e të bëftë mirë, mikut nuk i përfilitet buka.

Gjokës po i pëlqente biseda. Ata pinin e kujtonin të kaluarën. Plaku pyeti Petron në i kishin thënë gjë nga Partia pér atë që i ndodhi në oborrin e kishës dhe që xha Stefani e kishte quajtur mëkat. Mëkat. Që atë ditë ai u ngrijet, doli nga shtëpia, dhe bisedoi me Stirin. Dhe Stiri i tha se ajo kishte të bënte me Partinë, prandaj,

duket, komunisti nuk i kishte vajtur në shtëpi, paçka se qe i ftuar si mik. Stefan Jorgji solli ndër mend atë grindje dhe çap e jak nga traseja. Vështroi për komunistin, por nuk e pa dhe i shkoi mendjë për të keq. Stiri i tha të pyeste dhe pastaj të shkonte vetë në Komitetin e Partisë e të thoshte të vërtetën se komunisti nuk kishte faj, por e ngatërroi ai, matufi: «Ashtu i thuaj, se e marrin më qafë së koti!» — tha Stiri. E t'i thoshte se kishte dhe një ikonë në shtëpi. (E ja, se po e hidhte dhe atë, punë e madhe! Se mos do ta detyronte kush të mos mendonte më për zotin!) Dhe xha Stefani vajti të kërkonte Petron. Ai nuk donte të pyeste njeri. Vajti përséri. Të pestën ditë gjeti Gjokën dhe e njoihu. Dhe Gjoka e njoihu. Dhe, fjalë pas fjale, dolën në shteg te komunisti që na e paskësh emrin Petro. Petro Bitraku. Stefan Jorgji iu lut atij, Gjokës, t'i vinte për darkë bashkë me ustanë.

Asaj nate që priste miqtë, ai vajti tek ikona dhe e hoqi nga kamarja. Në çast nga mbrapa konizmës... (ajo qe e vjetër dhe, sa më e vjetër konizma, aq më i vjetër edhe shenjtë në shtëpi!). Nga mbrapa konizmës u rrëzua një akrep dhe mbeti me nofulla të hapura, bishtin dhe qeskëzën e hèlmit përpjetë. «Kështu janë këta, të helmojnë me bisht!» — tha Stefan Jorgji dhe e shtypi akrepin me këmbë. Atij iu kujtua se i bënte mirë gjurit dhe vështroi mos kishte të tjerë akrepa, por në kamare kishte vetëm pluhur dhe pezhishka merimange, të nxira nga tymi i vajit të djegur të kandilit. Zakonisht akrepat i bëjnë foletë në plasa gurësh, ndërsa ky e kishte gjetur mbas ikonës. Stefan Jorgji mori ikonën dhe ia dha së shoqes ta vinte më një anë, të mos e shihte bota. Kështu kishte bërë dhe Stiri... Ai pyeti Petron, në i kishin thënë gjë nga Partia.

— Jo! — tha Petroja.

— Po ti nuk beson...

— Jo! Komunistët nuk lejojnë të fyhen prindërit, — tha Petroja.

Plaku u ngazëllye dhe iu duk sikur dhe frymën e vet nuk po e ndiente.

Gjoka nuk po lëvizte asnë muskul të fytyrës. Zërat i vinin të thellë. Petroja tha: «Unë mbrojtë me rrezik.» Plaku pyeti: «Vërtet?!» Petroja shtypi e lëvizi majën e hundës me mollëzën e gishtit, si për të ndalur teshtimën: «Do të thoshin armiqjtë se ja, dhe komunistët...» «Luanin e pjell luanesha, nuk e pjell lopa,» — tha plaku dhe «vrik», u çua. Gjoka ndjeu se këmba e Stefanit rëndonte, tek shkelte në dyshemenë e shtëpisë. Peshqiri i kishte mbetur si një nishan, hedhur anëqafe. Peshqiri dhe brezi. Sa u gjend te dera, Stefani dha zë.

Në korridor u ndje të hapej një derë.

— Shkoni e thërrisni Stirin! — tha Stefan Jorgji.

Nga jashtë një zë gruaje i tha se qe natë.

— Shko e thirre, moj, të thonë! Nuk ka natë sonte.

Ai iu kthyë përsëri pranë vatrës dhe u ul mbi gju.

— Po ikonën? — pyeti Petroja.

Gjoka mbeti me vështrim të prerë.

Plaku ktheu kokën:

— Ikonën?!... E hoqa.

— Digje!

Plaku u zbeh. Dhe Gjoka iu duk më i zbehtë. Për një çast u ndien vetëm të kërciturat e druve në zjarr. Macja kishte ardhur e po kotej përsëri te gjuri i plakut me ngérrez. «Shpirréza!» — iu hakarrit plaku dhe ia dha me të prerën e dorës. Maces iu shtypën hundët në dysheme dhe kérceu

si e ndërkryer. «Na mbetën nëpër këmbë, na mbetën!» — tha plaku dhe u çua e nxori jashtë. Tek po kthehej, ai pa se Gjoka qe zverdhur dhe fërkonte ballin me mollëzat e gishtave. Stefani kujtoi se mos e pati zënë rakia dhe e pyeti në donte të shtrihej apo kishte ndonjë nevojë. Gjoka bëri me shenjë se ishte i qetë.

— Afrohu te zjarri, — tha Stefani dhe shkrepit urët. — Zjarri ta nxjerr të ligën.

— Sesi më erdhi kështu! — tha Gjoka dhe mblodhi veten.

— Afrohu, afrohu! Mekthi¹⁾ është, s'ka gjë. Ose do të jesh ftohur ndonjë cikë, — dhe Stefani shkoi e mori kutinë e sheqerit, mbushi një lugë kafeje dhe ia dha ta hante. — Një më një, përmekthi.

Gjoka e hëngri dhe, pas pak, vërtet u fthilla. Petroja pyeti se kujt i thoshin «mekth». Xha Stefani nuk e dinte se kujt, por ashtu i thoshin: «Ha pak sheqer dhe bëhesh qiqër.»

— Të vjen keq për jetën, xha Stefan? — pyeti Petroja.

Xha Stefani luajti kokën:

— Është e dhimbur e shkreta! — tha ai dhe u ul në vend. — Jo për vete, për fëmijën. Gjoka buzëqeshi.

— Prindi jeton e lutet për fëmijën, — tha Stefani.

Ai kishte tri vajza dhe të tria të martuara afër, se kishte dashur t'i mbante gjithmonë pranë. Gruaja që hyri atë mbrëmje në odë dhe u përshtëndet me miqtë, qe më e madhja vajzë dhe kishte ardhur më të parë. Dhe ajo martesë e afërt i kishte sjell Stefan Jorgjit gëzimin e ni-

1) Të mekurit, si të fikët. Vjen nga mungesa e sheqerit në gjak.

përvë dhe të mbesave, kur lozni në oborr... edhe kur donin t'i futnin duart në pjatën e sallatës apo dhe kërkonin të hanin me lugën e gjyshit. Petroja e pyeti në kishte ndonjë dhëndër komunist.

— Kam. Dhe gocën e kam.

— Janë komunistë, the?!

— Po. Pse?! — pyeti Stefani dhe pa nga ai. **Gjoka vështron te heshtazi.**

— **Çudi me njeriun, kur ndodhet i ndarë më dysh.**

— **Si më dysh?!**... Pa ma ftillo, — tha Stefani dhe u përkul përpëra.

— **Si puna jote: dhe me ikonën dhe me vajzen e dhëndrin komunist.**

Stefani ndenji ashtu i tendosur me qafën përpëra dhe pastaj papritur bëri zë t'i sillnin ikonën, por u kujtua se e shoqja kishte vajtur të thërriste **Stirin dhe u nis vetë**. Ai erdhë shpejt e shpejt, se deshi t'i kryente punët me një frymë e pastaj të ngushëlløhej, që nuk qe në vete dhe «pram!», ikona u gjend në zjarr. Dhe ai mend po mbetej **pa frymë, tek shikonte flakën që rrëmbente e skuqte figurën e konizmës**. Ajo qe një ikonë e vjetër dhe e zhulosur. Petroja mendoi se vlera e saj më e madhe do të qe po të digjej atë natë.

Stiri hyri e përshtëndetë. E shtrinte dorën pa kujdes, tek vështron te herë fytyrën e zbehtë të Stefanit dhe herë atë që takonte.

Stefani bëri shenjë nga zjarri;

— **Vdiq, Stir! Vdiq!**

— Të na rrojë Partia! — tha Stir. — Prandaj më qenke merakosur zotrote?! Dhe më ngrite natën, pale! — qeshi ai nën hundë — Hë! Dhe unë do ta djeg.

Macja férkohej pas oxhakut.

Ikona qe djegur përgjysmë dhe Zoja e Për-

vuajtur, virgjëresha Marie, përkulej si nga një shtrëngim barku dhe, dalëngadalë po zbehej e po mbruhej në një pllakë hiri.

Era e bojës së vajit të djegur krijonte bezdi. Gjokës i vinte për të vjellë.

Stefan Jorgji ngriti gotën.

VIII

Atë mbrëmje të vonë Artini u ul po tek ajo karrige, ku qe ulur skulptori këtu e një vit më parë, dhe u mbështet po tek ajo tavolinë e vogël në korridor. Që atëherë kishin ndryshuar shumë gjëra: fëmija qe më i madh dhe bënte gjumë të lehtë, **fotografia kishte mbetur po aty, si dika e rëndomtë mbi paretin e murit; ea copëra kartoni me hije e viza, të vendosura në mënyrë të çregullt në kornizë, përballë njëra-tjetrës, ngjanin më shumë si njolla të parregullta larsi sesa me një punë artistike.**

— Po këto, ç'i ke? — tregoi Artini me vështrim.

— Janë të Shkurtës. Nuk i sheh?!

— Të Shkurtës?!... Nuk i shoh.

— I hodhi skulptori.

— Dhe ti i mblodhe... — nënqeshi Artini.

Petroja mendonte se të gjitha ato skicë-ide boceti, duhej të ngjasonin dhe me bustin e Shkurtës, por ja që askush nuk ia kishte pranuar një përafëri të tillë.

— Çudi! Unë e shoh, — tha ai.

— Të duket sikur. Ta ka shpjeguar ai, prandaj. Të tjerëve do t'u duhet të lexojnë nga një

libër të tërë, përpara se t'i pëlqejnë ato dy-tri skica.

Petros i vinte çudi dhe përsëri ngulte këmbë në të vetën. Artini thoshte se formulat e shpjegimet i do shkenca. Veçori e artit qe ajo pjesëz e veçantë jete, që kishte të bënte me mendimin dhe shpirtin e autorit, e mbrujtur me të tërën. «Një arkitekti i prenë duart që të mos përsëriste më një vepër të përkryer arti. Ai qe shqiptar,» — tha Artini.

— Shqiptar?! — pyeti Elena. Ajo i harroi duart e arkitektit dhe po vështronë duart e veta.

— Po, shqiptar. Dhe vepra e tij mbeti e pa-përsëritshme; një mauzole në Agra të Hindisë, pranë lumit Xama, ku punuan njëzet mijë punëtorë për njëzet e dy vjet me radhë. Ka njëzet e dy kupola dhe në kupolën e portalit kryesor zëri jehon për gjashtëmbëdhjetë sekonda. Në agim merr ngjyrë trëndafili të zbehtë. Gjatë ditës me diell verbues, duket si një re argjendi, që lundron mbi tokë. Në netët me hënë, rrezaton në dritë të artë.¹⁾

1) Më 1630 shah Xhananit i vdiq e shoqja dhe ai, për të pérjetësuar kujtimin e saj, vendosi të ndërtonte në Agra të Hindisë një mauzole (Taxh-Mahall). Për këtë thirri në konkurs gjithë arkitektët e Lindjes dhe, ndërmjet të gjithëve, zgjodhi projektin e Mehmet Isait nga Opari i Korçës (për ndihmës kishte usta Mehmetin, edhe ky nga Opari). Ndërtimi i tempullit filloi më 1630 dhe u dorëzua më 1652. Si lëndë ndërtimi u përdor mermer i bardhë, gëlqere e kuqe, fildish, sedef, lloje druri të çmuar dhe korale, të sjella nga anë e anës. Taxha-Mahalli është një kryevepër mermeri të bardhë, midis qipshtesh me qiparise e parqesh me lule shumëngjyrëshe, që pasqyrohet në lumin Xama. Mauzoleu, së bashku me lulishten, e cila kishte kryarkitekt usta

Elenës iu duk sikur vërtet përvjetonte bukuri të tilla. Asaj iu kujtuan duart e arkitektit dhe, padashur, vështroi duart e Artinit. Ato iu dukën delikate. Ngriti sytë e pa nga Artini dhe buzëqeshi. Dhe Artini i buzëqeshi. Petroja e pikasi mendimin e së shoqes dhe tha: «Duart janë gjë e madhe, Elenë!»

— Po, po!... Po sesi të vjen ashtu, Petër, — mblodhi veten Elena. — Presin duar që bëjnë gjëra të bukura, paçka dhe në janë në ndonjë vend të humbur të Hindisë.

— Ndodhin dhe të tilla, — nënqeshi Artini paksa. — Prandaj nuk duhet të jemi dhe kaq delikatë. Po kështu dhe me një skulptor, nxënës të Zosimeas.

— Edhe atij ia prënë duart?! — pyeti Elena dhe pa nga ai. Elena kishte sy të mëdhenj. Artini qeshi e tha se nuk mund të ndodhë me cilindro e njejtë gjë. Skulptori kishte gdhendur në gur kokën e një grua. Kur mbaroi studimet e do të kthehej në Shqipëri, ia ndalën veprën.

— Pse?! — pyeti Elena.

— Në kufi, po. E quajtën hajdut, thanë se kishte vjedhur «kokën e Afërditës» në Greqi.

Elena për herë të parë dëgjonte për skulptorin, që paskësh vjedhur «kokën e Afërditës», perëndeshës së bukurisë, gruas me qafë të gjatë apo «qafë greke» siç quhej, të cilën ajo e pati ndëshur kaq herë nëpër reklama apo revista të zbulimeve arkeologjike. «Koka e Afërditës» ngja-

Isufin, edhe ky shqiptar, është quajtur «Poemë në arkitekturë», e papërsërithshme deri më sot në arkitekturën botërore. Kur Mehmet Isai përfundoi projektin dhe ndërttoi modelin prej druri, shah Xhahani urdhëroi t'i priteshin duart, të mos bënte më tjetër vepër kaq të bukur.

lli shqetësim dhe as donin të besonin skulptorin, që ngulte këmbë se e kishte punën e vet. U lajmëruan autoritetet e Athinës. U kontrollua dhe u vërtetua se skulptori kishte të drejtë. Dhe i, kërkuan falje. Dhe u habitën, kur ai filloi të qante mbi «kokën e Afërditës».

— Qau?! — pyeti Elena. — Përse qau?!

— Qau, po! Me dënesë, — tha Artini. — Qau dhë iku.

Ajo ndjeu keqardhje për skulptorin dhe kjo dukej nga sytë e saj, sy të qartë që vështronin në vezullim. Ai e kishte lënë atje, si një shëmtirë, «kokën e Afërditës», se kishte shëmbellyer punën e një tjetri, qoftë edhe të Fidias. Këtë ai nuk e kishte vënë re, prandaj qau dhe iku. Elena pyeti se ç'u bë me skulptorin.

— U kthye në atdhe, — tha Petroja. — Gdhendi gurë!

U duk sikur Elenës iu meh fryshtimarrja.

— E kam gruan ca të ndjeshme, Artin, — qeshi Petroja dhe përplasi gotën, — prandaj shpjegoja mirë ç'u bë, në është fjala për Cukallën, ose është xrezik që ime shoqe të mos flejë e qetë.

— Jo, pse?! — tha Elena dhe mbloodi veten.

— Po, për të është, — tha Artini dhe pa nga Petroja, që gjatë tërë kohës kishte dëgjuar me vëmendje atë tregim, të cilin ai e kujtonte si të padëgjuar. — Po kështu e ka arti, Elenë! Fillon te vetja dhe mbaron te të tjerët. Ura e Gjadrit të njihet që është e Gjadrit dhe jo e Artinit.

— Po, dhe fjala është për të veçantën, Elenë, — tha Petroja. — Ajo është një dhe vetëm një. Se ka kukulla në botë, që janë të përkryera, por përsëri...

Elena po e dëgjonte të shoqin sikur të qe

bërë tjetër njeri. Ai tha se Cukalla gdhendi gurë dhe béri portrete malësorësh andej nga i nxirrte gurët: «Gdhendi jetën në gurë mermeri, Elenë!» Ajo pa nga i shoqi dhe i erdhi mirë të përsëriste me vete: «Gdhendi jetën në gurë mermeri...», enë ca fytyra të uritura e të thara, të paepura, që vështronin vrërët e rreptas, më urrejtje.

— Epo në atë gjendje ai gjeti diç të vetën,
— tha Artini.

Asaj i qenë skuqur faget nga afshi dhe Petroja e vuri re...

— Shko, se do të digjen peshqit, Elenë!
Artini dalëngadalë nuk po e ndiente më atë drobitjen e atyre ditëve kur që marrë me llogaritë e pati nxjerrë se përsëri volumi i punimëve në hekurudhë pati rënë.

Elena shkoi e erdhi, e lehtë si një rabeckë, më një copë beze undër duar dhe kërkoi leje të shtronin tavolinën:
— Ja, u bënë! Më falni për vonesën, — tha ajo.

— Ouu, vonesa shton muhabetin! — tha Artini dhe u mënjanua mbi ndenjësen e karriges.

Elena filloi të shtronte nxituar mbulesën e tavolinës. Petroja vendosi shishën e rakisë dhe tri góta.

— Aksion është; këdhe vështirësi, — tha ai.

— Unë nuk të jam ankuar, — tha ajo.

Elena kaloi në kuzhinë dhe, tërë mëlef, mbante veshj...

— Amkohu, po deshe! — tha Petroja me të qeshur dhe i shkeli syrin Artinit.

— Unë të zgjodha vetë e nuk mërzitem, — tha ajo pas pak dhe ktheu peshqit. Peshqit po piqeshin. Ajo u gjend përsëri në bisedën e burrave dhe, tek rrinte e mbështetur anës derës, mbante ende pirunin në dorë. Përparësja e bar-

dhë dhe mëngët e fustanit, pak të përthyera mbi llërë, e tregonin si një vajzë të re.

— Ti gjene mirë, Elenë, por atje tek unë është një rrëmujë që... — tha Artini, duke shtrirë dhe më mbulesën e tavolinës. — Është një rrëmujë, që nuk e marr vesh as unë, — plotësoi ai mbas pak. — Vetëm Petroja mund të tregojë.

— Kështu është kur je pa grua, — tha Petroja.

Elena pà nga i shoqi. Ajo e dinte se Artini qe i martuar dhe me fëmijë. Vetë ajo nuk kishte kohë që banonte në hekurudhë dhe rrallë pati ndodhur të takohej me shokët e burrit, se gjithë ditën qe e zënë me punët e laboratorit në fabrikën e letrës, pak larg qytetit, dhe, kur kthehej, merrej me fëmijën.

— Mirë që ia di vlerën! — i bužëqeshi ajo të shoqit, kaloi përsëri në kuzhinë dhe humbi mendjen pas gatimit. Ajo hodhi peshkun në pjata, e spërkati me vaj e uthull rrahur bashkë dhe e vuri përsëri në tjegull. Kjo do të qe dhe pjekja e fundit.

— Ashtu është, — tha Artini. — Dhe mua, kur më vjen Jeta...

— Cila?! — pyeti Elena nga kuzhina.

— Gruaja. Dhe, kur i vjen gruaja, ia di vlerën, — ngriti zërin Petroja dhe i shkeli përsëri syrin Artinit.

Në të tilla raste ai tregohej i çiltër. Elena qe rreth të tridhetave. Ato ishin vetëm tri motra dhe i ati ankohej shpesh se po i humbte trungu familjar. Edhe ai kishte qenë djalë i pavëlla. Elena i kishte dhuruar tre fëmijë të mirë e të bukur. Dy të mëdhenjtë i kishte lënë tek i ati dhe vetë kishte ardhur me të voglin. Me të shqin kishte dhjetë vjet ndryshim e përsëri atyre u dukej se ishin dy shokë të mirë dhe shkonin

aq shumë me njëri-tjetrin, sa harronin dhe disa mirësjellje që duheshin në sy të tē tjerëve. Në motin e parë të martesës, Elena i pat tërhequr shpesh vëmendjen dhe Petroja, aty për aty, kujtohej, por nuk kalonte kohë dhe ai përsëri harronte.

Ajo solli dy pjata me peshq. Artini u mënjanua t'u linte vend duarve të shkathëta të amvisës.

— Ohoo! Kryevepër, — tha ai.

— Ju bëftë mirë! — gjegji Elena, me krenari. Ajo nxitoi e solli nga kuzhina edhe dy pjatëza me fasule, të ftohta, me pak piper, e vaj ulliri përsipër. Mandej vendosi përpara seçilit, nga një shamizë e piruni. — Të na falni, me ç'na u ndodh! — tha amvisa, dhe mori gotën.

— Të lumshin duart! — tha Artini.

Elena u largua. Dy burrat mbetën vetëm, dhe përplasën gotat. Peshqit ende nxirrin avull. Era e uthullës të ngacmonte.

— Të shoh ndonjëherë me djalin, tek drejton makinat, — tha Artini.

— Epo... E kemi ca të vëشتirë, — i përtypi Petroja, fjalët nëpër dhëmbë. Elena solli një tu-fëz qepë të njomë dhe djathë. Ai i pari shtriu dorën, mori qepën e njomë dhe ftoi mikun të ndiqte shembullin e tij. — Bëre mirë që i prure, Elenë.

Elena i buzëqeshi. Ai u clir. Ajo pa nga miku:

— Të mos ankohet më, prandaj.

Artini miratoi vetëm duke luajtur kokën.

— Unë tē kam kujtar baba të mirë, por ti e paske pasur nga halli! — tha ai.

— Mos u bëj, po deshe! — u shkrythi Petroja, dhe vështroi nga e shoqja. — Çerdhja ka kërkesa të shumta, siç thonë.

— As prishet puna për një më tepër. Ai vullnetar është, apo jo? — ngacmoi Artini.

— Po, po! — nënqeshi Petroja.

Ata bçokën përsëri gotat. Duket Elenës nuk i erdhi mirë dhe u largua, pa e ngarë fjalën më tej. Petroja qeshi nën hundë dhe pa nga kuzhina. Inxhinieri e ndjeu veten të çlirët në atë ngrohtësi familjare. Piu një gllënjkë raki dhe hëngri shumë meze. Ai ndjeu se nuk po ngjante më me Artinin si inxhinier.

Kohë më parë pati ndodhur që t'i mbronte bindjet e veta me ngulm dhe nuk pranonte bisedë me asnjë që nuk njihte problemin. Në fillim kjo i solli ngatërresa. Thänë se nuk përfillte vijën e masave dhe u zhivillua një bisedë e thekshme. Ai kalonte rrugës i shkujdesur dhe dukej paksa i dobësuar. Dikush hodhi dhe romuze se inxhinieri, për hir të shkencës, kishte mbetur dhe pa rruar! «Të mos pranohen vullnetarë në hekurudhë?!» — pyeti inxhinier Tosuni, sikur t'i dilte zëri nga hundët. Në të vërtetë atij i pëlgente t'i thërrisin Tomka. «Të mos pranohen kaq shumë, — theksoi fjalën Artini dhe picërroi njërin sy, se e ngacmoi tymi i cigares varur mbi buzë. — Kushton një djall e gjysmë! Sa të ndërtosh një tjetër hekurudhë, me mjete!» Tosuni u duk sikur pati një të qeshur të pandier. Ata u panë sy në sy. Ankthi qëndronte pezull. Në zyrën teknike pati hyrë një flutur dhe, paçka se dritarja qe hapur, ajo vinte vërdallë e nuk dilte jashtë. «Mos do të vëmë kokën tië kandar me politikën e shtetit?!» — turfulloi Tosuni. Nga dritarja hynte ajër dhe dilte jashtë tymi i cigares Artinit thua se i qenë ngritur qimet e mjekrës përpjetë dhe frymëma rrja i qe rënduar. Atij i thanë: hekurudha kishte kuptim më të madh nga ç'e mendonte ai. Artini tha: «Ky është mendim mikroborgjez: më fjalë politike kërkon t'ia hedhësh dhe vetes dhe shtetit! As hekurudha dhe as socializmi nuk ka ne-

vojë për dembelë, Tomkë! Ti i mëson vullnetarët se socializmi ndërtohet edhe pa mund, mjaft që të kesh dëshirë.» Inxhinier Tosunit i qe zverdhur hunda dhe sytë i lëviznin pa vend e cak. «Dhe për këtë do të përgjigjesh, Artin!» Ai u çua dhe doli jashtë i nxituar. Mbas tij dera u mbyll dhe çdo fjalë mbeti e këputur në mes. Petroja mendoi se Artini vërtet e vuri kokën në kandar me politikën e shtetit dhe ky qe një guxim budallai. Mendimi u rrah në organizatën-bazë të partisë dhe që atëherë vullnetarët vinin të ullgaritur.

- Kam ftuar Gjokën me gjithë të shoqen,
- e theu Petroja heشتjen.
- Sa mirë! — tha ajo.
- Duhej.
- Cili është ky Gjoka? — pyeti Artini.
- Ai që ka ardhur me gjithë gruan, Regën,
- tha Petroja.
- Rega?!
- E shoqja, — shpjegoi përsëri Elena.
- Kështu quhet, Rega.
- Rega është quajtur e bija e Balshajt, të Dytë, — tha Artini.
- Problemi i tij është delikat, — theksoi Petroja.
- Nuk ka aq rëndësi për veprën, — tha Artini.
- Petroja e vështroi Artini piu raki dhe çukiti në mezen e peshkut në majën e pirunit. Elena e pa prerazi. Edhe Petroja çukiti meze, pa vetëdije.
- Sa e bezdishme do të që jetë, po të shikohej në leverdi është secilit, me dy lekë më tepër apo dy lekë më pak, — shpjegoi Elena, kur vërejti se Petroja me heshtjen e vet shprehu një lloj pakënaqësie ndaj inxhinierit. — Bile unë do ta quaja borgjezë.

Elena fliste e shqetësuar dhe tiparet e saj dukëshin ca më të arrira: ifytyrë e grunjtë, paksa e hequr e ca muskuloze, buzë të fryra e vetulla të rëna poshtë. Anëgushe Artini i vuri re një nishan dhe iu kujtuat nishani i vogël i së shoqes, që e kishte mbi faqe. Zëri i saj u qetësua dhe la të kuptohej se vlera e njeriut është së pari në moralin e tij. Artini vërejti se aq gjë nuk duhej tepruar, por duhej gjykuar në vlerën e vërtetë të saj, se po bëhej e modës të jepeshin më shumë mend se punë. Dhe kjo që një turp: «Ende mesatarja e punimeve në hekurudhë nuk është arritur, Petro. Dhe na rrofshin mendtë! Krahasoje, pra, problemi e një hekurudhe me problemi e një Gjoke!»

— Unë do të thosha se është po aq i rëndësishëm, — tha Elena.

— Vetëm nuk duhet të harrojmë punën e të shfajësojmë veten: jo pse erdhi me gruan apo pse rri me motrën! Sikur të kemi marrë përsipër që në një muaj e gjysmë të pastrojmë Gjokën. Nuk e di në më kuptove, Elenë. Më parë jemi gati të gjykojmë për veprimin e tjetrit sesa për punën tonë.

Artinit iu duk sikur i tha të gjitha fjalët me një frymë, mori gotën dhe e çoku me secilin në tavolinë. Dhe Petroja ngriti gotën e përshëndeti, duke e lëvizur pak në ajër.

— Megjithatë duhet mbajtur qëndrim: një druajtje mund të të humbasë të drejtën ose një budallallëk, i veshur me shumë lajle e lule, të prish mendjen, — tha Petroja.

— Sigurisht, — nënqeshi Artini, — sigurisht! Këtu ka të bëjë dituria, guximi dhe besimi përsa je i vendosur, ndryshe...

Elenës ajo nënqeshje iu duk si një mospër-

fillje, nuk i erdhi mirë dhë endërpreu ende pa e mbaruar fjalën:

— Po ju kujtoni se gjërat e vogla nuk sjellin përmbyse, inxhinier?! — tha ai.

Dhe ky qe një guxim. Inxhinieri tha se dënuari, zakonisht, përpara pushkatimit kërkon cigare. Kështu kishte qenë gjithmonë. A mos me gjithë mend i pihej cigare?! As i binte ndër mend, por donte të zgjaste jetën sadopak. Dhe kjo puna e shfajësimit... Artini la gotën në tavolinë dhe gërmoi me majën e pirunit copa nga trupi i peshkut.

— Kush do të përgjigjet për punën tënde, Petro?!

— Petroja heshti.

— Ti! — tha Elena.

Në zërin e saj u duk një notë talljeje, sikur deshi të thoshte: A mos kujton se do të përgjigjesh ti?! Në një çast Petroja kroi zërin. Artini buzëqeshi nën hundë:

— Hë! Mirë do të qe. Bile do të qe më mirë, sikur të tjerët të përgjigjeshin dhe për dobësinë tonë.

Tymi i cigares thuajse mbushur korriderin e vogël. Elena e vuri re dhe shkoi të hapte paksa kanatin e dritares. Zëri i Petros u ngatërrua me të kërgiturën e kanatit dhe Elenës iu duk nisi, një zë i thyer: «Nuk shtrohet problemi ashtu, Artin! Nëse ti nuk pranove dikur shumicën e vullnetarëve, se nuk kishte mundësi organizimi në frontin e punës, nuk besoj se deshe të veçoje problemin ekonomik nga ai i edukimit. Tani më duket... Prandaj Elena këtu ka të drejtë.» Elena nuk dëshi të ndodhej kur flitej për të dhe bëri sikur merrej me punë në kuzhinë. Ajri po ia freskonte ballin, por çuditërisht faqet i ndiente më të nxehta. «Ndofta

me ndonjë teprim të vogël, ashtu është, Elenë! — e ngriti Petroja zérin: — Djalli e mori po të gjykohet fati i njeriut për një lek më shumë apo dy më pak! Dhe kur mendon të trajtohen të dyja, secila në masë të duhur!» Ajo nuk iu përgjigj.

— Këtu qëndro: në masë të duhur.

— Po! — tha Petroja.

Elena përgjoi dhe i erdhi mirë që i shoqi po përsëriste mendimin e saj dhe po e gjente me vend e mbrohej me të. Ajo vetiu u afrua te dera. Artini tregonte se njihte një njeri që donte dhe tre-katër vjet të dilte në pension dhe askush nuk përgjigjej për paaftësinë e tij, se nuk kishin ku t'i gjenin një tjetër vend të përshtatshëm pune. Ky quhej Visar. Visari dukej i zoti: fliste e shtronte probleme edhe pa pasur njojurinë e duhur... Kështu që socializmit i duhej të vuante paaftësinë e Visarit, sa të dilte në pension!

— Sonte u bëra fjalaman dhe dashkam të pi! — tha Artini.

— Ouu, të lutem! Ne jemi në shtëpinë tonë, — tha Petroja dhe kapi gotën. — Gëzuar!

— E zonja e shtëpisë nuk po pi.

Elena mori në çast gotën e të shoqit.

— Është gota ime, — tha Petroja.

— S'ka gjë! — tha ajo dhe e toku me Artinin. — E zonja e shtëpisë është e kënaqur, kur miku e nderon. Gëzuar!

Këtë herë Elena vërtet piu pak, se radhët e tjera vetëm sa pati lagur buzën. Asaj i vinte mirë nga qëndrimi i çlirët i Artinit.

— Ti kërkove gurë të thyer për markën e betonit, Petro. Ende nuk të janë përgjigjur.

— Duket nuk janë të bindur se mund të arrihet.

— Aaa?! Dhe mua më duhet të vuaj për

këtë?! Dhe të humbas mendjen, duke u marrë me Gjokën e të përligj dobësinë. Kanë ardhur përpunë vullnetarët e të edukohen nëpërmjet punës, ndryshe... Urdhëro e shtro probleme dhe ha fjalë!

— Po ju, e mendoni Gjokën në ç'hall është?!
— pyeti Elena me mllef.

Zakonisht Artini të tilla raste nuk i linte të kalonin shkarazi, por ja që aty për aty e harroi mendimin e mëparshëm: «Sigurisht!... Ah, po, sigurisht ndaj gjërave të mëdha duhet treguar vëmendje!» Ai e ndjeu shqetësimin e Elenës dhe në zërin e saj seç dalloi një timbër që dridhej, kur tha se nuk mund të pyetej se cilën duhej të mbanin: hekurudhën apo Gjokën. «Edhe Gjokën, po!» — tha ai. «Gjokën?!» — pyeti ajo vetiu. «Për aq sa duhet, sigurisht,» — tha Petroja.

Artini u çua, uroi dhe mori të ikte. Elena kërkoi të falur. Ai mbeti te dera dhe tha se do ta mbante mend këtë natë tepër familjare. «Nuk e harroj dhe një rast në Përmet, te një shoku im,» — shtoi ai dhe u përshtëndet me Elenën.

Jashtë bënte të ftohtë. Ata kaluan urëzën e drunjëtë dhe Artini mori të shpejtonte:

— Natën e mirë, Petro! Nesër...

— Prit, se po të përcjell. Nuk kam gjumë...

Ata nisën përsëri bisedën. Petroja gazmohej si fëmijë. Duhej gur i thyer me përmasa të ndryshme për të arritur të përftonin vlerën e betonit të cilësisë së lartë. Dhe kjo nuk duhej vonuar...

Elena ndjeu çelësin e derës, tek e mbylli Petroja. Ende nuk kishte rënë. Ajo kishte larë enët, kishte veshur rrrobën e natës dhe po mblidhite flokët me biguti. Petroja hapi derën e dhemës së gjumit, pa më parë të shoqen dhe

iu afrua, tek ajo mblidhte tufëzat e flokut. Ashtu, me flokë të mbledhur, gjithmonë Petros i qe dukur më ndryshe, sikur të qe një fëmijë dhe më e padjallëzuar. Nga pasqyra ajo pa kokën e të shoqit që iu afrua pranë dhe u mënjanua paksa. «Rënke era peshk!» — i tha ajo nazike. Petroja e rrëmbeu të shoqen ndër duar: «Hoho! Peshk, pos!» Elena, imcake siç ishte, ia hodhi dorën në qafë dhe u mblodh kruspull në krahët e tij, se e dinte që Petroja do ta rrotullonte dhe mandej do ta hidhte në krevat: bum! Krevati do të lëkundej dhe ajo do të kalamendej. Tek qeshej, buzët e saj mblidheshin, hundëza tkurrej e sytë sikur picërröheshin paksa me një vështrim ngacmues:

— Mos, Petro, mos! — tha ajo.

Petroja e ndali vrullin.

Elena u mek në gjoks të tij: «Mos, se na zgjohet djali!» Kështu flinin ata, të tre në një krevat.

Petroja. Ajo. Dhe djali.

IX

— Marta, Marta!... Mos qaj, Marta!

Asaj nate Marta qe kapitür nga një èndërr. Iu duk sikur ai, gjarpri beronjë¹⁾, fluturonte dhe ajo vraponte bjeshkës dhe... sa më shumë vraponte, i priteshin fuqitë dhe tërhiqeje zvarrë e zvarrë... Dhe mandej i dukej sikur fluturonte dhe

1) gjarpër shigjetë, shumë idhnak, gjahun e godet me kërcim në ajër.

ajo e hidhej nga shkëmbinj të çuditshëm dhe binte ndër pllaja, ku shendonin bletët ndër lule. Po gjarpri beronjë e ndiqte dhe e ndiqte. Ajo u fsheh pas një bredhi. Gjarpri beronjë e shpoi edhe bredhin edhe atë, tejpërtej. Pastaj iu mbarua fryma dhe... ëndrra iu ngatërrua keq. Iu duk sikur po qante, atje rrëzë bredhit te Bjeshka e Hirtë.

Lora e përmendi dhe Marta u kthye në anën tjetër.

— Je pa fjetë, Lorë? — pyeti Rega.

— Po fle, — tha ajo. — Po ti?

— Gjoka më ka thanë me e pritë nesër, herët.

Lora nuk e kuptoi se ç'deshi të thoshte maledorja. Një vajzë qeshi në gjumë, një tjetër tërroi vëmendjen se bëhej zhurmë. Lora tha: «Fli, se është vonë, Regë!» Dhe Rega u kthye në anën tjetër, duke i uruar gjumë të ëmbël.

Lora rrekej të gënjeni veten se duhej të flinte dhe filloi të numëronte pa mbarim. Ashtu i kishin thënë të bënte, kur nuk kishte gjumë, por herë pas here, midis numrash, hynte Kujtimi... dyqind e pesëdhjetë e tre. Jashtë kishte yje, kishte hënë. Kishte dhe errësirë. Dhe hënën, dhe yjet, dhe errësirën e kishte nata... dyqind e pesëdhjetë e katër, dyqind e pesëdhjetë e shtatë, Bujari është fëmijë dhe... dyqind e nëntëdhjetë e shtatë, punë e madhe në u rritëm bashkë! Njëqind e shtatëdhjetë... Genci u zemërua kot. Ai është shok i mirë dhe kjo nuk do të thotë... shtatëmbëdhjetë, tetëmbëdhjetë, pastaj yjet do të shkrihen... Na ishte dhe një përrallë për një vajzë, që deshi të shihte lulen kur çelte dhe u ngrit herët... Nesër unë do ta takoj Gencin dhe do t'i kërkoj të falur, të tjerat janë punë boshe! Hë, ajo vajza dremiti dhe iu duk sikur lulja po çelte. I tha vajza lules: «Përse u ngrite kaq vonë?!»

I tha lulja vajzës: «Vërtet?! Unë u qova me die-llin!» «Hajt tani! Natën e mirë!» — i tha Lora vetes dhe filloi të numëronte nga e para.

Asaj nate Gjoka ndjeu angështinë e erës së ngrohtë, ndonëse mëngjesi kishte ardhur i fresskët. Pa nga qelli dhe retë iu dukën si lëvere të shtrydhura: kishte dy javë që natën binte shi dhe ditën mbante kohë e mirë. «Në male, shiu litar dhe toka behar!» — belbëzoi me vete, aty tek priste Regën. Pastaj i shkoi mendja për sa thoshte një këngë e kënduar me gënetë: «Fusha gatuan bëtë, mali bën furtunë!» Kënga bënte fjalë për një vajzë që shkonte të luftonte maleve. Në Myzeqe kishte baltë. Gatuhej baltë. Dhe Gjokës iu duk se kënga ishte thurur enkas për bal-tën e fushës dhe furtunën e malit.

Gjoka prit dhe Regë s'ka.

Qe ende herët.

Nga sytë dukej i pagjumë. Ra dhe boria e zgjimit. Gjoka vuri dorën te vendi i mustaqeve dhe, ndonëse e dinte që mustaqe nuk kishte, filloj të ndukte me shqetësim atë pjesë të sipërme të buzës. Pastaj hoqi dorën dhe mori rrugën për jashtë qytezës. Roja e pyeti në do të shkonte te batipali, por Gjoka nuk i dha përgjigje. Balta ishte e keqe dhe i ngjitej nëpër këmbë. Qyteza po zgjohej dhe Gjokës i shkoi mendja te shokët, që do ta prisnin te batipali, ndonëse ishte e diel. Atë ditë duhej të ngulnin pesë pilota një mbi normën. Të nesërmen do të bënin pushim dhe në mbrëmje do të fillonte turni i natës. I vështirë ai turn, por dhe i bukur. Gjoka e kishte prouar: po t'i largoheshë dritës së elektrikut, nuk mësoheshe lehtë me errësirën e mund të

mos e shihje as shokun pranë. Atij i vajti mendja te Rega dhe iu duk sikur ajo rrugë e sheshtë po i rëndonte gjunjët. Në male ai ngjitej e zbriste shpejt. Këndeje kishte vetëm fushë e rrugë. Ai zbriti nga malet me Regën (Na ishte njëherë: Rega, Ega! Një grua që endej e çapitëj dhe ec e ec... Gjoka para dhe Rega mbas. Atje tek ura e Mirdekës Gjoka qëndroi. Rega iu afrua, ai e pushtoi në parzëm dhe pëshpërimat mbetën nëpër ag: «Nuk do të ndahemi kurrë, Regë!» «Jo, askurrë!» «As në udhë hekuri!» «Mos, Gjokë, mos!» A nuk po ndien za?» Atë mëngjes kishte shumë njerëz dhe agu qe mbushur me zëra) Ai zbriti nga malet me Regën të ndërtonte rrugë të hekurt dhe në fillim iu duk si çudi që treni kalon midis baltës. Më lehtë do ta besonte se çan midis malesh: kjo po, ishte një punë e madhe për trenin e hekurt dhe, po të mundej, ai do ta ngjiste bjeshkëve, ku nuk kishte baltë dhe frynte furtunë.

Ndali një makinë dhe Gjoka hipi lart. Ende pa zënë vend mirë në ndenjëse, ai ndjeu drithërimën e motorit t'i vinte nga këmbët e t'i përqethët trupin. Kjo iu duk si një pështjellim e nuk e dëgjoi mirë shoferin.

— Fole gja? — tha Gjoka.

— Pyeta ku do të shkosh, — tha shoferi dhe luajti marshin.

— Në Rrogozhinë, — tha Gjoka i lehtësuar nga ato dridhje e dalëngadalë po merrte veten.

Traseja dukej sikur vraponte në të kundërtën e rrugës së tij dhe pemët mundoheshin t'i fshihezin mbas krahëve. Gjoka nuk pa asnjë vullnetar të punonte në trase. Ishte e diel. Ai përbluante gjithfarë mendimesh. Rega do të ishte me shoqet. Usta Petroja do ta shihte e do ta pyeste për të. Për Gjokën, se nuk kishte qenë atë ditë te

batipali. Dhe ajo do tē ūte kokën. Apo do tē qante?! Hë, më mirë tē qante... Tē qante. Shoqet mandej do tē përgojonin «marrinë». Marrinë e saj apo... Shokët do tē tregonin se kishte qenë në hekurudhë një vullnetar. Atë e quanin Gjokë. Ai erdhi pér tē punuar dhe la tē shoqen...ahaha! Gjoka kujtoi Regën, i pérhumbur.

Nën dritat elektriqe shiu dukej si litar uji, që zbriste nga lart. Rega po i përkëdhelej dhe ia kapi gishtat ndër gishtat e vet. «Ku shkojmë, Gjokë?» — tha ajo me pëshpërimë. «Ma ngadalë, se ndien nata!» «Cila?!» «Nata. Natën zani ndihet ma tepër,» — tha ai si heshtazi. Ajo iu afrua pranë, sikur ta kishte frikë natën dhe Gjoka, thua se po ia ndiente frymëmarjen në kraharorin e vet. Shikoi fytyrën e saj dhe krelat e flokëve që i dilnin nga shamia dhe i vareshin témthave, i qenë vesuar nga pikat e shiut nën strehë. Në raste tē tjera as do ta kishte vënë re, por në atë zhurmën e shiut, gishtat, e saj zgjuan tek ai gjithë vëmendjen dhe pëshpëriti: «Rega... Ega!»

Dhe atij iu duk sikur po e priste ende tek ajo strehë. Apo qante tek ajo srehë. Dhe do t'i fshinte lotët tē mos ia shihnin. Dhe Petroja atje do ta gjente e do ta pyeste përsë Gjoka nuk ishte te batipali. Atje e prisnin shokët. Dhe Petroja do t'u tregonte shokëve...

Shoferi lëvizi levën e marshit dhe makina u drodh lehtë.

— Po Ilin e njeh? Gazetar — tha ai. Ai po tregonte se kishte qenë vullnetar.

— Ah, po! — u përmend Gjoka. — E kam parë.

— Dhe që thua ti... Si ta thonë emrin?

— Gjokë!

— Eh, Gjokë! Kam kohë që nuk e kam takuar, se jam në udhëtim, por, kur zbritën vajzat nga malet, ky Ili na i mori në pyetje. Dhe e di çfarë u tha?! «Përse erdhët në hekurudhë?» Njëra kishte qeshur. Ke dëgjuar pyetje të tillë ti?! Kështu e bëri dhe me një shokun tim, shofer. Qe ai që u hodh nga ura për të shpëtuar minatorin. E di?! Nuk e dinte gazetari si të vinte po të hidheshe nga ura poshtë e të shkoje drejt minave, hahaha! — qeshi shoferi dhe e pyeti përsëri si e quanin.

— Gjokë! u përgjigj ai dhe e pa vëngër. Iu duk vetja i huaj me atë shofer që i harroi emrin.

— Mua më quajnë Neki, — tha shoferi.

— E gëzofsh e mos t'u harroftë emni! — tha Gjoka.

— Të falem nderit! — tha shoferi dhe mbeti një çast, duke menduar për këtë lloj urimi.

— Dhe kështu, o Gjokë, Ili bëri pyetje budallai, por ama dhe shoferi nuk ia përttoi: «Hidhu vetë e ta provosh!» Kështu i tha e më plaçin sytë, në të génjej! E ku kishte kohë ai të ndiente kur u hodh nga ura?! Dhe as tregim bëri Ili dhe as... — desh tha një fjalë të rëndë Nekiu, pa e vrarë mendjen në do t'i pëlqente Gjokës.

Gjoka nuk po e dëgjonte më dhe zhurma e motorit iu duk e zakonshme... Një zhurmë e zakonshme, që ngatërhohej me përfytyrimin e tij. Ai do të arrinte në Hiraj në mugëtirë, kur dielli do të humbiste mbas bjeshkës. Çan Buçi do ta pyeste për Regën. Ai do t'i thoshte se mbeti atje. Çan Buçit do t'i binte një hije në fytyrë. Hije e vrërrët. «E ti, me leje?!» «Jo, ika!» Plakut do t'i dridhej njëra anë e mustaqes a do t'i vetonte njëri sy: «Ike fshehur?! Burri s'i kthen shpinën plumbit dhe ti...» E kush do të përgjigjej në kuvend

përpara shokësh?! Ai e la Regën në rrugë të hekurt... puh! Çan Buçi i Hirajt do të hante veten nga turpi... puh! Ai kishte një djalë, që nuk kishte burrni. Dhe Gjoka e ngjasoi veten me orlin qafërrjepur¹), që nuk e hapte dot sqepin për të mposhtur gjahun edhe nëse me kthetrat e veta mund ta shqyente... puh! Gjahu nuk ishte më i tij dhe orli, mbas gjithë asaj lufte në jetë, rrekej e shuhej duke u bërë gazi i vetes... puh! Ish-te dhe ajo këngë e vjetër vaji, për Urën e Mirdekës, që vinte si jehonë e një kohe të largët:

*Te Ura e Mirdekës,
Ku buron një gurre,.
Mos e lini gruan,
Të pijë ujë në gurre.
Qan me gurren syri i saj,
Ajo lotin lan!
Mos e lini të pijë ujë,
Se për burren qan!
Qesh me gurren syri i saj:
Gushë e faqe lan!
Mos e lini të pijë ujë,
Qesh me ashikzanë!
Te Ura e Mirdekës,
Te Ura e Dekës së Mirë,
Mos e lini gruan vetëm,
Se është e pahirë!*

Do të qe mugëtirë. Ai do të kthehet në fshat dhe babai do të ulte kryet e thinjur: «Unë kisha një djalë. Gjokë ia thoshin emnin. Unë e porosita... Ai harroi dhe shiti trimni!»

1) Shpend i egër, jetëgjatë. Kur plaket, sqepi i sipërm i kthehet, dhe i kalon nën sqepin e poshtëm, pa e lënë të hapet, dhe kështu orli shuhet nga uria.

— A mündesh me ndalë, shofer? — tha Gjoka papritur dhe kapi dorezën e derës. Shoferi e pa dhe nuk e kuptoi rrëmbimin e tij.

— A nuk do të vish në Rrogozhinë?! — pyeti ai.

— Jo!... Kam harrue me i thanë gruës diçka.

Shoferi u hutua për një çast dhe ndali makinen. Gjoka zbriti. Shoferi nisi rrugën dhe vazhdoi t'i binte borisë nëpër kthesa.

Gjoka u ngjit në trase dhe filloi të shpejtonte përmes trarëve të drunjtë, midis dy shinave të hekurta.

X

Ata lanë qytezën mbas.

Nga larg dalluan usta Petron tek po merrej me batipalin. Gjoka nuk dukej. As kur u afriuan nuk e panë dhe shqetësimi filloi t'u rritej. «Do të ketë mbetur në bujtinë i harruar,» — tha Kujtimi. Të tjerët këmbyen vështrime dhe shpejtuan të përshëndesnin ustanë. Mandej filluan të shkundnin baltën e këpucëve. Shtroja e dërrasës u kërciste nën këmbë. Çekici i batipalit kishte mbështetur kryet mbi pilotë. Petroja diç çkolistë te friksioni dhe i frynte një bulone. Bisedat qenë të thata: ca fjalë, që duheshin thënë. Ariani vazhdonte të kruante baltën e këpucëve. Bujari mblidhë gurë të vegjël dhe i hidhte në përrua. «Rega do të shkonte në ekskursion.» — tha Kujtimi dhe pa nga Petroja. Ky, kinse nuk kishte dëgjuar nga biseda, pyeti se ku kishte imbetur Gjoka. Kaq e pati heshtja dhe cilido që gati për të thënë diçka.

— Do tē jetē pa qejf, shpejtoi tē përgjigjej përsëri Kujtimi.

— Jo, usta! Do tē largohet, — tha Bujari.

Kujtimi e pa vrërët. Qenë orët e para tē një mëngjesi tē lagësht. Puna ende nuk kishte filluar dhe Gjoka hyri si pykë në mendimin e tyre. Dukej sikur tek ata vinte ftohtësia e tokës së lagur. Bujari shfreu me një fërshëllimë tē zgjatür: «Shko e mbushi mendjen malësisë se hekurudha është kudhër e kalitjes!»

— Nuk besoj tē ketë ikur, — tha Ariani.

— Hamendjet leri kur tē shkosh pér tē fjetur, — ia preu Bujari sakaq.

Petroja dëgjonte i shqetësuar. Ngjarja sa nis tē gërshtetohej dhe, aty pér aty, u shkoq si litar prej rëre. Ai urdhëroi tē bëheshin gati e tē iknin. Ata mbetën në kureshtje. Dukej sikur fryma u mbahej vetiu. «Nuk do tē fillojmë punën?!» — pyeti Ariani. «Është e diel dhe ju jeni tē lodhur,» — tha Petroja.

— Faleminderit pér kujdesin, — tha kujtimi i fyer. Ai qe skuqur, futi duart në xhepat e xhakëtës dhe, tē mbledhur grusht, i rëndonte më po-shtë. — Nuk jemi karavidhe, usta!

— Nuk është punë karavidhesh.

— Të na sjellësh deri këtu dhe tani...:

— Unë thashë është e diel. Kështu?! — pyeti ai shkurt.

— Po dhe rrëmbehem, usta. Të rinj jemi, — vërejti Ariani.

Kujtimi rëndonte edhe më duart ndër xhepa, si tē donte tē ngultë këmbë në vend e tē mos lë-vizte më: «Kështu, usta, kështu! Ne kemi ardhur tē punojmë.» Petroja vuri rë se ata u morën vesh me një vështrim.

— Te friksioni¹⁾ do të rri unë, — tha Bujari.

— Ku do të rrish?! — pyeti Petroja.

— Te friksioni.

Ata u panë sy më sy.

— Hë, trim i madh zotrote! — tha ustai.

— Aq sa jam.

Bujari mënjanoi vështrimin dhe u largua dy hapa më tej.

— Mos ki frikë, usta! — siguroi Ariani.

— Rrezikon kokën. Gjoka ia ka marrë dorën.

— Nuk është punë Gjoke kjo! — ndërhyri prerazi Kujtimi. — Po të qe për të, as kishim ardhur. Ja, kështu! Dhe ti mendo si të duash. Si të duash, — përsëriti ai.

Ustai nuk dha urdhër dhe as foli më. Ai ktheu krahët dhe i lai të vendosnin vetë. Gjendja qe e vështirë. «E, o mistrec?!» — pyeti Kujtimi me përkëdheli. Bujari i shkeli syrin: «O unë, o ustai! Nuk mundet dy trima në një vend,» — qeshi ai. Kujtimi tërroqi vëmendjen e të tjereve. Ariani doli në anë të kolonës. Agushi, përbalë. Fatosi pyeti në qenë gati. Gati. Gati. Petroja hetonte me vështrim. Bujari i buzëqeshi. Kujtimi luajti kokën.

— Kujdes pilotën! — tha Petroja. Ai sakat u ngjit te litari i ndezjes me mendje se ky grup po kalonte në prova të rrezikshme dhe, po të mos i përfillje, do të vriteshin në sedër. — Gati, dje ma?! Ke punën më delikate, Bujar!

— Gati, shokë?! — urdhëroi Kujtimi. Zëri i tij nuk duronte më fjalë të tepërtë.

Petroja tërroqi litarin e ndezjes dhe u ndje zhurma e një çekiçit që u përplas mbi pilotë: Bam-bam! Bam-bam! Gjithë frikë e kujdes, Bu-

1) rregullator, ka të bëjë me ngritjen e çekiçit në masa të caktuara

jari shihte friksionin. Në fillim çekiç i ngrihet pak e godet lehtë, sa të zërë vend pilotë. Mandej ai ngjitej e ngjitej dhe shkëputëj me forcë: «Bam!» Ndërkohë atyre u duhej të përgjonin për të mënjanuar çdo defekt.

— Si thoni, do t'ia dalim?! — pyeti Kujtimi.

— Patjetër! — tha Ariani. Ai pastroi ca vendin dhe u ul, duke kapur gjunjët midis krahëve të fuqishëm. Ashtu ai dukej me pamjen e një njeriu që mundohet të përbajë vrullin e forcave të veta.

— Ta dijë edhe Gjoka, — vërejti Agushi.

— Nuk është punë inati. Të çmend koncepti, — tha Ariani.

Bujari heshtte me drojë te friksioni dhe vështronët çekiçin. Ënda ia kishte të dëgjonte. Fatosi pyeti përsë iku Gjoka. «Kishte koncept, pra! Dhe u çmend. Nuk dëgjon ti?!» — tha Agushi. Ai ka pi njérën anë të mjekrës në dorë dhe u mundua të kërciste rruazat e qafës. Fatosi hapi sytë pa kuptuar kurrgjë. Kurrgjë: copëra bisedash, ca të fryra jashtë mase dhe ca të hedhura tej, si rrëcëka.

— Pilota po ecën majtas, Fatos! — tërroqi vëmendjen Bujari dhe ngriti dorën lart.

Fatosi e Ariani morën nga një dërrasë dhe e vendosën midis kolonës e pilotës. Dërrasat e shtytjes ishin të shkurtra dhe tronditja e batipalit vinte si një kërcënim i prerë. Ata e ndienin tronditjen në duar, në shpatulla dhe shtrëngonin nofullat për ta mposhtur. Frynte erë e lehtë. Bulëzat e djersës ftoheshin mbi ballë. Kujtimi vështronët mënjanimin e pilotës.

— Kujdes friksionin, Bujar! — lajmëroi ai.

— Pilota erdhi në vend.

— Fatosi la dërrasën dhe pa drejtimin. Ai tha se pilotë ishte larguar nga kolona dhe kjo rrezi-

konte. Çekiçi një çast mund të futej midis pilotës dhe kolonës dhe mandej... Përsëri dërrasat e drejtimit. Pas tij, Kujtimi dhe të katër, dy e nga dy në secilën anë të dërrasës, shtynin kolonën në drejtimin e kolonës: «Oooo! Jepi, Oooo!» Usta Petroja atje te depoja, përtej bregut, ndjeu thirrjet e tyre dhe kuptoi se diç nuk po shkonte mbarë. Ai nxitoi dhe, sa u afrua, thirri si i xhindosur:

— Jo me këto dërrasa! Ku i keni të gjatat?

Atyre u gëfonin gjokset dhe nuk ju përgjigjën.

— Dëgjoni ju?! Jo me dërrasat e drejtimit!

— Nuk e dimë kù janë, usta! — tha Agushi.

— Fatos, largohu andej! — urdhëroi usta Petroja. Ai nuk e besonte që edhe ndihmësi i tij ta merrte punën kaq lehtë. Ata të katër donin të plotësonin një normë. Ndonjëri mund të thyente dhe kokën. — Kujdes, Bujar! Frenoje! — urdhëroi ai prerë.

— Mos e ndërpre punën! — diktoi Ariani.

Çekiçi godiste: «Bam! Bam! Bam!» Aty lózte dhe rreziku. Petroja nuk mundi të hidhte çap më përpara. Ai vetëm cirrej: «Ju mori djalli, ju mori! Do t'ju thyejë brinjët çekiçi!» Vullnetarët me gjokse zbërtthyer i jepnin zemër njëri-tjetrit: «Oooo-op! Ooo-op!» Dalëngadalë ustai po harronte rrezikun e çikicit dhe, kur u drejtua pilotë, pa se vullnetarët dihasnin, buzëqeshnin dhe bënin fresk. Bujari pyeti ustanë në duhej, të frenonte. «Vishni xhaketat, se do të ftoheni!» — këshilloi Petroja pa ditur ç'të thoshte tjetër.

Një batipal.

Katër vullnetarë, një ndihmës dhe një usta.

Fjalë dhe boshllëku i dites së diel, në trase. Kjo qe pamja që të lodhte më tepër: një hapësirë pa lëvizje dhe pa zëra. Petron e hante meraku i shkujdesjes së tyre, që shpesh e

ngatërronin me vrullin vullnetar. Një herë, kur po ngulnin pilota (e gjashta apo e gjashtëmbëdhjeta, Petros nuk i kujtohej), Gjoka thirri Bujarin dhe urdhëroi të mbante friksionin. Ai vetë u shkëput, mori një vare dhe i ra pilotës tri-katër herë, sa e afroi te batipali nga ishte larguar. Pa la dhe varenë e i vuri shpatullat për të mbajtur pilotën në drejtimin e çekiçit. Çekiçi godiste me rrezik sipër, mbi kokën e Gjokës. Kujtimi e rrëmbeu Gjokën dhe e flaku tej. Petroja mehu frymën në ato çaste dhe mbylli sytë të mos shihte q'mund të ndodhte aty. Pa iu shfry Fatosit dhe iu kanos se do ta godiste me pëllëmbë, si ta kishte fëmijën e vet. Atëherë Fatosi i kishte kërkuar të falur dhe i qe mënjanuar. Edhe tani po i kërkonte të falur. «Ua njoh kokën unë!» — iu shkreh Petroja, tek solli ndër mend si u kaloi ai rrezik me kërcënimin e çekiçit mbi krye. Ata të katër vazhdonin t'i jepnin arganellos dhe i hidhnin vështrime të shkëputura shoku-shokut, pa folur.

Gjoka kalonte nëpër traversat e drunjta dhe i dukej sikur vraponte në një shkallë të shtrirë. Rruga qe e gjatë, ai dihaste. Hoqi xhaketën dhe hapat i ndjeu më të lehtë. Dhe iu krijua një përshtypje se deshi të arrinte një njeri diku larg, por, sado që i bëhej në vetvete sikur i thërriste e vraponte drejt tij, njeriu largohej edhe më. Gjoka kishte mbetur i vetëm midis dy shinash të hekurta, që po e shpinin drejt shokësh. Drejt Regës... Mandej shinat mbaruan. Dhe traversat e shpërndara mbaruan. Traseja mbeti e sheshtë. Atij iu krijua përreth një boshillëk dhe iu duk sikur nga një humbore ndiente jehun e zërit të vet

që e përqueshte: «Rruga e vetme... E vetme. Rruga e vetme asht e lodhshme. Dhe mendja e vetme... E vetme. Mendja e vetme nuk ka cak. Kur je vetëm... Vetëm. Kur je vetëm, fjalosesh me veten. Dhe kush fillon e fjaloset me veten, ai asht i ndamë nga shoqnia. Dhe sa i humbun... I humbun. Sa i humbun mund të jetë njeriu pa nji shok. Unë u humba shokëve. Nga ne thonë ma mirë me pasë nji anmik ma tepër sesa me humbë nji mik.» Gjoka kishte humbur shokët. Trasja shkonte drejt batipalit... Atje ishte Bujari, Sokoli,. Ata të pestë. Dhe usta Petroja me ta, se gjithmonë bashkë patën punuar. Dhe Fatosi, ndihmësi i ustait. Vetëm Gjoka nuk ishte. Ai po kthehej tanë t'i takonte dhe ngriti një dialog. Dhe dialogu që: «A erdhe, Gjokë?!» — do t'i thoshte Petroja. «Po, erdha, usta!» «Të pritëm.» «A u lode, Bujar?»! «U lodhëm, Gjokë. Pse erdhe?»! «Nuk mundesa me ikë, Sokol.» «Pse?»! «M'u duk sikur po humbja veten, Lorë!» Gjoka qeshi, kur mendoi se Lorën ai do ta takonte së mbrami, bashkë me Regën, Ky që një dialog i mendjes së vet, një mendje që kishte humbur dhe nuk dinte përqka mendonte...

I vetëm në atë trasë, ai dukej sikur ngulte hapat e vet.

Gjoka, sa erdhi, përshëndeti me zë të mëfshtë, që nuk ngjante me zërin e vet. Shokët i uruan mirëseardhjen. Ata dihasnin të lodhur. Petroja nuk foli. Ai ndiqte lëvizjet e ngathëta të çekiçit derisa u kap në gremçën e vet. Mandej vullnetarët drejtuan trupat dhe shpatullat iu shkrythën veti. Atëherë Petroja iu afroa Gjokës dhe

e pyeti për shëndetin. «Asgja. Te friksioni po qëndroj vetë,» — tha Gjoka. Ai e ndjeu veten ngushtë.

— Më thanë se ishe i pamundur, — vërejtë Petroja.

Gjoka u duk sikur u tremb:

— Të kanë rrejtë!

Të tjerët mbetën, si të mbanin fryshtat, dhe deshën të lëviznin për të humbur gjurmët e hilesë. Kujtimi shpejtoi e tha se nuk domin të shqetësonin ustanë, prandaj.

— E pse me rrejtë?! — tha Gjoka.

— Kështu na thanë, — gjegji Kujtimi e nuk deshi ta nguc te më tej këtë bisedë; mori ca guraleca e fillooi t'i hidhte në përrua.

Gjoka vështronte cilindo që fliste. Fjalët vinin rrötull. Ai i ndiente sikur prekte copëra të ftohta çeliku. «E dinim që nuk ishe i sëmurë,» — tha Bujari me furi. «Dhe nuk të prisnim,» — i dha Ariani edhe më tej krah bisedës. Kujtimi hidhte guraleca në përrua. «Unë jam tue ndie përsa thoni, — tha Gjoka dhe u çlir. — Dhe ti Kujtim, lene gurin!» Kujtimit i mbeti guraleci në dorë. Ai e lëshoi dhe guraleci ra në dërrasë. U duk se erdhi një çast zemërimi dhe Gjokës thua se i iku fytyra: «Ma parë unë dua kuven din, mandej...» — tha ai. «Dhe unë dua punën, — e ndërpree Petroja, aty për aty. — Në jeni çlodhur, fillojmë: fjalë nuk dual!» Petroja hesh ti, duke pritur zbatimin e urdhrit. Vështrimin e mbërtheu në një pikë dhe ajo mbeti e vëtmja pikë në atë gjendje të palëvizur.

Vullnetarët vështruan Gjokën.

Gjoka shkoi te friksioni. Bujari ende kundron te. Ariani i ra Agushit lehtë në shpatulla. Gjoka vërejtë me shpoti: «Boll je tue më pa, Bujar! Edhe për kumbar me më pasë dashtë...» Bujari i tha

qetë, si tē mos i bëhej vonë pér asgjë: nuk do tē qe keq, po tē fuste kokën te batipali dhe ata t'i binin me çekiq. «Po ç'djall kérkon! — bërtiti Gjoka dhe u duk sikur vërriti si cjapi mbi shkëmb. — Përgjigjen jua kam dhanë.» «Po edhe ti, bëje një autokritikë, se fjalë ke pér tē thënë e nuk ke pér tē mbajtur gurë mbi shpinë!» — tha Fatosi me shaka, por kurkush nuk qeshi. Petroja iu hakërrua:

— Kam pritur e pércjellë shumë unë. Aty e aty jeni, një kokë. Puna. Ura. Shoku. Mendimi... Dreqi. Po veten, ku e keni lënë?! — ndjeu ai një si shtrëngim në grykë dhe u përcoll. Fikthi i hummbi një çast e iu duk përséri. — Ta dini, unë do tē ankohem, se sa vijnë e shkojnë në hekurudhë, aty e aty janë, si njëri-tjetri. Po lozni me veten! Shko e gjej vinçierin tē na afrojë pilotat! — iu hakërrua Petroja edhe një herë Fatosit.

— Si urdhëron, iusta! — gjegji Fatosi dhe iku me vrap.

Petroja nuk foli më, por ashtu i vrerët u largua i pércjellë nga vështrimet e vullnetarëve. Rrugës pér te baraka ndjeu tē bënte fresk: «Hë, kështu e duan ata! Harrojnë veten dhe rrezikojnë...» Ai frikësohej se ata shpesh nuk i përfillnin «çmenduritë». Ndonëse dhe ai vetë e kishte bërë një «çmenduri».

...Qe prill 1968.

Inxhinier Artini ná ndërtoi një urë tē vogël te lapidari Ajo lëvizte vetë, si e gjallë; dhe dukej sikur ecte me njerëzit. Pér tē u thanë shumë fjalë, rrugëve dhe në qytezë. Një ditë Petroja e luti

Artinin tē shkonin tek ura. Pranvera buiste me sythin dhe biskun e bimës së mbjellë, fërfëron-te nē gjethet e pemëve, prarohej me ngjyrën e luleve dhe endej e përkundej nē krahun e fluturave; fliste me zukamën e bletëve e këndonte me zërin e zogjve, ligjëronte me bilbilin nē korije dhe qyqen ndë pyje siç thoshte kënga: Bilbili ia thotë,/ Qyqja po këndon,/ Plagët e mia ç'i lëndon! Dukej qe një këngë e vjetër që ndihej se vinte e mugët nga thellësia e fushët dhe këngëtarit seç i përtérinte plagë tē harruara!

Urëza e Shkurtës njërin krah e mbështeste nē trase dhe me krahun tjetër zbriste nē drejtim tē fushës me një palë shkallëza, jo shumë larg rrugës automobilistike. Petroja ngjiti shkallëzën dhe e ndjeu veten si nē një korridor tē freskët. Tek hodhi hapat e parë, ai u lëkund dhe ndjeu druajtje. Ai e dinte se projekti qe bërë pjesë-pjesë nga zyra teknike dhe po ashtu qe zbatuar. Ajo po lëkundej nën hapat e tij dhe jo më nē përurimin e bustit, ku do tē kalonin shumë njerëz... Petros i hyri një frikë dhe iu kthye Artinit: «Po ura lëviz!» — dhe sakaq ai rëndoi nën hapat e vet. Dhe ajo lëvizi «Po kjo është dhe më e bukura e saj, Petrooo!» — tha Artini dhe sytë i shkëlqenin. Ura kishte diçka tē veçantë dhe njerëzit këtë e ndienin, por Petroja nuk deshi t'ia dëgjonte më Artinit atë zë tē drithëruar: «Të ndiesh, por jo me frikë!» — tha ai. Dhe ura nuk duhej ta përkulte shpinën si nē lodra fëmijësh. «I duhet Shkurtës. Petrooo! I duhet Shkurtës...» — tha Artini.

Qe prill. Plepat shtrinin degët mbi urë. Pranvera lozte me gjethet. Asaj nate Petroja nuk bëri gjumë. Zëri i veroreve dhe cëritja e bulkthit dridheshin nē vibracione tē harmonishme. Petros i erdhi një e përqethur dhe u ngrit e dolli

jashtë në verandë. Qielli kishte yje dhe qe i ftohtë. E shoqja e ndjeu dhe i thirri. Ai i tha se kishte punë dhe u nis. Inxhinier Artini ia kishte prishur gjumin. Qe mesi i natës. Natë prilli me çëritje bulkthash dhe këngë veroresh. Në afërsi të urës ai ndali kompaninë e parë që kthehej nga turni dhe e kaloi mbi urë. I mori dhe i vuri në kolonë me hap ushtarak dyzet veta. Artinit iu ndez gjaku: «Po kjo është jashtë normave teknike, Petrooo! Ku deshe t'i mbysje vullnetarët?! Dyzet veta të mbledhur në një pikë në atë urë! Kupton?!» Petroja tha se e kuptonte, por nuk mund ta linte pa provë, se ura lëvizte dhe ai kishte frikë mos shembej. Këtë ua kishte thënë dhe vullnetarëve. «Ja, do më?! Ma prishe gjumin dhe më shtyve në gabim....» — tha ai dhe, si komunist, do t'i falej Partisë ta ndiente në nuk mundi t'ia kuptonte mendimin Artinit.

Qe prill 1968.

XI

Ata ktheheshin nga ekskursioni.

Lora iu afrua Regës. Kur arritën tek ura përtëj kanalit, ata kthyen rrugën dhe vazhduan të ecnin pranë pemëve. Era krijonte një gjendje vagëllimi shpirtëror, që nuk kishte të bënte me mirazhin e një fushe, ku kundërmonte era e barit. Një vajzë e vogël qëndronte në mezhdë të kanalit, qëllonte me gurë dhe përpiquej të nxirrte që an-dej patat. Ato ulnin e ngrinin qafat e gjata si t'i bënин lajka njëra-tjetrës. Këmbët e vajzës së vogël Lorës iu dukën të bardha e delikate. Dhe

ajo seç pati një ndijim të vagëlluar e deshi të gjente e të ripërtërinte në shpirtin e vet miturinë, kur i pëlgente të rrinte zbathur e të lagej me gjithë fustan në përruan e Gurabit, me rosat. Rrëmoi në kujtesë të ndjellë fëmijérinë dhe ndjeu se i kishte humbur e ajo nuk qe më e aftë të përjetonte gëzime të thjeshta. Vajza e vogël lozta me patat, vetëm, buzë kanalit. Një qerre e ngarkuar me hekurishtë u kaloi pranë. Pendari u foli qeve dhe ata e nxituan hapin, duke gulçuar nga barra e ngarkesës. Qerrja u trokoshit dhe rrapëllima e hekurishteve thua se mbuloi tërë rrugën: Lora mbylli veshët dhe priti derisa ajo rrapëllimë nuk u ndje më. Nga larg vinte krikëllima e rrotave. Rega vazhdoi bisedën e lënë përgjysmë:

— A thue kë më ik, Lorë?

Lora nuk i dha përgjigje të drejtpërdrejtë.

— Më ke thënë se të do shumë, Regë.

— Po, veçse ai asht burri, — mërmëriti Rega e dëshiruar.

Lorës i qeshi zemra dhe miratoi malësoren. Dhe tha se Gjoka nuk ikte, se kishte frikë. Rega mbeti dhe nuk po kuptonte se nga kush mund të kishte frikë Gjoka. Nga fëmijëria asaj i kishte mbetur përfytyrimi i burrit, që vë poshtë ariun e bjeskës. Për këtë shumë burra u kishin treguar grave të tyre dhe ato e ndienin veten gra me burra të fortë:

— Gjoka me pasë frikë, the?!

— Ka frikë nga ti, Regë.

Rega qeshi nën zë. Dhe ajo nuk mund ta mendonte frikën e Gjokës dhe as e kuptonte Lorën, kur i thoshte se ishte më e fortë. Rega vuri pëllëmbët në faqe dhe iu duk sikur i humbi fytyra.

— A thue, Lorë?!

— Po, ai të do. Ti ke në bark fëmijën e tij, Reginë. Ti je nëna dhe pa nënën...

Rrega do të lindte ferishten dhe do ta ushqente me gjirin e vet dhe do të lozta me të dhe do ta mësonte si të belbëzonte së pari dhe... paçka se do të quhej biri i Gjokës, ajo ishte nëna, që e kishte ushqyer me gjakun e vet dhe... Ato lanë rruqën dhe kaluan anës ugarit. Përtej hamullorja dukej me një drithë të mugët, ku përziheshin grumbuj avujsh ngjyrë hiri. Mbas hapave të vet, ato ndienin furimin e tokës ende të pangopur me lagësh-tirë.

Atë mëngjes Gjoka priti e priti.

Rega shkoi në ekskursion me shoqet te, Kasollja e Barinje. Kasollja qe në fushë, ku në vapsi mizonin delet. Prej aty, në pranverën e vitit 1943 kur sa kishte plasur gjethja, nëntë djem nga fshati Bunar lanë delet në fushë dhe u nisen partizanë. Më i madhi ishte gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe më i vogli katërbëdhjetë. Me ta qe edhe Marini... Kasollja kishte mbetur po me ato shtylla, thuajse të shtrembëruara, ndonëse ndonjëra qe e përkulur edhe më. Nga ana e lindjes shtyllat në fundin e tyre kishin zënë myshk. Gardhi i kasolles kishte lëshuar bark dhe, vende-vende, ishte shqepur. Kasollja qe mbuluar me kashtë. Kashta qe kalbur, edhe pse në pesë a gjashtë vjet atë e ndërronin me kashtë të re. Dhe ky qe i vetmi kujdes, për të ruajtur gjendjen e herëshme të kasolles. Atë ditë, aty me vullnetarët, kishte ardhur dhe nëna e Martinit. Rega thuajse ishte fare pranë saj, e mbështetur në krah të Lorës. Asaj i dukej sikur nëna kishte një breggë, por nuk e thoshte. «Ja, që këtej ikën, — tha ajo, — por ne nuk i përcollëm dot, se nuk na lanë!» Ndofta kjo do të qe dhe brenga e saj. Lora pyeti përsë nuk i lanë (!).

— Kishin frikë se mos derdhni lot dhe përmallonim fëmijën, nusja e nënës.

Të tjerët panë nga Lora. Regës i erdhi keq. Nëna, sa herë që u drejtohej vajzave, nuk u thoshste «bijë». Rega mendoi se ndonjërën prej tyre ajo do ta donte nuse për Marini.

Grupi qe nisur me pushkë në krah. Fusha kishte bar. Këtyre fushave ata patën lozur me dyfek prej kallami. Atë ditë qe një mëngjes i mugët, mëngjes pranvere; lulekaçja kishte nxjerrë kryet nga dheu dhe dukej si një zambak i vogël me katér petëla të hapura. «Revolucioni që ka nisë...» Ata thanë t'u kishin kujdes delët dhe të ndillnin qentë, se po u vinin mbrapa. Ata po shkonin partizanë. A thua ishin rritur?! Në krye moti nënët u vinin përpara fëmijëve nga një hosten, kobure dhe sëepar e thoshin se, ç'të kapte fëmija, i tillë do të bëhej. Pati ndodhur nga ata që kapni kobure. Patën dalë dhe kaçakë. Por të dilnin partizanë kaq të vegjël?! Dhe u kishin thënë që t'i ngrinin pushkët grykëlart, të mos u takonin në dhé. Mbi kapele kishin vënë nga një yll të kuq dhe kishin kënduar atë këngën që qelli bëhet tym edhe flakë... Nëna nuk ia dinte mirë fjalët. Pastaj erdhi dimri dhe këndeje nuk rrihej më: fusha kishte baltë. Baltë të zezë. Lora pyeti si ishte Marini. Deshi të dinte edhe më. Nëna nuk dinte ç'të thoshte: «Po ja, nusja e nënës, ai qe... ishte më i shkurtër nga pushka.» Të tjerët qeshën Dhe nëna qeshi: «Po, po! Kështu ka qenë ai...» Pastaj nëna kishte marrë vesh se atij i qenë grisur opingat, ia kishte ngrënë guri i malit. Kështu qe lufta: të shponte me plumb këmishën, të griste apingat dhe të linte zbathur maleve... (Uh, o zot! Ajo kishte frikë dhe shtirej sikur nuk e mendonte një këmishë të shpuar nga një plumb i vogël.) Thanë se edhe komisari e kishte pyetur

përse rrinte zbathur. Komisari kishte hequr opingat e veta dhe ia kishte dënë. Mirépo Marini nuk i kishte pranuar. Dhe thonë sikur kishte imbetur me ca kilota të grisura e dukej sikur mbarre me vete leckat e Myzeqesë. Një natë, para se të niseshin, në shtëpinë e saj askush nuk mbylli sy. Dhe askush nuk foli për luftën, paçka që secili mendjen e kishte në luftë. Nënës nuk i besohej që ai po nisej partizan, se i dukej i vogël. Ajo i shëmbellente luftëtarët burra të fortë e jo sa Marini i vogël. Kur vinin njerëz, fshehurazi, ajo i pyeste se ku ngroheshin. Ata i thoshin se ndiznin zjarre në dëborë. Pa bënin dhe shtëpi prej dëbore dhe rrinin ngrohtë. Këtë nëna nuk e besonte dhe nxirrte e u jepte çorape leshi dhe ndonjë fnellë me dorak të zbukuruar me mollë. Dhe t'i thoshin Marinit se bejka kishte pjellë dy: "Dhe vërtet atë vit na polli bejka dy qengja e njérin do ta ruanim, sikur ç'të qe!" Atë ditë të lagësht vjeshte copëza resh dukeshin në hapësirën e pastër dhe qielli ngjante me një qëllq të thyer. Hijet e reve binin e lëviznin si të gjalla mbi fushën e gjerë, por askush nuk e kishte mendjen tek ato. Nëna tha se qengjin do ta therin, kur të vinte ai... Seç thanë pastaj se gjermani po qëllonte me gjyle e po mësynte me ushtarë e makina të hekurta. Dhe kjo i qe dukur asaj si një rrëfenjë: kuçëdra villte zjarr, nxirrte tym dhe kishte zënë burimin. Pa u ngrit djali... hëhë! Bijtë e nënave! Biri i nënës seç e kishte humbur. tek shihte gjermanin të lëronte vendin me gjyle topi, si par mendë. U zvarrit në hendek, zbathur përballë tankut dhe «bam!», me pushkë të gjatë: bam-bam! Pa gjerdanin. Gjerdani ishte bosh. Kontrolloi pushkën. Pushka nuk kishte më fishekë. Ishte hera e parë që po zemërohej me të. Marini hoqi xhaketën dhe zvarrë-zvarrë anës

xhadesë, pranë tankut dhe ia vërviti në zinxhirin e rrotave. Atij iu duk sikur ngeci tanku e po vinte anës, kur u kthyen nga ai. Dhe Marini u çua në këmbë e vinte anash tankut, me pushkën pa fishekë. Dhe u hodh mbi tank dhe i ra me kondak të pushkës, që t'ia shkallmonte kapakun. Kështu kishte qenë ai që së vogli: lozta me dy fek kallami dhe kondak, pa këndonte dhe një këngë: *Po i vjen vdekja robërisë! Nga shqiponjat partizane!* Pastaj u hap fjala se e qëlluan gjermanët nga mbrapa me murtajë dhe e shembën mbi tank. Qe luftë e madhe, tri ditë luftë. Bilë njërin, pak më të vogël se Marinin, deshën ta largonin nga ajo luftë. Eh, jetëbardhët! I dhanë një copë letër për ta çuar në fshat, por ai e çoi shpejt e u kthyen përsëri. Kishte marrë dhe tri shegë nga e ëma për t'u njomur buzën të plagosurve... Dhe kishte mbetur atje, tek u lagte buzën me lëng shege, bashkë me një Liri nga Fieri. Dhe pastaj nëna tha se i ati kishte shkuar të kërkonte të birin në natën e errët. «I kam prurë opingat, të mos i hajë guri këmbët!» — u tha ai. Ata, shokët, kishin ulur sytë. Pastaj Marinin e ngarkuan në një qerre dhe e prunë këtu, te kasollja. Kapelen me yll vënë mbi gjoks... Mandej qe ngritur i ati i djalit e porositi nënën: «Eja dhe mos qaj!» Nëna kishte pyetur përse. Asaj i thanë se gjermani që nëpër këmbë dhe nuk duhej të dëgjonte të qarën: Ajo ecte rrugës dhe qante me zemër: *Ty të rrithi nëna, pa bukë e pa gjë!* Dhe seç iu kujtua bejka që kishte lindur dy qengja.

Marta po ngashërente. Tusha e qortoi. Rega nuk i foli. Lora ndjeu një vagëllim shpirteror dhe iu duk vetja e mangët. Deri më atë kohë ajo e kishte ëndërruar dashurinë e vet, si më të çlirtën dhe më të mirën dhe as e mendonte sejeta ishte e mbrujtur me dashuri nga më të

ndryshmet që mbartnin në rrugën e vet dhe përbuzjen. Marini i mbeti në vegim si njeri që godet meurrejtje mbi tank.

Sokoli kishte marë një purtekëz dhë, gjatë rrugës, qëllonte këmbëzën e pantallonave në mënyrë ritmike. Fshikullimi i saj godiste në mendimin e tij dhe e largonte nga ngacmimet dhe zërat pérreth:

*Qielli me krähun e purpurt,
Si një shpend i stërmadh,
Tokën e mblodhi në gjirin e vet
Dhe e puthi me afsh
Erdhi mëngjesi, o njerëz!
A e ndieni ju laurëshën?!
Fërfërimëzën e kavakut të heshtur?!
A e ndieni ju erën e bukës si dël nga avulli
i tokës?!
A e ndieni?!*

«Pam! Pam! Pam!» — purtekëza. Miklimi i vjershës i humbi në llapaçitjen e çizmeve të veta. Qielli ishte i mugët. Ai ktheu për nga batipali. Dalëngadalë zërat e rrugës po vagëlloheshin dhe ai po jetonte me afshin e ugarit të lagësht. Fusha sillte ajër të freskët dhe heshtje të paanë. Sokoli ndiente zhurmën e hapave të vet dhe fergëllimën e frymëmarrjes së thellë. Kur iu afrua batipalit, herë vështronë përruan dhë herë kundronë çekiqin, tek ngrihej përpjetë dhe shkëputë teje andej mbi pilotë. Përroi sillte ujë të turbullt dhe Sokoli seç ndjeu një tundim, kur u përshtendet me ustanë: «Me gjithë këta ujë, do të përmbytemi, usta!» — tha ai. Petroja e siguroi se, sado shi të binte, përroi nuk mund të fryhej

shumë, se ushqehet nga rrëke ujëpakta. Çekici ra mbi pilotë. Gjoka përmendi me zë të lartë numrin tetëmbëdhjetë. Sokoli korrigoi: njëzet. (Nëntëmbëdhjetë Gjoka kishte thënë kur vajti ai.) Agushi qeshi mbyturazi. Sokoli bëri sikur nuk e vuri re dhe u kthye nga ustai të tregonte proverbin e pérroit që ushqehet me këlyshët 'vet. Bujari nuk e mbajti dot gazin. Qeshën dhe të tjerët. Petroja qeshi me zë të trashë. Fjala e Sokolit herë ngjante si një lojë gaztore, herë si një e vërtetë e padëgjuar: «Rri, o për kokën tënde, se na ka ardhur në majë të hundës! Në vend që t'i ngremë shifrat, i ulim... Këndeje ul Gjoka, andej ai, tekniku beratas,» — vërejti Sokoli. «Prapë me teknikun ti?!» — pyeti Kujtimi. «Epo mirë, lëre!» — tha Sokoli. Atij iu kujtua noska për hundën. Gjoka përmendi numrin trembëdhjetë. Sokoli tha se kishte lajthitur ose nuk dinte të numëronte. Nuk ecej si gaforrja, mbrapsht. Fjala qe për Gjokën.

Pérroi qe fryrë. Uji kishte gjetur një vend dhe po shpérthente në argjinaturë. Sokoli e pa dhe, papritur, ia dha me thirrmë. Kujtimi i bëri zë Petros, që nuk e kishte vënë re shtimin e pérroit. Petroja la hekurishtet e dérrasat me të cilat merrej e vrapoi për tek ata. Ariani pyeste se ç'duhej bërë. Gjokë Çani i Hirajt, që era ia pérthau buzët atë mëngjes, thirri Bujarin për te friksioni dhe vetë vrapoi e u hodh në ujë. Sokoli pa me habi. Ustai urdhëroi të tjerët të shkoni në ndihmë të Gjokës.

— Sillni sa më shpejt dérrasa, Arian! — tha Kujtimi dhe u hodh aty, ku Gjoka qëndronte krähëhapur e rrropatej të ndalte rrymën. Ata u kapën krahaqafë, për të zënë sa më shumë vend në argjinaturën e plasur.

— Baniu za shokëve, Agush! — thirri Gjoka.

Agushi vrapoi duke iu marrë këmbët nëpër argjinaturë. Ustai ngriti dorën dhe la të lirë litarin: «Frenoje!» — urdhëroi ai. Bujari qe hultuar dhe i thirri Gjokës. Zhurma e ujit ia përqaste Gjokës zérin me gurgullimën. Sokoli shpejtoi dhe ia përfshiu Bujarit dhe dorën, dhe levën. Duart u bashkuan me njëra-tjetrën: «Po kape me të dyja duart, more djalë, dhe tërhiqe!» Çekiçi frenoi mbi kokë të pilotës. Ata panë njëri-tjetrin në sy: nuk kishte kohë për shaka.

— Qëndró këtu, Sokol!

— Po ti?

— Te Gjoka, vëlla, te Gjoka!

— Mos ki frikë!

— Mbaje levën fort të mos shpëtojë!

Qe një këshillë shoku në çastin më të vështirë. Sokolit i erdhi për të qarë, tek pa Bujarin që vrapoi, u hodh në ujë dhe u lidh krah për krah me shokët e tjerë.

— Kam me të mbytë, — i tha Gjoka kur i shkoi pranë.

Bujari i buzëqeshi. Ata të dy e vunë në mes dhe lidhën duart mbas shpine. Ariani vraponte nëpër argjinaturë me një dërrasë në krah dhe, në rrugë e sipër, diç tha, por Sokoli nuk e mori vesh. Ai shkoi dhe u shtri në argjinaturë e vendosi dërrasën mbas shpinës së shokëve. «Mbeti te leva, sikur...» — tha ai dhe i thirri ta lëshonte. Ndërkohë ia bëhu Fatosi: «Ka shpërthyer rezervuari dhe vinçieri ka vajtur atje. Për të tjera pilotë...» «Sill dhé!» — këlthiti Petroja. Uji sa vinte shtohej. Bujari dridhej e kërciste dhëmbët. Shokët e mbanin peshë dhe atij nuk i zinin këmmbët në tokë. Një lëvizje e vogël e të tre vullnetarëve edhe dërrasa mund të kthehej e të notonte në rrjedhën e përroit. Petroja sillte dhé. Fatosi sillte dhé. Sokoli e ngjishte. Vullnetarët që erdhën ishin

të paktë, se kishin shkuar atje, ku kishte shpërthyer rezervuari. Petroja urdhëroi që shtresat të vendoseshin në gjithë gjatësinë e argjinaturës, se mund të rrezikohej dhe batipali. Me të ardhur, Agushi shkoi te kryet e Bujarit dhe i tha të dilte ta linte atë në vendin e vet. Ai ngriti kokën dhe i buzëqeshi: buza i qe mavijosur dhe pushi i faqes i qe ngritur përpjetë. «Lëre, se ka borxhe të vjetra për të larë!» — tha zëdridhur Kujtimi. Uji, sa vinte, frynte shtratin e përroit.

Lora pa se Sokoli po mundohej të shtynte një karrocë të mbushur me dhë. Karroca nuk ecte në tokë të parrahur. Lora i doli përpara dhe deshi ta têrhiqte. Karroca u mënjanua dhe u derdh i gjithë dhei. «Lëre, dreqin!» — mallkoi Sokoli, gjithë djersë. Ai tha ta mbushnin përsëri e ta ngrinin si tezgë. Lora zbërtheu gjoksoren pa fjalë. Ai pa dy shpatulla të ngushta përpara vetes. «Hidh dhé!» — i tha ajo. Dy duar përpara tij kishin ngritur anët e fustanit për ta mbushur me dhë. Ai ngriti lopatën dhe hodhi dhë. Dheu rëndoi mbi fundin e fustanit. «Mbushe plot!» — tha Lora. Dhe një lopatë. Dhe dy. Ca vajza, që jepnin e merrnin të shtynin një karrocë, e lanë atë në mes të rrugës dhe zbërthyen gjoksoret. Sokoli mbeti të mbushte fundet e vajzave me dhë. E fundit që shkoi ishte Rega... Gjoka desh klithi, kur e pa Regën ashtu, fustanngritur e ngarkuar me dhë, gati për t'u rrëzuar në përrua: «A je e marrë, Regë?!» — mbeti me turp ai, duke shfryrë ujë nga goja.

Petroja shihte ata tre djem në ujë, duke pritur rrëmbimin e përroit dhe vajzat që, pa drujatje, mbushnin fundet e fustaneve me dhë. «E mira u buron nga brenda, — tha me vete. — Është në shpirtin e tyre.» Vetë ai nuk e mbante mend

ku e lanë prindërit e ku i la. Dinte që u rrit te gjyshja dhe shokët e njihnin me emrin Petro Rabecka.

...Kështu, në Lagjen e Rabeckës bëhej luftë. Ajo ndizej nga pasditja dhe vazdonte me tër-sëllëm deri në orët e para të mëngjesit. Banorët e mbetur bënин gjumë të trembur. Sa dëgjonin një krismë, prisnin një tjetër dhe vetiu grumbulloheshin në një vend, për të marrë zemër: gratë fjaloseshin për fëmijët, burrat për strategjinë e luftës. Kishte çaste që furia e luftës ngrihej dhe mbi hallet e njerëzve dhe vetiu në shtëpinë e Rabeckës binte heshtje. Të parët që heshtnin ishin pleqtë. Po të parët që nisnin bisedën ishin po ata, pleqtë.

— Gjermani është djall!

— Dhe për djallin ka plumb, zoti Bido!

— Nuk ka varr që e mban djallin, jo!

— Ti je burgjez, Bido! Partizanët kanë çliruar gjysmën e qytetit dhe ti po me frikën e gjermanit.

— Ne po bëjmë muhabet!

— Në luftë nuk ka muhabet, Bido!

E pastaj... Në shtëpi kishte hyrë ngutshëm një partizan. Njerëzit e hutuar panë nën dritën e kandilit një burrë thatim me mustaqe të zeza dhe automatik në dorë

— Nga vjen ti?!

— Nga lufta.

Kaq qe pak: të gjithë nga lufta vinin, apo shkonin në luftë. I pari që iu afroa nga të vegjlit, qe Rabecka.

— Partizan? — pyeti Rabecka.

— Partizan, — tha i porsaardhuri. Ai kërkoi të dinte si mund të dilej te Bashkia.

— Nuk mundet. Në çati të qethin plumbat, — tha një.

— Provuan dy veta dhe u vraaanë, — e tori Bidoja fjalën nëpër dhëmbë.

— E ai: njëri isha unë, — nënqeshi partizani.

— Dhe nuk u vrave?! — pëshpëriti Rabecka, sikur të nxirrte tërë fryshtë përnjëherë.

— Pusho, Rabeckë! — tha me zë të dridhur Bidoja.

— Pse, ti je Rabecka?! — pyeti partizani.

— Unë. Nga më njeh ti?

— Nga hunda, hë!

Dhe ia shtypi hundën' me mollëzën e gishtit tregues. Rabecka qëndronte përpara tij këmbëzbathur. Moshatarët përreth ia kishin zilinë (Njëri edhe qeshi me hijen e rëndë të Rabeckës!). Partizani pyeti si mund të dilej drejt për te Bashkia.

— Si drejt?! Pengojnë muret.

— Do t'i shembim muret, — tha partizani.

— Me grusht!

Partizani e nxori fjalën nga dhëmbët. Bidoja çakërriti sytë. Rabecka shendoi në gaz.

— Pse qesh tiii??

— Nuk e dëgjon?! Me grusht, thotë (!).

— Po, me grushtin tonë! — tha partizani.

— Po bunkerin? — klithi Rabecka.

— Dhe bunkerin!

Dhe pàrtizani lëvizi përpara tij grushtin e madh, ndërkohë që të tjerët prisnin përgjigje: «Ja, e sheh? Me këtë do t'i dërrmojmë. Nga mund të kalohet, Rabeckë?»

— Drejt rrugës së madhe.

— Po plumbi?

Të gjithë panë nga Bidoja dhe kuptuan se mendimi i Rabeckës qe një çapkënllek i rastit, me të cilin nuk bëhej shaka, se rruga e madhe

ishte një vijë zjarri e rrihej me plumbë. (Nga krahë i njërit bunker shkëputëj një tank dhe përshkonte rrugën që lidhej me bulevardin kryesor. Shpesh kthehej dhe nëpër rrugica ku gjuante banorët e fshehur. Atë tank kërkonin ta ndalonin me barrikada: vendosnin hekura mbas heku-rash, trarë, thasë me rërë dhe gurë mbas gu-rësh.) Rabecka ndaloj të qeshurit. Partizani nderoi me grusht dhe iku. Njerëzit mbetën me vështrim nga dera, pa mbledhur veten nga ajo shfaqje e shpejtë. Rabecka tha: «Oho, sa të madh e kishte grushtin ai!» Mbës grushtit të tij Rabecka nuk kishte parë asnë dhe ai grusht nuk iu nda nga mendja gjithë natën.

Në shtëpinë përdhese vazhdonin bisedat e lëna përgjysmë:

— U shkatërrua dhe një bunker! — tha një zë i ardhur.

— E tha ai partizani me mustaqe.

— Qe tjetër. Ai u vra.

— Ti je burgjez, Bido! — tha Rabecka dhe iu turr për t'i rënë me grushte. — Burgjez! Burgjez!

— Po, Rabeckë, u vra! — tha i porsaardhuri.

— Mori rulin që shtron rrugët dhe u nis drejt bunkërit, por nuk arriti.

Rabeckës i mbeti dora e mbledhur grusht dhe, tek e ndjeu të prerë këtë lajm, i rrahu zemra: «Tak! Tak! Tak!» Burrat nuk folën më. Gratë mbetën si të nemitura.

Petroja pëshpëriti nën zë: «Me grusht! Do t'ia shtypim kokën burgjezit dhe do të zhdukim çdo bunker e kanun që na qëllon... (dhe se si i ngatërrroi ai këto!) Dhe vullnetarët nderojnë me grusht. Bido, me grusht! Ja, këta vullnetarë. Këtu u njoh dhe Lora me Martën, Tushën e Regën, këtu... So-

koli po ngjesh dheun që sjellin vajzat. Atij i vjen mirë të lavdërohet nga pak.»

— Hë, Sokol?! — i tha Petroja dhe ndjeu një qetësi në vete.

Sokoli iu afrua pranë: «Fat i bardhë, usta! Fat i bardhë. Do të ishim mbytur të gjithë, me gjithë batipal, po të mos e kisha parë unë shpërthimin e ujit...» Shokët qeshën dhe e nganë më tej shakanë, sikur edhe Gjoka kishte marrë zemër nga tregimet e tij, pa u hodh në përrua në kohë të vështirë e, po të mos qe ai, as Bujari nuk do të dinte të tërhiqte levën me të dyja duart. Gjoka kishte dalë nga përroi dhe kullonte ujë. «Zemër kush jep, usta, pa trima ka plot!» — tha Sokoli dhe, ende pa e mbaruar mirë fjalën, Gjoka e rrëmbeu papritur dhe e shtrëngoi për mesi. Ca qeshën dhe ca u hutuan. Rega u skuq, se iu duk e pahirë që i shoqi hokatej me të përparrë të tjerëve.

— Hidhe, Gjokë, të bëhet poet! — tha Agushi. Gjoka e hodhi.

Sokoli e pa veten poshtë skelës.

Gjoka qeshi me të tjerët: «Hajt e jep zemër tani, Sokol!» Sokoli mundohej të ngjitej: «O kokëlakër! O fanatic! Nuk është dialetike kjo, o kokë... kokë...» shfrynte ai e nuk po gjente dot tjetër fjalë për kokën e Gjokës. «Është praktike,» — tha Bujari buzëdridhur dhe lëvizte e kërcente për t'u nxehur. Lorës se si iu duk, kur e pa tek i kullonte ujë nga këmbëzat e pantallonave e mëngët e xhaketës. Dhe ajo donte të kërcente e të thërriste sikur ishte e vogël.

— Bujar!... E do trikon? — u kujtua Lora.

— Pastaj, se do të shkoj në depo, — tha ai dhe u nis për në barakën e vogël, ku e priste Kujtimi. — A po vjen, Gjokë?

Gjoka nuk iu përgjigj dhe vazhdoi aty, në sy të Regës, të fërkonte kofshët nga lart-poshtë, për të kulluar ujin.

XII

Ato ecnin të tria dhe herë-herë ndaleshin të dëgjonin më mirë bisedën që sillte Marta nga bjeshkët, në rrugët e qytetës. Rega pyeti: «E mandej?!» Marta i tha se e donte fort, pa kishin dalë dhe të shëtisnin. Rega hapi sytë. Ajo kishte dëgjuar që të fejuarit dilnin e shëtisnin me të fejuarat, por jo në bjeshkë (Ata burra, thonë, përturp të grave bjeshkane, nuk mundeshin dot me ariun; po t'i kapte, ai i lagte dhe i bënte qull me pështymë).

— Të do fort, the?! — pyeti ajo dhe zëri i erdhi si i trembur. Rega ndjeu se nuk u ngop me frymë, kur dëgjoi se dhe Marta e donte fort e fort.

Rega dashurinë e ndiente në parzëm, se aty kishte një vend që ajo nuk e njihet, por i dukej se nga aty i shpërndahej afshi që i skuqte faqet dhe i dridhë zemrën. Marta e ruante në gji dhe e ndiente me të përqethurën që i shkaktonte në të gjithë trupin. I fejuari ishte i mirë, e kishte thyer zakonin, kishte shkuar në shtëpi dhe, tek kalonte pragun e kullës, ku e priste ajo, kishte ulur kryet: «Se ishte i gjatë, moj, si lis.» Dhe kur ishte bërë mbledhja në katund, ai ishte ngritur dhe kishte folur. Dhe ajo kishte folur me fjalë të pashkëputura: «Dhe-unë-nuk-due-me-e-lanë-të-fejuemin. Na-kemi-bi-

sedue dhe-e-duem njani-tjetrin.» Dhe gjindja kishte thënë : «Mirë!» Kështu që në fshat vetëm ata të dy kishin mbetur të fejuar dhe, kur ai ishte nisur për ushtar, iu lut Martës të mos e harronte. Marta kishte ardhur në hekurudhë dhe mbas saj, kushëriri i burrit. Kur të kthehej Marta, bjeshka mund edhe ta priste me një «kupë idhnie», por ajo nuk do t'i gëlltiste fshehurazi lötët.

— Ti, a druhesh kur bisedon me të? — e pyeti Rega faqendezur.

— Po jo, moj Regë! Në fillim jam skuqun paksa, por mandej jam mësue.

Tusha jetonte me ndjenjën e Martës, se dhe vetë ajo, po ta provonte dashurinë e vërtetë, në fillim do t'i merrej zëri dhe nuk do të mund ta shikonte në sy, por mandej do të lozta fshehurazi me të dhe do të qeshte pa drojë, paçka se nëna do t'ia qortonte marrinë.

Enëdrrime vajzash, dëshira grash në qytezë! Të tjerat i dinte vetëm Marta. Tusha dhe Rega dëgjonin.

— Po ti, a do ndonji?! — pyeti Marta papritur. Tusha u tremb dhe mblodhi buzët:

— Po iballasi bante shaka, moj! Dhe unë i thashë: «Druhem se kë nanën e keqe, o iballas i marrë!»

Dhe Rega u tremb: fletërrufeja e Gjokës ishte hequr nga vendi. Ajo pa anash dhe kundroi se mos e shihte kund në turmën e vullnetarëve. Tek kundronte, dukej tepër e vetmuar.

Kur hyri në sallë, Rega u nda nga shoqet dhe shkoi e u ul pranë Gjokës. Ishte po ajo sallë,

ku kérceu me Lorën dorabel: nji, dy, tri!, dhe kishte përsëri zhurmë. Zhurmë dhe fjalë. Regës iu dukën si rrapullima fjalësh. Ajo thartoi buzët. Atë pasdite qyteza priste gjykimin pér grisjen e usullit¹), që mbante të stamposur fjalën e gjyshërvë pér t'iu nënshtuar dokeve. Dy botë të kapërthyera. Secila kërkonte të drejtën e vet. Bujari mundohej të dëgjonte Lorën, por nuk po e linte zhurma. Ajo filloi e lehtë, si me pëshpërimë, e mandej erdhi dhe u rrit. Sokoli diç çuçuriste dhe ai mundohej ta mënjanonte: «Lërna, pér kokën tënde, dhe dëgjo!» Sokoli e pyeti çfarë të dëgjonte. Dëgjo këtu, dëgjo atje... Tërëjeta duke dëgjuar i kishte kaluar. «Dhe askush nuk po na dëgjon një herë!» — tha ai. Ariani tërroqi vëmendjen dhe i ra tavolinës me fundin e lapsit. Dalëngadalë zhurma u qetua. Në sallë frymëmarrja po ndihej e rëndë. Lora pyeti: «Mirë ju nuk e duroni dot sjelljen e Gjokës, po Gjoka a e duron tuajën?!» Kureshtja mbeti pezull. «Të lumtë! — tha Sokoli me vete. — Se duro, duro... Pa dale një herë!» Andej nga mesi i sallës u ndje një zë që deshi të dinte në qe Gjoka fanatic apo jo. Këtë Lora duhet ta thoshte. Cili qe ai zë, nuk u mor vesh. Lora diç tha një fjalë nëpër dhëmbë, si të përtypëte zemërimin e një barre të lodhshme.

— Ai po pyet, moj motër, dhe ti na thuaj. Se edhe ajo fletërrufe këtë trajton, por Gjoka...

Kujtimi nuk e mbaroi mendimin deri në fund.

— Po, éshtë! — tha Lora.

— Dhe ti i del krah një fanaticu?!

Salla mbeti e çuditur, me ca fjalë të ngatërruara, që u përzien me të qeshura. Gjokës iu duk

1) një vendim i trashëguar apo i marrë, i vënë si rregull pér t'u zbatuar.

se i lëvizi zemra vendit. Regës iu drodh buza, pa erdhi e iu rrudh balli vetiu dhe iu bë sikur Lora e goditi mu në parzëm, aty ku ajo ruante të fshehur dashurinë. Lora u zu ngushtë. Në saillë zhurma u bë shqetësuese. Aty-këtu, si hesh-tazi, u ndien dhe fjalë të tilla, që nuk ishte mirë t'i dëgjonin vajzat (gjoja sa shumë do ta donte Lora burrin!). Ajo tha se Gjoka e donte dhe Regën si një fanatic (!), por fjala e saj mbeti pa krye në atë shqetësim, se nuk u mor vesh në Gjoka e donte Regën deri në fanatizëm apo e trajtonte si një fanatic. Rega përplasi kapakët e syve dhe kundroi Lorën. Kujtimi qëroi më parë zërin dhe nxori fletorkën e shënimeve nga xhepi: «E di ç'i thonë kësaj?! — pyeti ai dhe tundi fletorkën. — Këngë e re në avaz të vjetër! Na u treguaka dashuria duke punuar veçmas me gruan! Dhe Lora na u mjaftuaka që ai të tregojë faqe botës se e do Regën, por për pushtetin që ushtron Gjoka ndaj saj...» Lora e ndërpreu: «Gjoka nuk e fsheh vreten,» — tha ajo.

— Gjoja! — i tha ai.

— Rega nuk të është ankuar, — i tha ajo.

— E mandej?! — tha ai.

— Përse ju shqetëson kaq shumë kujdesi i Gjokës për të shoqen? — tha ajo.

— Jo kujdesi, por mendimi se gruaja jeton me frymën e burrit, — tha ai.

— Ju doni që ai ta lërë të harruar e të përhumbur?!

Lora pyeti. Genci mendoi se Kujtimi që një «Bashebush». (Kështu e pati krijuar një fjalë me menidtë e veta!) Bashebushi ngatërrrohej së kotti me shqetësimin e të tjerëve dhe, paçka se nuk ishte në dijeni të plotë të problemit e të rrethanave, diktontë si të që mbrojtës i flaktë i të drejtave shoqërore: bëj kështu e bëj ashtu! Ba-

shebushi e ndante shpejt nga qëndrontë shumica dhe «fët!» (për të nuk kishte rëndësi argumenti), nxirrte nga xhepi një bllok shënimesh: «Ne jemi të mendimit...» Bashebushi kishte dhe aftësinë e çuditshme ta kuptonte të deleguarin në sý dhe «fët!», fletorkën e fuste në xhepin e pantallona-ve e korrigjonte se duhej bërë kështu dhe jo ashtu, por... Dhe ajo lidhëse i jepte cilësinë e shpëtimtarit që, dhe në pati gabuar përfaje të të tje-rrëve, tani e kuptoi problemin dhe evoluonte. Kështu Bashebushi mbetej gjithmonë brenda, si një krimb në mëshikëzën e vet. Fletorkën e linte në xhepin e prapmë të pantallonave dhe luante vetëm gishtin përfje të theksuar se qe vepruar gabim: por... Bashebushi nuk vuante përmend. Ali, po! Rega mungoi në punë se ishte e sëmurë, mirëpo atë ditë mungoi dhet Gjoka. Coi te mjeku të shoqen se nuk kishte besim te komandantja e sektorit apo tek infermierja. U pa në pazar të Lushnjës dhet... «Praf!», e mylli fletorkën e shënimeve me një të përplasur të kapakëve: «Ja kù të çon fanatizmi, shokë! Të humbet dhe ditën e punës!»

— Po, se patën frikë nga komandantja e sektorit, Lina, dhe infermierja Marie! — u tall Sokoli. Salla qeshi.

Në atë gaz të papërbajtur, Gjoka ngriti zërin e tha se të tjerët dinin të flisnin bukur, por ai dinte të thoshte të vërtetën. Ariani i bëri shenjë të heshtje dhet Gjoka heshti. Bujari u ngrit e tha: «Të na falë shoqja Lorë!» Lora po dëgjonte. Dëshuria e Gjokës paskësh qenë e shtirur dhet jo ashtu si e paraqiste ajo, Lora, një dashuri e madhe (!). Kështu tha Bujari. Malësorit po i merrëj mendja. Zëri i Bujarit po i dukej si zëri i dy pllakave prej metali që, sa herë përplasen, nxjerrin tinguj të ndryshëm, herë të hollë dhet herë të trashë, herë të gjerrë dhet...

— Pse?! — pyeti Lora me kérshéri.
— Se nuk do që gruaja të bëjë çap pa urdhërin e tij, prandaj.

Rega drithërohej, kur dëgjonte të thuheshin fjalë për dashurinë e Gjokës. Këtë e dinte vetëm ajo dhe nuk kishte përsë të ngaçërrrohej me atë, dashurinë e Lorës, si mundohej Bujari t'u mbush-te mendjen të tjerëve; gjoja sikur Lora kërkonte të mbronte Gjokën dhe harronte se fanatizmi dinte të vishej dhe me fustan të prerë sipas modës. Sokolit iu duk një figurë e bukur dhe pëshpëriti shend e verë: «Je poet, Bujar! Bukur!» «Tjetër Bashebush kv!» — tha Genci me vete për Bujarin. Lora pruri një shembull të thjeshtë. Ç'do të ndodhë sikur Gjoka të pinte një gotë birrë me të shoqen në sy të fanatikëve?! Këtu ajo ndiente shqetësimin e botës kanunore që, edhe kur bin-dej në virtytet e larta të gruas, i jepte asaj emrin «burrëreshë», se gjatë kohës nuk ia gjeti dot një emër të vetin, por e la të harruar e të papërfillur. Ndërsa Gjoka, të paktën një herë në jetë, i që bindur forcës së gruas: kur ktheu rrugën. Dalëngadalë ai do ta quante shoqe në mendimet e veta dhe do t'ia dëgjonte fjalën. Lorës iu duk sikur disa e kishin marrë me të rrëmbyer dhe qëllonin pa vënë re, mjaft që të hidhnin një gur!

— Ke të drejtë, Lorë! — vërejti Bujari dhe përmendi ca fjalë të usta Petros: «Hë, djalosh?! Do ta rritim njeriun apo...» (Ai këshillonte ta shkurtonin ca atë hapin e rrëmbyer, se heroizmi nuk qe marrëzi që mund të rrezikoheshe dhe përnjë pilotë.) Kështu edhe bota e Gjokës, po të gjykohej me urtësi, nuk mund të flakej tej si një leckë, ajo duhej gdhendur.

Gjokës i dukeshin më të rënda fjalët se trarët e mbajtur mbi shpatulla. Rega shëmbellente një

Pece të pluhrosur, që po ia shkundnin përpara fytyrës dhe, tek rrudhi sytë, ndjeu dhimbje. Ajo përsëriti dy-tri herë me mendje si mund të flakej Gjoka si leckë. Po të qe i atillë, ajo do të qante dhe do të ulte kokën përpara shoqeve e grave në bjeshkë, ku Gjoka u mundua dhe i mbushi mendjen Çan Bugit të Hirajt, që nuk deshi ta linte Regën në hekurudhë. Atëhere për herë të parë e kishte parë të vjehrrin me ca sy të çuditshëm:

— Mos e shtjell ma gjatë.

— Për gruan teme?!

— Ke me ia pa hajfirin asaj mendjes sate atje!

Po të donte, le ta kuptonte i biri se Çan Buçi i Hirajt fjalën e burrit e kishte me nderin e vet: në pyetje dikur i ati i nuses, sa ajo ishte vajzë, tani babë për të ishte Çan Buçi dhe nuk qe gur i lënë në bjeshkë.

Po ja që i biri e ktheu në rrugë:

— Pse, si e mendon ti udhën e hekurt, o babë?!

Rega pa së si plaku erdhi e u vrenjt:

— Kush të tha se e mendoj keq?! Qe tek e ke pushkën! — ia tregoi ai pushkën varur në mur. — Dhe, në ke mund ti me e qëllue qiftin në fluturim, unë ta kam mësue me atë pushkë! Tani po do me më mësue ti?!

Rega u hutua kur pa atë plak hijerëndë ta ndiente veten ngushtë me të birin dhe iu duk sikur iu drodh i gjithë trupi, kur kërkoi mendimin e saj, për t'i vënë kapak bisedës. Ajo e pati ngasuar atë me malet dhe, ndonëse plaku e pati harruar gjumin, Rega çohej më herët nga ai dhe nga njerëzit e shtëpisë se kështu e pati porositur e ëma, të merrte fshesën e të fshinte oborrin, të vinte valsuerin në zjarr e, sa të ndiente kollën e

të vjehrrit të nxítonte t'i hidhte ujë pér të larë fytyrën. Ajo e ndjeu se atij iu errën sytë kur kérkoi fjalën e së resë. Qe hera e parë që i vjehrri mbas pesë muajsh martese, e pyeste dhe ajo duhej t'i përgjigjej, se gjithmonë e pati dëgjuar në heshtje dhe vetiu i qe bindur.

— Nuk di me të thanë gja, babë! — iu përgjigj Rega.

— Të lumtë! A do me shkue, jam tue të thanë, se me ditë... Di unë mandej!

— Po, babë! Në mbledhje na thanë se për ne ka folun shoku Enver.

Plaku u pre. Regës iu duk sikur atij iu droah buza nën mustaqe. Pa nga pushka. Pushka heshite e varur në kryevend.

— Shuej, oj nuse, se më ke vra! — rrotulloi ai kokërdhokët e sypë. — Fort randë po më ardhka, se ka me u përrallitë bota në shtëpinë temë, ti por dhe mos me shkue, nuk më ardhka mirë, tha Çan Buçi dhe u soll nëpër dhomë, drodhi e ndezi cigare, e thirri të birin. — Due me t'i thanë nja dy fjalë që Ujkani i Hirajt ia ka lanë babbës tem, Buçit, për me m'i thanë mue, unë ty dheti fëmijëve të tu: «Bani rrugë burrnisë e mos u përrallit në trimni! Fushat kanë dashtë me u naltue e jo malet!» — dhe mandej plaku rëndë-rëndë shkoi dhe e puthi Regën në ballë. — Ty të paça, nuse!

Rega e kishte kuptuar mirë të vjehrrin dhe atij dò t'i vinte keq, po ta përgojonte, prandaj dheti ruante të fshehtën. Tek e shihte Gjokën me ato pikëzat në fytyrë, asaj i dukej më burreron. Ashtu ishte ai.

Në sallë ndihej clodhje.

Tusha u ngrit e tha:

— Më ka tregue nana, prandaj edhe unë deshta

me ju tregue. Në mälësi, kur shkonte çika nuse, i jepnin si pajë dhe nji pashë litar, «Litari i nuses», i thoshin. Unë flas pa drojë përpëra jush, se të tanëve ju kam si vëllazën e motra...

Martës se si iu duk ai litar që qëndronte nën dyshekun e martesës dhe e ngjasoi me beronjën, që fshihet e sulmonte çdo gjë të gjallë. Asaj i kishte mbetur ndër mend një përfytyrim fëmijësh, se po të vije një pllakë guri atje ku do të godiste ai gjarpër, atëherë ai do të copëtohej. Thonë se natën e parë burri zgjaste dorën dhe e merrte litarin nga fundi i dyshekut dhe e qëllonte gruan në shpinë. Mandej litari qëndronte nën dyshek të martesës tërë jetën... Tusha pyeste në ishte Gjoka fanatik. Gjoka nuk kishte litar t'ia tregonte Regës, por kishte frikë se mos Rega i dilte duarsh.

— A je e marrë, a?! — tha Marta e trembur.

Rega vështron te me ca sy të mëdhenj dhe zëri i Tushës vinte si një shungullimë e largët.

— A të pyes, Tushë? — tha Lora.

— Tash due me të kallxue për Gjokën e mandej pyet, — tha Tusha. — Nji ditë e caktuen me punuë te shinat. Ai shkoi me shokë, por u kthyesh vetëm në fanë atë rrugë të largët e nuk u drekue atje, me shokë. Rega edhe në mensë len shoqet e shkon e rri në nji tavolinë me të. Rrinë vetëm të dy.

— Po këtu nuk ka asgja të keqë, Tushë!

— Ka, se ndahet prej shoqesh, Lorë!

— Dhe rri me burrin, — plotësoi Lora.

— Nuk e len burri, thuej!

— «Burrnia» as do më ditë për gruen, Tushë. Dhe nuk e mbani pranë — nguli këmbë Lora.

— Unë e kam lanë të fejuemin dhe as kam pyetë për burrni të kurrkujt, — kundërshtoi Tusha në çast, — por ti, Lorë, po do që malësorja të jetë e niënshtruemja e burrit e mos me gu-

xue me hedhë nji hap të vetin, as bukën mos me e hangër pa praninë e tij.

Salla mërmëriti si një valëz deti.

Gjoka tha:

— Unë nuk jam i zoti me u mshehë mbas sjelljeve të reja, por kam zbritun në hekurudhë me Regën, për me pa jetë me sy e me ndejtë ma lirshëm.

Salla ia ndjeu frymëmarrjen.

Një i dha të drejtë.

Një e kundërshtoi.

Vajzat mbetën të përgjonin fjalën e tij. Lora me gishtin e vogël godiste tavolinën me shqetësim. Rega ngashëreu padashur, kur pa Gjokën që ngriti dorën dhe e lëvizi si për të kapur fjalët e veta. Ajo dorë iu duk e madhe, e ashpër dhe vrazhdësinë e saj ajo e kishte ndier mu aty, në parëzm. «Po a e dini ju se ajo deri më dje nuk më thërriste as në emën dhe vetëm këtu, aty te përrroi, filloi me më quejtë Gjokë? Se për të unë kam qenë burri i paemën... E ju?! — pyeti ai tërë mllef dhe përsëri e ngriti dorën si për të kapur mendimet e veta. — Urdhéroni e flisni tan!» Marta ndjeu freski. Genci pyeti hidhur se kujt nuk do t'i pëlgente të punonte në hekurudhë me të fejuarin, burrin apo gruan?! Dhe prandaj duhej mbajtur qëndrimi ndaj atyre që mblidhnin fjalë dhe hidhni gurë. Lora seç ndjeu një ngazëllim.

Ariani pyeti Gjokën:

— A deshe të ikje nga hekurudha, Gjokë?

— Fol, Rega! — tha Gjoka pa u çuar nga vendi. — Unë nuk po mundem ma!

Dhe Rega u çua, pa pérreth me sy shqerre dhe deshi të buzëqeshtë, por ndjeu se po i dridhej buza, pa nga Lora dhe Lora e miratoi me tërë qenien:

— Po, asht e vërtetë, — tha Rega. Salla e mehy frymëmarrjen. — Ai deshi me u largue, por nuk iku.

Në sallë u rrähën shuplaka. Vajzat zgjatën kryet për të parë atë malësore që kishte arritur të thyente mendimin e një burri. Rega mbushi sytë me lot dhe e ndiente veten të lumtur që arriti të bindte dhe të tjerët për dashurinë e saj. Djemtë dëgjonin me kureshtje. Ajo thoshte se nuk kishte bërë dashuri (dhe këtë Lora e dinte, se ajo ia kishte thënë te «rruga e hekurit») dhe ajo tani po e njihte më mirë Gjokën dhe ai...

— Me thanë të vërtetën, unë nuk kam besue se Gjoka ka me ma ndie fjalën... Po edhe ty, Tu-shë, desha me të thanë se, kur u fejuem na (sak gjashtë muej kemi martue), Gjoka nuk më ka ble me pare dhe unë nuk kam qenë robinë e tij, ashtu si thoni ju. As Gjoka nuk do me më pasë robinë se, po të qe ashtu, ai vetë kishte ardhun në hekurudhë dhe mue më kishte lanë atje, te Bjeshka e Hirtë, dhe... Unë nuk kam me u nda prej tij, se kam nevojë me mësue prej tij dhe unë...dhe unë... — nuk diti ç'të thoshte më tepër ajo dhe mbeti e hutuar, kur pa që të tjerët diç prisnin edhe më, se vetiu e kishte ngritur zërin: «Dhe unë... dhe unë...» — e pastaj u qetësua përsëri. — Ai përzuni kushërinin e të fejuemit të Martës nga mbramja, pa i thanë kurrikush. Po shpotinë e Gjokës ai malësuer nuk ka me e harrue sa të gjallë mbi dhë. Ky asht Gjoka dhe unë i thashë mirë bane që e përzune, paçka se qe gati me u rrähë me të, — tha Rega pa menduar se diçka të tillë nuk e kishte dëgjuar nga i shoqi dhe ai tani heshtte pa e pasur mendjen. — Prandaj unë desha me e ditë dhe ju lutem me ma thanë në e kam nji faj temin, — tha ajo si me një frymë dhe u ul.

Genci kërkoi leje të largohej, por askush nuk

e pati mendjen tek ai, se jetonin ende me fjalë e Regës ndër mend. Zhurma e sallës u fasht ngadalë dhe Regës heshtja iu duk e rëndë. Ajo deshi t'i kapte dorën të shoqit e t'ia shtrëngonte fort, por druhej se mos e shihnin.

Marta pa përreth. Qafa e gjatë shëmbëllente si e mermertë dhe fytyra në ngjyrë pjeshke, me buzë të holla e hundën pak si në të përpjetë. Rega kryqëzoi gishtat dhe filloi t'i ndrydhte derisa i dhembën.

— Unë jam Marta Preka e Prekë Gjekë Kolës, malësore, — renditi Marta prejardhjen e vet, si bëjnë zakonisht malësorët pér të treguar krenarinë se kanë qenë lerë e rritur në atë vend gjysh pas gjyshi. — Para se me i thanë dy fjalë të tjera, desha me e pyetë Gjokën. A mundem?

— Urdhno, Marta! — tha Gjoka nga vendi, i gatshëm të dëgjonate.

Rega mbeti me gishta shtrënguar.

— Ty të lumtë, se si burrat e ke ba! — i tha Marta dhe pastaj u shpjegoi atyre që e dëgjonin se ishin nga një fshat, prej Hirajt, dhe ia njihte babën Gjokës, por as ai dhe as baba i saj nuk mund ta ndienin gruan në kuvend e jo më të kishin pér këshillë dhe mendjen e saj. — Unë vetë e para kam me u ngritë e kam me të lavdërue që malësi, Gjokë, por desha me ditë pse mos me pranue me i dhanë të tjerët dorën grues, kur hyppin në tren të punës? Me u kuptue, kur ti nuk ndodhesh pranë.

— Po ti a e njeh krahinën tonë? — pyeti Gjoka.

— Po, e njoh!

— Epo si me e lanë, Martë?! — u tall Gjoka zemërçiltër. — Apo kur të kthehem i në fshat të thonë jo i dhamë dorën, por e quem «hopa!» Re-

gën dhe e hypëm në tren... E Gjoka?! Aty pari ndodhej budalli e nuk tha gjë.

Lora lagu buzët, si t'i ishin tharë. Sokoli kroi zérin. Tusha gjeti rast e pyeti:

— Po në punë, Gjokë?

— Po edhe në punë ashtu kishin me thanë. Tu shë e Kreit: Gjoka kishte humbun andej e na kemi punue me të! — dhe Gjoka qeshi vetë aq me gjongël, sa dhe të tjerët qeshën, pa menduar se ai ishte i dëshiruar të përqeshte zakonin edhe pse ende jetonte me të.

— Kuku, bjeshka mandej! — tha Marta dhe vështroi me sy zjarri, që ngjanin si sytë e nuselalës. — Gjoka-burri bani si i tha Rega-grueja!

Mbas mbledhjes, Gjoka doli me Regën rrugëve të qytezës.

Dikush hynte në bujtinë, dikush dilte, një këndonte me zë. Dyqani ishte mbyllur. Rega e kishte kapur Gjokën për dore dhe, sado që ai mundohet ta largonte, ajo ia shtrëngoi gishtat e ash-për edhe pse ndjeu «marrinë e vet», por deshi të tregonte se dhe ajo nuk druhej në sy të gjindjes të përkëdhetë burrin, që kishte guxuar të ndeshej me «ariun e bjeshkëve». Ai ari i ngjau sikur kishte zbritur edhe në hekurudhë e Gjoka u kap shpatullash me të, i vuri stërkëmbëshin për ta përbysur, por nuk mundi dhe ata e lëshuan njëri-tjetrin, duke nxjerrë shkumë nga goja dhe... «aaaa!», bërtiste ariu! Sa të mbushej Gjoka me frymë, pa... hëhë!

Gjoka tërhoqi dorën, se ndjeu të qeshurit e dy vajzave që u kaluan pranë dhe u larguan. «Praj, Regë!» — tha ai. «Kam me të përqafue!» — i tha

ajo. «A ke luejtë mendsh, a?!» — i tha ai. Rega nuk ia lëshoi dorën: «Kur të jemi vetëm!» Ajo provoi ashperzinë e një dore, tek ia shtrëngonte gishtat, aq sa nuk mundi t'i hapte më dhe t'i shkëpuste nga ajo pëllëmbë e vrazhdë. «Ka me na le nji vocërrak, Gjokë!» — i pëshpëriti ajo, si me një frymë, tek ndjeu se diç i lëvizi në bark, dhe sakaq iu përkëdhel mbi sup. «A je e marrë, a do me u tallë?!» — vërejti Gjoka mbi supin e vet, por ajo ia mori dorën në pëllëmbë dhe, me kujdes të mos e shihte njeri, ia vuri te barku, pak nga e djathta, dhe ai ndjeu të goditurat, si të rracha të çregullta të një zemre.

TRËNDAFILA NË RRETHORE

Mbi cepin e palltos, aty nga fundi, Artinit i varej një fije e bardhë peri dhe ai as e kishte pasur mendjen të shihte veten më parë se të dilitte nga baraka. Te dera u kujtua se qe dhe i pakrehur. U kthyte përsëri dhe u kreh shpejt e shpejt, duke u parë në pasqyrëzën e vogël, aty mbi tavolinë, pranë fotografisë të së shoqes. Atë ditë qe dhe i parruar, ndonëse e shoqja ndër këshillat, si porosi të parë, i kishte lënë të rruhej çdo mëngjes. Dhe ai queshte me të: «Sa herë më kujtohesh ti, Jeta, do të rruhem unë!» Megjithatë ai Artin i shkujdesur asaj i dukej më i çilët, më i afërt, më i padruajtur; paçka se në rrethin familjar ajo ankohej se ç'e kishte gjetur me atë burrë! Mbi tavolinë kishin mbetur fletët e shpërndara të letrës, që Artini ende nuk ia kishte nisur së shoqes.

...Dhe do të derdhim kushinetat me markën pesëqindëshe, Jeta! Janë të parat kushineta, që ne ndërtojmë ashtu si dimë vetë, dhe unë nuk kam më frikë ta mbaj trenin mbi shpatulla. Të kujtohet nata e korrikut, kur ti deshe që unë të çlodhesha nga mundimi i tepërt i punës?! Më ke dhënë fjalën se do të qëndrojmë të dy nën urë dhe...

Qyteza kishte të tjera shqetësime dhe të tjetra halle. Asaj i duhej të gruponte forcat vullnetare dhe t'i niste në drejtime të ndryshme,

duke pritur të mësonte përfundimin e një dite
dhe të njehsonte vlerën e saj me betonin e he-
dhur, me trasenë e shtruar... Ajo regjistronte dhe
copëra bisedash të mbetura nga e kaluara si ske-
lete dialogësh që, aty për aty, shuanin thjesht një
kureshtje ndër banorët e qytetës. Në ato bise-
da flitej dhe për një urë, që rrinte e mbështetur
në dy pikat.

«Eshtë një urë e vogël. E vogël, pos!»

«Inxhinier Artini bëri dhe një projekt për
një urë të madhe, projekt të bukur, por ç'e do!...»

«I kishte mbetur në letër. Në letër, pos!»

Qe një ditë e thatë janari. Artini doli nga
baraka dhe pa nga qielli. Qielli, gri. Era frynte në
drejtim të kodrave e, megjithatë, tymi i oxhakëve
herë-herë vinte i përzier, si të frynte moreni. Arti-
ni hoqi fijen e perit nga palltoja dhe doli të pin-
te kafen e mëngjesit. Ai i kushtonte kujdes të
veçantë ndërtimit të urave. Mjeshtrit tanë të vjet-
tër kishin ndërtuar bukur nëpër botë. Thonë se
për Urën mbi Drin, mjeshtri kërkoi që më parë të
shuanin gëlqeren dhe, kur të kthehej ai, mbas
dhjetë vjetësh, të fillonin ndërtimin. Dhe mjeshtri
iku të ndërtonte nëpër Ballkan e gjetiu. Pas dhjetë
vjetësh u kthye. Mjeshtri urdhëroi që çdo banor
i asaj ane duhej të hidhte mbi llaç një kokërr ve-
zë. Të vjetrit tempujt dhe urat i ndërtonin me
madhështi, por vetëm në ura dhe në kështjella
bënин kurbane. Dhe legjendat më të shumta qe-
në për urat dhe për kështjellat e arrinin deri
në flijimin njerëzor, ndërsa për tempujt legjendat
nuk përmbanin të tilla flijime. Prandaj dhe urat
duhej të qenë të bukura, se ato ishin vepra arti
dhe u përkisnin të gjithëve, që nga kohët e lashta.

Në mensë nuk kishte njeri. Katina i uroi mi-
rëmëngjesin.

— Nuk paskan ardhur ata?! — pyeti inxhineri.

— Cilët «ata»?! «Ata» ka shumë kjo mensë.

— Shokët, pra! — tha Artini i nxituar.

Atë mëngjes inxhinieri asaj iu duk i harruar dhe mendjeprishur.

— Erdhën, pinë kafe dhe ikën. Por më parë «mirëmëngjesi», inxhinier.

— Më fal, Katinë! — tha ai, pa orën dhe mori të kthehej. — Më gënjeu koha dhe kujtova se jam herët.

Ajo e pyeti në donte të hante mëngjesin. Ai i tha se nuk kishte kohë e shpejtonte për në mbledhje. «E mora vesh, — tha ajo dhe nxitoi e vuri xhezven në zjarr. — Prit të pish kafen!» Artini u ul në një nga tavolinat përballë dritares së kuzhinës. Kafja ziej e Katina fol! Ndihmëskuzhinierja qëronte patatet dhe dy vullnetare lanin enët.

— Thonë se do të bësh një urë të madhe, inxhinier, — tha ajo me mendjen te xhezvja.

— E madhe është, por të shohim.

— E pse të shohim?! — pyeti ajo.

— Me të thënë e me të bërë...

Ajo ofroi kafenë dhe u mbështet mbi sportel. Artini u ngrit e mori kafen.

— Nuk ta ha qeni shkopin ty, jo! — tha ajo.

— E ha, nuk e ha... Po nuk qe i zoti të mbrosh punën tënde, të ha qeni! — shpjegoi ai më tej mendimin e vet.

— Uuu?! Ti nuk je i zoti?! — pa ajo nga matanë sportelit me njëren vetull ngritur përpjetë.

Inxhinieri piu kafen dhe iku. Atë ditë në zyre kishin ardhur dhe nga shtabi qendror i heku-

rudhës, se bëhej fjalë për një projekt të ri ure. Artini zuri vend në karrigen e lënë bosh, pranë tryezës së madhe. Ura do të fillonte që nga tune-li i Rrogozhinës e do të shkonte deri te Qafa e Shpendit. Një urë gjarpëruese, thuajse dy kilometra, e përfshirë midis dy kodrave, në atë lugine do të kishte bukurinë e vet. Pyetja e parë që iu bë inxhinierit qe se ku do të derdheshin këmbëzat e urës, ndërkoqë që ne parafabrikate të tillë nuk kishim. Ai shpjegoi qetë-qetë se kishte menduar t'i derdhte me vullnetarët. Inxhinier Tosuni llogariti se mbeteshin dy-tre apo pesë hektarë tokë pa u mbjellë, në një kohë kur në vendin tonë një kokërr gruri vlente sa një kokërr plumbi. Kështu tha ai dhe kjo i ndrydhi njerëzit. Artinit i rëndoi koka dhe rrudhi ballin mbi vetulla:

— Po edhe me dhimbje do ta ndërtojmë të bukurën, Tosun! — dhe një çast ai pa nga inxhinieri e uli zérin. — Një urë e tillë mbi viadukt do të jetë e para në vendin tonë. Kësaj hekurudhe i duhet, — theksoi Artini dhe shtypi bishtin e cigares në taketukën mbi tavolinë.

Inxhinier Tosuni kundërshtoi përsëri. E bukura duhej të ndërtohej me leverdi dhe, sakaq, me majën e lapsit ai bëri në letër një vijë dreddharake, për të ngjasuar rrugën që do të bënte traseja e zhavorrimit apo ura. Po të llogariteshin shpenzimet e mëtejshme, ato i tejkalonin edhe një herë më tepër shpenzimet e zhavorrimit.

— E di, — tha Artini.

— Atëherë?! — pyeti Tosuni.

Artini i ofroi një fletë letër me përllogaritje të ndryshme dhe shpjegoi se për pesëmbëdhjetë vjet mbishpenzimet shlyheshin nga prodhimet e tokës së kursyer nga hapësirat e këmbëzave të urës. Mandej ura për dyzet vjet shlyente vetve-

ten, ndërsa zhavorrimi... Fleta mbeti në tavolinë si e pavlerë.

— Këtu e dyzet vjet, Artin...

— Traseja e zhavorrimit nuk mbulon asgjë, qoftë edhe për njëqind vjet, inxhinier.

— Ndërtojmë sot e kursejmë sot, inxhinier!

— ia përmendi edhe Tosuni ofiqin.

Artini nguli këmbë se toka kushtonte më shtrenjtë. Zyra e këshillit teknik ishte e vogël. Tymi i duhanit shpërndajahej duman, në rrathë të rënduar e qëndronte pezull. Usta Petroja u ngrit dhe hapi dritaren përgjysmë. Nga jashtë hyri të ftohtët e janarit.

— Na mbyti tymi! — tha Petroja ende pa u ulur në vend.

— Duhet ruajtur toka, inxhinier! — e nguci Artini bisedën më tej.

— Larg dyzet vjet, Artin! Larg!

— Pse larg, inxhinier Tosuni?! — pyeti Petroja në çast.

Zëri i tij qe si i gërvishur dhe tërroqi vëmen-djen e të tjerëve. Tosuni mblodhi supet dhe padashur u kolli. Pastaj dhoma ra në heshtje dhe u duk sikur të ftohtët po ndihej më tepër.

— Atëherë, sigurisht ne do të jemi më të fortë dhe prodhimi i asaj toke as do të bjerë në sy, — tha Tosuni me një nënqeshje të lehtë.

Petroja ndjeu se ndërhyrja e tij qe e nxituar.

— Jo, po... Nuk duhet menduar vetëm për sot, inxhinier! — përtypi fjalën ai nëpër dhëmbë.

— Ti je usta dhe, po nuk ndërtove sot me le-verdi, nuk ke bazë për nesër.

Inxhinier Tosuni shtriu dy pëllëmbët e duar-ve mbi tavolinë. Usta Petroja tha se një urë e bu-kur në këtë hekurudhë nuk qe e «burgjezit,» qe jona: «Ja, këtë desha të them! Sigurisht, mbas

dyzet vjetësh do të ndërtojnë dhe më bukur, por duhet edhe ne... Edhe ne, inxhinier, edhe ne. Të mos na shajnë fëmijët tanë, se është e rëndë, kur të shan fëmija, inxhinier. E rëndë, ta marrë e mira, kur mendon se pret dorën e fëmijës tënd të nxjerrë nga varri... Po edhe toka do të na duhet dhe jo pér dyzet vjet, por pér gjithë jetën: është jona, tokë buke dhe nuk ke ku e gjen, po të duash, edhe një pëllëmbë më tepér. Por edhe që të mençmit janë më të paktë, edhe këtë e di. Pér kaq unë e vrava mendjen,» — foli Petroja me duf. Dhe të tjerët solën. Nga dritarja gjysmë e hapur hynte ajër i freskët. Artini tha se deshi të pyeste. Tosuni rrrotulloi lapsin ndër duar dhe vështrimi i vajti te fija e letrës me shifra të llogaritura.

— Cili është më afër, viti 1967 apo viti 2000?
— pyeti Artini.

Tosuni e pa dhe nuk e kuptoi se ç'deshi të thoshte inxhinieri. Sytë e Artinit iu dukën të fshehtë dhe, në heshtjen që u krijuar, përgjigjja e nxituar do të gabonte cilindo.

— Ti do të lozësh kalambur?! — pyeti Tosuni.
— E kisha fjalën si largësi kohe, — tha Artini.

— Sigurisht 1967-a, — tha Tosuni. — Është më afër.

— Ja që gabave, inxhinier! Gjashtëdhjetështata nuk kthehet më pér të korrigjuar dobësinë tonë, prandaj...

U duk sikur Tomka klithi dhe têrroqi vëmen-djen e të tjerëve se Artini po lozte kalambur. Petroja shoi cigaren. Atij iu duk ca si i cuditshëm mendimi i Artinit, kur fliste se rinia punon-te në hekurudhë dhe jetonte marrëdhënie komuniste pérderisa kryente punë të papaguar. Ja, kjo

nuk i kishte shkuar ndër mend! Ai përmendi dhe proverbin latin «Sub specie aeternitatis»¹⁾ dhe e përshtati mendimin se duhej të ndërtonin për të ardhmen. Dhe nuk bëri shaka në paraqiti aty një projekt, se nuk bëhej shaka me punën. Ai deshi t'i thoshte vëtes se bëri aq sa mundi, për të mos u ndier fajtor. Gjashtëdhjetështata nuk kthehej më, edhe nëse pas dyzet vjetësh do të ndërtohej edhe më mirë dhe më bukur. Prandaj viti dy mijë ishte më afër. «Dhe ne duhet ta sjellim në praktikën e punës, — tha Artini, — ndryshe, po të mendosh vetëm sot për sot, nuk ka komunizëm.» Ai do të bënte një urë të bukur të ngritur mbi viadukt dhe treni do të dukej sikur do të ecate i mbajtur mbi krah. Po ajo urë donte plot shtatëmbëdhjetë muaj të ndërtohej.. Kjo i shqetësoi njerëzit.

Usta Petroja doli i fundit nga mbledhja dhe gjatë rrugës po fliste me vete, tërë nerva: «Po pse, more, të kripsha trutë! Mos do të prishen planet e shtetit për mendtë e tua?! Ne për një vit mbarojmë hekurudhën dhe ti... dy vjet për urën! Eh, Artin Rrapi! Do të kishim një urë të bukur, po të kishe menduar me kohë.» Artinin ëi e gjeti në dhomën e vet. Kur hapi derën, Artini nuk foli. Petroja u ul në anë të krevatit dhe e vërente kur trazonte librat në tryezë. Ca i merrte nga ajo dhe i shtinte në arkën e madhe dhe ca i nxirrte nga arka dhe i rendiste në tryezë. Portreti i së shoqes qe hedhur në një anë mbi ndenjësen e karriges, ku qe ngatërruar me pasqyrën dhe veglat e rrojës.

— Bukur u mbrojtën dhe ata! — tha Petroja pa përmendur se cilët.

1) në shikimin e përfjetësisë.

Ai thithi cigaren dhe priti të fliste Artini. Artini mori portretin e së shoqes, e fshiu me një leckë për t'i hequr pluhurin dhe e vendosi në pezul të dritares. Nga fotografia, Jeta vështronë shqetësimin e tij. Petroja tha përsëri se ata u mbrojtën bukur dhe pështyu një thërrime duhani mbetur mbi buzë: «E gjetën shtegun e hapur,» — e nguci Petroja më tej bisedën, kur pa se përsëri nuk mori përgjigje. Artini ktheu kokën nga ai dhe përsëri nuk foli. I kishte kthyer kurrizin dhe nuk dinte ç'bënte: dhe i rregullonte librat, dhe i prishte. I dukej sikur ndiente ethe dhe Petroja dalloj se edhe në heshtje ai mundohej të përligjte mendimet. Mandej biseda qe e prerë:

— Ç'kisha për të thënë e thashë.

— Dhe kjo qe e gjitha?! — pyeti Petroja.

Artini e pa në mënyrë të dëshpëruar. Petroja dukej nervoz për gjendjen e shokut.

— Unë nuk mendoj vetëm për sot, — tha Artini dhe u kthye nga ai.

— Po. Kërkon tokën dhe harron kohën! — tha Petroja dhe u çua nga ana e krevatit, shtypi cigaren, iu afrua shokut e ia vendosi duart në supë me lehtësi. Vështrimet e tyre u takuan. Në sytë e tij kishte dhe dashuri, dhe keqardhje. — Në këtë pikë ata kanë të drejtë. Toka duhet të na dhimbet në çdo pëllëmbë të saj, por edhe koha duhet të na dhimbet. Po edhe të bukurën e duam edhe për sot edhe për të ardhmen. Ti harrove të bukurën për sot... Ja edhe ta falën tokën, por kohën ku do ta gjesh?!

Artini u largua, u ul në krevat dhe mbështeti kryet midis dy duarve. Ai kishte harruar kohën dhe kjo e drithëroi, kur mendoi se si e kishte mbytur krijimin e vet. Mbylli sytë një çast, i erdhi rëndë dhe u çua vrik e ndezi shkrepësen të

digjte projektin. Petroja ia rrëmbeu nga duart. Artini vështron te projektin dhe nuk kuptohej se i fliste vetes apo Petros: «Ai nuk u bë në kohë dhe unë nuk dua të lë histori të pavlera mbas. Ja, për këtë e bëra: nuk desha të gënjej kërrkënd, për të më thënë se unë jam një hero. Dhe as kam dashur të bëhem hero... Dhe as ta shes të rëdomtën për vlerë, duke gënjer dhe veten dhe shtetin. Ja, kështu do të përgjigjem dhe në organizatë dhe ajo le të vendosë në bëra mirë që desha të djeg projektin.» Petroja i tha se ai duhej të mësohej si të punonte në kohë. Këtë, po! Do ta bisedonin në orgnizatë.

Artini shikoi fotografinë e Luljetës dhe iu duk se sytë e saj vështronin me vëmendje. Në tavolinë qëndron te letra që ai ende nuk ia kishte dërguar së shoqes dhe fletët e letrës qenë nga-tërruar me skica projektesh.

XIII

Vjeshta kishte hedhur shumë gjethë në tokë dhe i kishte grumbulluar hendeqeve e rrëzave me shtrojerë. Plepat ishin më të shumtë kësaj ane dhe kështu krijohej përshtypja e rreme se të parat që binin në tokë ishin gjethet e tyre. Edhe në pranverë dukej sikur plepat çelnin gjethen të parët, por edhe kjo qe një përshtypje e rreme. Ngjyrat e verdha e të gjelbra në të turbullt e theksonin edhe më pamjen e murime. Ndryshe qe po të vështroje nga kodrat. Ato qenë të veshura me ullinj dhe pamja e vjeshtës vetiu shndërrohej në një gjelberim të përhershëm.

Ky gjelbërim gjallonte dhe tokën me rigimin e barit e prarimin e bimës së grurit ndër fusha. Dhe trëndafilat e krasitur në gusht çelnin në vjeshtë dhe mbushnin oborret dhe postrehët, si dhe lulishtet e sheshet e qytetit. Po çuditërisht vjesh-tën e njihnin nga rënia e gjetheve dhe nga fluturimi i shpesës së egër, që ndillte dimër. Lora padashur ktheu sytë nga qielli. Qielli qe i qartë, i larë me një dritë të fortë, ndonëse qe vjeshtë.

Kujtimi dhe Lora ishin te stoli. Po ai stol dhe po ajo shtyllë me atë megafon në krye. (Ato nuk e ndërronin ngjyrën sipas stinës, por vetëm lagen-shin nga shiu dhe thaheshin nga dielli.) Rrugët e qytezës dukeshin si të lara dhe në të kishte kohë që flitej për ndërtimin e një ure. Ca thoshin se inxhinier Artini po bënte një projekt, ku krahas me njëra-tjetrën do të kalonte dhe treni dhe makina. Ca thoshin se inxhinieri kishte humbur një projekt të bukur ure, vetëm për mendtë e kokës.

Mëngjesi do të qe i lodhshëm.

Kompania e Lorës do të punonte edhe në tur-nin e natës në betonimin e soletës së urës. Betoni do të mbushej nga vullnetarët dhe do të hidhej në traun e urës. Poshtë do të rridhte lumi... (mbi lumë do të kalonte treni dhe mbi tren të parët do të hipnin vullnetarët e, sa herë të kalonte pranë lapidarit të Shkurtës, treni do të vërvshëllente). Kujtimi tha se duheshin lidhur përsë-ri hekura, ndryshe betonimi nuk do të fillonte me kohë. Ata, një pjesë të natës, duhej ta ka-lonin atje. Lorës iu duk se nga larg do të ngjan-nin si ca hije që lëviznin në dritë. Ajo kishte pa-rë një fotografi të tillë të nxjerrë natën, në dri-tën e hënës.

Kujtimi pyeti se ç'do të donte ajo më parë te njeriu. Biseda ndërroi aq papritur, sa Lora u

hutua dhe i kërkoi falje që nuk e pati mendjen.

— Te njeriu të pyeta, — tha ai si i fyer, — ç'do të doje?

— Po... Është ca e ngatërruar puna e njeriut, — vërejti ajo.

— E kisha fjalën për cilësitë, — i tha ai ngaqë yuri re se Lora nuk e kuptoi pyetjen.

— Më parë njeriun, — tha ajo.

— Njeriun??!

— Po çfarë mendon ti?!

— Ky problem lindi dhe për Gjokën, prandaj, — tha ai.

— Po, po! Lindi. Unë do të desha te njeriu dhe atë botën e Gjokës, që e do Regën e mundohet të përbysë bindjet e hershme që i rëndoijnë si ankth.

Ndërkojë aty pranë erdhë Genci. Lora la fjalën në mes dhe Kujtimi nuk pyeti më gjatë. Genci kishte ditë që mendonte e kafshonte buzën për çka i thoshte vetes. Atij i dukej se Lora kishte hyrë në jetën e të tjerëve apo të tjerët kishin hyrë në jetën e saj, ashtu si kishte ndodhur dhe me Gjokën dhe... ndonëse një natë ai numëroi me gishta betimet për të mos e takuar më, kur e pa me Kujtimin, deshi t'i këmbente dy fjalë.

— Eja ulu! — i tha Kujtimi.

— Bën mirë të na lësh vetëm! — tha Genci.

Kujtimi u hutua. Lorës i vetoi njëri sy dhe iu lut Kujtimit t'i linte vetëm. Genci ngjante si i pagjumë. Kujtimi u largua dhe ajo, në atë heshtje të thyer, ndjeu se Genci e kapi nga krahët e po mundohej t'i buzëqeshëte. Lorës ajo buzëqeshje iu duk e shëmtuar, si e lindur nga një ngërc. Ajo lëvizë shpatullat për të treguar bezdi. Ai e shtrëngoi edhe më tepër, Ajo seç ndjeu një turbullim a marramendje, iu duk më fanatiku i fanatikëve, dhe fytyra e tij iu shpërfytyrua në dy koka të

ngatërruara me njëra-tjetren. Njëra dallohej që ishte e Gencit, ndërsa tjetra vinte e zbehtë e përzihej me të dhe... Atëherë ajo nuk duroi më dhe e goditi fort me pëllëmbë. Gencit iu fashit ajo buzëqeshje e shëmtuar ngërçi dhe iu varën duart si të këputura. Ishte po ai stol, po ajo shtyllë, po ai megafon. Lulishten e përqethët era. Genci u largua pa i ndier hapat e vet të rënduar. Atij i dukej sikur nga shpatullat i vinte një e nxeh të dhe llërët e duarve i dridheshin. Lora njërin krah e kishte lëshuar në mbështetësen e stolit dhe gjoksi i gufonte. Mbas asaj që ndodhi as vetë nuk e kuptonte në që përgjumësh, apo i rëndonin kapakët e syve nga zjarrmia që ndiente në faqe, në veshë, në gushë, në qafë dhe trupi sikur po i mbulohej me bulëza djerse nga turpi.

XIV

Qyteza jetonte çaste nga më të ndryshmet, disa nga të cilat mbeteshin të heshtura e disa dil-nin më në pah. Turni i natës ende nuk kishte filluar. Ai do të fstillonte mbresat e veta dhe përmbante në vetvete ëmbëlsinë e fshehtë të muzikës që ndjell nata dhe bukurinë e nji pikture nën dritat elektrike, rrezet e të cilave drithërohen kur era u lëkund llambat. Po të binte shi, shiu do të kërciste në mushama, po të bënte ftohtë, vullnetarët, para se të fillonin punën, do të ngrohin duart me radhë në flakët e një zjarri bubulak dhe pastaj do t'i lagnin ato me pështymë, që të mos u rrëshqiste bishti i lopatës apo krahët e tokmakuat, tek do të ngjeshnin betonin aty te soleta.

— Hë, marrokja, na e mori frymën! — tha Gjoka dhe iu nxehën shpatullat. Duket era i kishte lënë më tepër mbresë në Myzeqe.

— Mjaft që nuk është erë shiu, — tha Agushi.

Ariani pa nga qelli që trazohej si një vor-bull, nga ku ngjante se ngriheshin re të hirta tymi.

— Povjen e përzier dhe prite kur të fillojë!
— tha ai.

— Le të bjerë! Nesër japim lajmin e fitores,
— tha Lora për të thyer angështinë e bisedave.

Ata qëndronin në bazë dhe prisnin lajm në duheshin më të tjerë hekura në armaturë. Gjoka thirri: «Oooja! Shpejtoni, në daçi, se sonte duem me hedhë beton!» Por zëri i tij nuk u ndje shumë, ndonëse thirri me «eho!», si në malësi. Dhe iu duk çudi: fusha ia mori zërin dhe nga armatura nuk iu përgjigj njeri. Bujari qeshi. Gjokës iu frynë flegrat e hundës dhe u nis i çoroditur për atje ku lidheshin hekura. «Përse qesh ti?!» — tërroqi vëmendjen Kujtimi. Ai u shfaj-jësua se nuk po bënte gjë. «U bëfsh lëmsh! Kap hekurin atë bëj!» — tha Agushi. «Ka hekura atje. Po të duan të tjerë, kërkojnë,» — tha Bujari. Pastaj ata heshtën me mendje te Gjoka. Aty dhe përreth nuk kishte as thirrje as sulme. Kishte vetëm një zhurmë të mërzitshme hekurash. Ata uleshin, ngriheshin e prapë uleshin. Lumi vazhdonte rrjedhën. Gjoka ngjiti urrezën me dërrasa, që dredhonte nga poshtë, deri sipër. Kur u afrua, pa se vendi qe aq i ngushtë, sa zëri fashitej e zhurma e hekurave mbytej brenda lugut të drunjtë, ku gjatë shufrave paralele çapiteshin dy hekurlidhës dhe i lidhnin në largësi të duhur. «Sonte duem me hedhë beton,» — tha Gjoka dhe

u ul galiç. Hekurlidhësi ktheu e pa Gjokën mbi krye e nuk foli. Gjokës iu duk si një mospërfilleje dhe ndjeu një afsh të nxehjtë t'i vinte nga brenda drejt fytyrës e t'i merrte fryshtë: «Po dhe në të fola, unë nuk të kërkova send përshtëpinë teme, or mik! Ty, në të duhet gja, lype. Veç sonte duhet më hedhë betonin, ndryshtë ke vra nji brigadë!» — foli Gjoka me duf dhe u çua. Në armaturë hapat iu dukën më të lehtë. Tek zbriste shkallinat, ndjeu se urëza krijonte lëkundje dhe ai vetiu përbante vrullin në të tatëpjetën e saj. Brigadieri thirri të sillnin edhe pesë hekura të drejtë. Gjoka i tha se aty tek armatura i kishte vetëm tri copë. «Duhen pesë të tjerrë, të drejtë dhe jo të kthyer,» — tha hekuridhësi. Gjatë rrugës, Gjoka shpresoi. Sa arriti te shokët, ia behu dhe vetë brigadieri.

Hekura nuk kishte. Brigadieri tha :

— Të gjendet një skodë dhe të shkojë e t'i marrë në poligon!

— Po ju përsë nuk i numëruat?! — pyeti Kujtimi.

— Me sa di ti, dimë ne! Na morën nga objekti edhe na sollën t'i lidhim. Kaq tha brigadieri.

Vetëm kaq. Vullnetarët panë njëri-tjetrin. Ata me gjithë Lorën ishin gjashtë. Aty kishte vetëm hekura të kthyer dhe nuk dinin ç'të bënin. Sekush përbluante një mendim: mendime të vagëlluara. Lora largoi tufëzën e flokut nga sytë. Bujari shkoi dhe u ul mbi hekura. «Po nuk i lidhët sonte deri në orën pesë, do t'ju lidhim ju!» — tha ai. Askush nuk qeshi. Lora pa Bujarin: «Hë, «budalli»! Bënte shaka kohë e pa kohë dhe vështronë si guhak.» Ajo deshi ta fshihte mendimin e vet dhe, pa ditur ç'të bënte, tha të drejtonin hekurat që kishin. Bujari qeshi. Të tjerët

e panë. Asaj i erdhi inat me yeten. Me veten
dhe me Bujarin që qeshi. «Pa çelësa dhe pa ta-
volinë nuk mundet,» — tha brigadieri. Ajo u
lut përsëri ta provonin: një përçapje të marrë
dhe pastaj le të ktheheshin të mundur në qytezë!

— Me se?! Me duar?! — tha Ariani.

— Jo, me... Me flokë! — qeshi Bujari. Ai deshi
të thoshte diçka tjetër, në vend të flokëve, por
i erdhi rëndë nga Lora.

Kujtimi shih te me keqardhje edhe pse donte t'i
bindej dëshirës së asaj vajze. «Kush guxon?» —
tha ajo dhe nderi dorën. U duk sikur të tjerëve
mendimi u mbeti në një pikë të vdekur. Edhe
asaj nate brigada do të bënte gjumë dhe lajmë-
tarët e atij turpi do të ishin ata të pestë dhe Lo-
ra, gjashtë.

— Pse më vështron ashtu, Bujar?! — pyeti
ajo.

— Hë!... Je vajzë, — qeshi ai.

— Mos u rrëmbe, moj shoqe! — tha hekur-
lidhësi. — Nuk ke me se t'i kthesh.

— Me duar! — foli nxituar ajo.

— Nuk janë tela! — tha Agushi dhe zëri i tij
dukej sikur vinte i humbur nga një gropë.

Çdo gjë përreth ngjante sikur dremiste. Dhe
hekurat, dhe lumi pranë, dhe era pranë ngjante
sikur psherëtinte. «Unë jam me Lorën!» — tha
Gjoka në një çast të papritur. Të tjerët hapën
sytë e mblodhën buzët. Asaj iu duk sikur pu-
shtoi qellin dhe i shtriu dorën Gjokës: «Jepma
dorën, vëlla Gjokë!» Ajo e ndjeu atë dorë të
argasur që e para u përplas mbi dorën e saj...
Ohooo! Sa e vogël iu duk dora e vet. Gjokës ajo
dorë iu duk edhe më e vogël e kjo bëri të ndien-
te dhe më tepër forcën e vet: «Ashtu le të bë-
het, si thue ti, Lorë!» Gjoka shtrëngoi në pë-
llëmbë dorën e Lorës dhe as e mendoi se po

vihej në provë me fjalën e një vajze. Në atë dorë të vogël u bashkua dhe dora e Kujtimit dhe pastaj... Të gjitha duart. Lora buzëqeshte dhe mbante në pëllëmbën e vogël duar të fuqishme.

— Po ti, Bujar?! — pyeti Ariani.

— Epo ç'rëndësi kanë betimet?! — pyeti dhe Bujari.

Lora vështronë me druajtje dhe iu duk sikur hamendja e saj qe vetëm një dëshirë dhe pastaj ato duar do të largoheshin dhe përsëri dora do t'i mbetej e vetme, madje do të dukej dhe më e vogël. Buzëqeshja iu fashit ngadalë dhe, nga frika, i pushtoi ato duar midis pëllëmbëve të veta. Ajo donte fjalën e mirë dhe e priste me ankth.

— Do të drejtohen, — tha Gjoka.

— Kapni hekurat dhe i çoni te binarët, dje ma! — urdhëroi brigarieri. Ai porositi shokun e vet të merrte një nga vullnetarët dhe të vahdonte lidhjen.

Lora iu lut Bujarit.

Bujari tha se nuk merrej me lidhka. Dhe nxitoi të bashkohej me të tjerët. Lora dalloi se dhe te Bujari po zgjohet burrëria. Asaj era ia kishte ngatërruar flokët mbi ballë.

— Shkojmë? — i tha hekurlidhësi.

Ajo mori rrugën pas tij.

— Nga je ti? — pyeti ai.

— Unë?! Nga Gurani.

— Dhe unë vullnetar jam, — tha ai.

Ajo urëz dërrase, që ngjitej deri lart në argjinaturë, u kalua me ca pyetje të druajtura dhe as Lora dhe as hekurlidhësi nuk morën vesh ç'u tha e përse u tha. Lora e kishte mendjen tek ata që kishin vendosur hekurin e kthyer midis dy binarësh, të ngulur dhe rropateshin për ta drejtuar

me tërë fuqinë e krahut, duke i dhënë zemër njëri-tjetrit: një, dy, tre! Oooooo!... Nga lart ata du keshin të vegjël dhe Lora nuk ua shihte lëvizjet, veç ua dallonte mundimin në atë zë, që vinte valë-valë: «Oooooo!» Atje ishte dhe Bujari. Ai nuk e bashkoi dorën me dorën e saj. Dora e saj ishte e vogël, gishtat të hollë.

Hekurlidhësi punonte. Lora me një tjetër mbanin në drejtim hekurat. Ajo pyeti në do të mbaronin shpejt. Hekurlidhësi e siguroi, pa menduar se, po të mos drejtoheshin hekurat, lidhja do të përfundonte të nesërmen. Kaq mbeti kjo: një pyetje, një përgjigje dhe pastaj heshtje. Në këtë heshtje tek ura lidheshin hekura me fi je të holla teli.

— Po andej nga ju i fejojnë vajzat në djep?
— pyeti ai.

— Po!

— Po ti, e fejuar je?

— Unë?!

Biseda mbeti e ndërprerë. Andej nga drejtoheshin hekura, nga dihatja thirrja e Bujarit vinte si me dallgët: «Eeeeeç! Loooora! Fitooooore!» Lora zbriti me një frysë urëzën me dërrasa dhe u gjend te shokët.

«Binte shi, usta. Binte shi si me gjyma mbi shpatullat e vullnetarëve. Dhe ata e largonin me kova...» Trilli qe i lehtë: gjatë rrugës, Sokoli shtjellonte shembuj virtyti. Vetë ai nuk ishte ndodhur atje, por ngjarjen e kishte përgjithësuar në ca vargje, ku paraqiteshin heronj me trupa gjysmë-zhveshur që mbanin lart, ndër duar, karroca të mbushura me dhé. Dhe i kalonin mbi kryet e vëta. Vjersha përfundonte: «Vdiq, ore, vdiq!»

Petroja pyeti se cili vdiq (!) «Koncepti burgjez,» — theksoi Sokoli me «u». Petroja ngazellehej... Që andej nga armatura u dëgjua brohorima e vullnetarëve. Edhe Sokoli bërtiti e grishi, Petron të thierriste «urra!». Petroja qeshte. Sokoli vrapoi dhe e ngjiti shkallëzën me një frymë. Ai gazzohej dhe uronte shokët. Dhe Petroja, sa arriti, i përgëzoi. Gjoka i ndjeu krahët të lehtë. Bujarit i qeshi ftyra. Kujtimi ishte gati të drejtonte dhe të tjerë hekura. «Punë e madhe kjo jona!» — tha Sokoli krenar. «Sidomos jotja!» — tha Bujari me romuz. Brigadieri po shikonte dhe nuk e kuptoi se ç'donte ai, birboja, në atë lavdi. «Dhe të prishet mendja, — tha Sokoli i qetë. — Njëqind e shtatëdhjetë vepra arti për t'u ndërtuar, nuk janë pak!» Të tjerët qeshën. Sokolit i erdhë rëndë: fundja, krahë vullnetarësh ishin dhe nuk kishte rëndësi kush punonte më shumë e kush më pak. Dhe kështu rriddhëtjeta e kësaj ane, herë me të qeshur e herë me të menduar. Megjithatë ata nuk ishin fëmijë në gazin e vet dhe as pleq në mendime. Brigadieri zgjati dorën dhe i uroi secilit punë të mbarë. Hekurlidhësi, tek i dha dorën Lorës, desh u pengua. Ai pa me inat gurin, turfulloj dhe çoi dorën përgjysmë, aq sa pëllëmba i arrinte në drejtim të shpatullave, sa për t'i përshtendetur të gjithë njëherësh, dhe u largua i hutuar. Sokoli qeshi. Gjoka tha: «E ke pa ti shkollën, Bujar. Nuk të ka pa shkolla ty.» Kështu thà Gjoka dhe atij iu pre gazi: «Mos u ngatërron me shkollën, se të dalin lakin, Gjokë!» Gjoka kafshoi buzën, si të ndiente pickimin e plagës së freskët.

Ata bënë shumë fjalë. Biseduan për klasën punëtore edhe për grushtin e saj... Sokoli u çudit se si ai Petroja i urtë, që ia pëlgente kaq shumë gazin, po përmendte grushtin e klasës punëtore.

Ajiku pa dëgjuar thirrjen é shokëve dhe lata
hijen e shqetësimit.

Lora tha:

— Ti e ke fajin, Bujar!

— Unë fajin?! — tregoi veten ai me gisht.

— Jo me të përpjekur, djema! — tha Petroja.

— Ne nuk po rregullojmë dot veten, usta. Dhe
jo më të përgjigjemi në i tharton apo nuk i thar-
ton turinjtë Sokoli.

— Po ti mos fol ashtu për shokun! — tha pre-
razi Ariani.

Bujari kërciti gishtat. Dukej që ishte bëre
nervozi: u ul, mori një gur dhe e hodhi. U ul pér-
séri. Përséri mori një gur. Përséri e hodhi.

— Pa shikojeni, djema! — tha përséri usta.

Bujarit i mbeti guri në dorë:

— Ç'të shikojmë, usta?!

— Ti the: veten!

— Veten?! — pyeti Bujari vetiu.

Të tjerët përgjonin bisedën. Lora shihte sa
Bujarin, sa Petron. Petroja pyeti se si mund ta
kuptonte ai veten pa shokun. Ata as e kishin
menduar një gjë të tillë. Qyteza në syrin e Pet-
ros bleronte si një pylli: dhe pylli bashkonte to-
kën më qiellin. Se nga i kishte lindur ky përfyty-
rim i fëmijërisë, ai nuk e dinte, por e ndiente
se duheshin sa më shumë vullnetarë, që të ën-
dërronin e të shqetësoheshin dhe për jetën e
Gjokës, edhe për dashurinë e Lorës... Ajo po flis-
te për një dashuri të madhe, me ca fjalë të nxitura,
sikur t'i lidhë varg, dhe ngatërrroi në ta So-
kolin, Bujarin, veten, e mbeti e hutuar, pa' e
kuptuar përse u ngatërrua dhe..., uh, Bujari pér-
veshi buzën si i paditur dhe të tjerët mëndohe-
shin të shpjegonin hamendjet e saj. Petroja ia
ndjeu shqetësimin asaj vajze, që nuk po mundej

t'i jepté kënd mendimit: asgjë, zemrën të qëruar, pa edhe komunistët ngatérroheshin.

— Me ma ngarkue organizata, unë e rregulloj Sokolin, — tha Gjoka.

Petroja e ledhatoi me vështrim, për të mos e fyer në sedër:

— Është luftë mendjesh kjo. Bujari e ka shok, — tha ai.

— Në kooperativën tonë nuk ka njerëz që vijnë vërdallë. Dhe të rinjtë po mësojnë më shumë se një zanat, — tha Agushi, por edhe ky shpessim u duk i thatë.

Ata bënë shumë fjalë. Edhe Lora ishte aty, me ta.

Ata u çuan të lanin soletën. Nga larg u dukën vullnetarë.

Rega dhe Tusha ecnin pranë njëra-tjetrës. Pak më tej, Marta dëgjonte bisedat e tyre: Qe një ndajnatë në perëndim dielli. Tushës i dukej rrugë pa mbarim dhe biseda e lodhshme, prandaj dhe fjalët i kishte të përtuara. I ngjante sikur e ngushtonte xhaketa, por nuk donte ta mbante zbërthyer.

— Ej ti, Tushë, më ke vra! — i tha Rega.

Regës nuk i erdhi mirë. Kindat e këmishës, si xhubleta të mbledhura, i rrithnin gjunjët, dhe ajo ndjiente vështirësi në ecje. Në mbrëmje vjeshte ajo nxitonte për në trase, për të arritur atje larg, ku dukeshin gjashtë veta, që lëviznin dritat elektrike.

— Epo unë e kam një vjehërr e ti, nuk manjeh Çan Buçin e Hirajt, Tushë! — i tha ajo.

— Sa i egër, aq i mengëm burrë, i urtë-e i nder-

shëm asht. E ai më do me shpirt, se e ka pasë një vajzë dhe i ka vdekë. Mos me dashtë ai, unë nuk kisha ardhun në udhë hekuri.

— Po Gjoka?! — pyeti Tusha sa për t'u gjen-dur.

— Gjoka mbas e fjalë boll, besa!

Rega përplasi qerpikët, tek dalloi Gjokën atje lart, dhe as e pati mendjen te kundërshtimet e Tushës. Asaj iu duk sikur kishte kohë pa u parë me të dhe shpejtoi. «A u lodhe, Gjokë?!» — i tha ajo pa drojë. «Drejtuem hekura, Regë» — i tha ai.

Asaj nate ata do të betononin soletën.

Frynte erë e ngrohtë shiu dhe vajzave u pël-qente që ajo u shpupuriste flokët dhe u rrihte fytyrën vrullshëm. Lora largoi flokët e shpërndarë përpara syve fije-fije. (Po vinte koha të merrej karroca dhe më i zoti do të qe kush hidh-te betonin e parë në soletë. Kështu e kishte ndarë ajo me mendë e veta!) Sakaq ajo mbante me dhëmbë një copë llastiku. Tufëzën e flokëve e mblodhi anës qafës me njérën dorë.

— I ke flokët të mirë, — i tha Tusha dhe ia kapi llistikun.

Lora e kishte përfytyruar ndryshe atë natë betoni, por ajo paskësh qenë e thjeshtë. Disa mbartnin e sitnin rërën e zhavorrin; Bujari me Gjokën sillnin nga depoja çimento, se në të përpjetën e rrugës nuk ngjitej dot karroca; Re-ga bashkë me një tjetër mbushnin, ujë me kova; betomiera gatuante e përziente zhavorr e çimento, e mandej Genci ngarkonte karrocën dhe ajo, Lora karrociere, e mori dhe derdhi betonin e parë në soletë, ku prisnin ta shpërndanin Kujtimi, Tusha... Frynte erë. Lora thirri që andej. Dhe Kujtimi thirri me sa fuqi pati, por era ia mori zërin dhe atë zë e dëgjuan vetëm ata që

ishin pëfreh. Atje lart tek armatura e soletës njerëzit dukeshin më të mëdhenj. Nga betoniera erdhi një zë i shkëputur. Më pas ca fjalë të nga-tërruara dhe zhurma e veglave u përzje me një të qeshur. Era e solli të qeshurën si me të prera dhe ajo herë e fortë dhe herë e fashitur u duk si një e qeshur e pavend. Gjatë rrugës Gjoka hidhte sytë buzë përroit. Në një çast Bujari i tha se ai, shoku i Regës, qe djalë i sjellshëm: i mbushte kovat dhe njérën ia jepte asaj. Gjokës i ngeci fryma dhe filluan t'i trazoheshin mendtë. Ec dhe ec. Afa kaluan dy herë asaj, rruge dhe Regën nuk u zuri syri, Gjokë as barrën nuk po e ndiente mbi shpinë, se «heu!», iu bë sikur i humbi gruaja nëpër natë: «Dita ka synin e një-riut, nata do synin e bufit me pa dorën e kusarit, heu!» — tha Gjoka me vëte. Betoniera rotullonte beton. Era përfontonte zëra të turbullt, që ai nuk i ngjasonte. Përmendej nata dhe mesi i natës, mëngjesi dhe emri i Artinit, që u përzje, me fishkëllimën e ndërkryer të erës: «ffiiuu!», si dhe zëra djemsh e vajzash, por Rega nuk ndihej kurrikund. Gjoka vështroi buzë përroit ku Rega priste të mbushte kovat dhe shoku t'i merrtë e t'i conte përsëri ku gatuhej beton... Ai e dalloi në fundin e asaj drite elektrike dhe i thirri:

— Po ty, a të ka rënë kova në përrua, Regë? Era ia mybyti zérin.

— Ja tek jäm, Gjokë!

Ajo hodhi një hap drejt tij dhe u trëmb, kur e pa të largohet me një thes cimento në kurri. Një natë më parë, kur ata kalonin nëpër rrugët e qytëzës, nuk frynte kaq erë. Era tanë sa po vinse po bëhej më e fortë dhe errësira më larg drivate elektrikë, dendësohenj dhe më shumë. Sytë e saj të mëdhiënj sikut vështrohin me rrathë të murrmë para vetes dhe në gjysmerrësirën para

barakës së cimentos, pamja e Gjokës shëmbëllen-te dhe më e lodhur. Rega u kthyte dhe shkoi buzë përroit. Atje, te baraka, Gjoka i tha Bujarit: «A po shkon me mbajtë ujë, Bujar, dhe Rega...» Bujari nuk foli. Gjoka përsëriti: të vinte Rega në vend të tij.

— Pse?! — pyeti Bujari.

— Epo ke me shkue, pra! — tha Gjoka prerë.

— Ngarkesa e grave është e ndaluar, — vë-rejti Bujari dhe shtresën e ngarkesës e hodhi mbi shpatulla.

— Atë e di unë! — tha Gjoka.

Bujari u largua dhe i tha se do ta padiste me fletërrufe. «Hajt e mos ki hall!» — i tha Gjoka dhe mbeti në përgjim. Ishte larg dhe zërin ia mbështolli era në shtjellën e vet. Bujari po shkonte të mbushte ujë. Rega do të kthehej për të mbajtur thasë. «Ma hidh dhe tjetrin në kurriz!» — i tha Gjoka magazinierit dhe... Rrugës takoi me Regën. Ajo i tha: «Ti e di, unë nuk mundem me mbajtë thasë.» I tha ai: «Nuk ke me mbajtë! Rri e prit aty!» Gjoka vazhdoi rrugën dhe iu duk sikur ndiente të qeshura. Një tha se Gjoka qe fanatik. Ai u shtang. Pastaj... oho! Gjoka me dy thasë në kurriz dhe dikush grishi të tjerët të shikonin. Gjoka u drodh. Përriti kalonte ujë-shumë. Gjoka nuk po ndiente më hapat e vet në-për natë dhe iu duk sikur po shtjellonte një përrallë me një «Gjokë», që nuk dinte ç'të bënte. Ai shkarkoi thasët te betoniera dhe shkoi të Bujari, që mbushte kovat me ujë dhe përrallitej me shokun e vet. Si iu afrua, i thirri në emër. Bujri u çua shpejt në këmbë dhe iu largua bregut, disi i trembur.

— Hë, Gjokë?!

— A po vjen ky shoku yt me mbajtë thasë, Bujar?

— Po Rega? — pyeti Bujari.

— Ajo tē mbajë ujë.

Tjetri dëgjoi heshtazi, mbushi kovën dhe ~~ik~~
pa thënë gjysmë fjale.

— Bëre mirë që nuk iu lute, — tha Bujari.

Gjoka e ndjeu veten si tē rrahur.

XV

Nata me erë kishte fytyrën e vet. Një muntohej tē mbahej, tek zbriste nga urëza. Një ruante karrocën tē mos i përmbysej e t'i derdhej betoni. Njëra nga vajzat largonte fijet e flokut... Oho, një lopatë fluturoi përtej dhe u rrokullis me zhurmë: duket dikush e kishte lënë pa kujdes tek armatura e soletës.

Era, e shiut frynte e stuhishme e vinte e përzier. Po tē frynte në një drejtim, ajo do tē që më e ftohtë dhe më e fortë dhe shiu atëherë nuk do tē mënonte. Asaj nate u prishën flokët, u ngatërruan zérat, u lëkundën llambat elektrike, që krijonin valëzime në rrathë drite dhe në mbarim tē atij turni, u thur legjenda që do tē shëtiste rrugëve tē qytezës. Atë natë, aty ku hûdhej betoni, hijet e vullnetarëve luhateshin dhe dukeshin si tē gjalla në atë valëzim dritash. Aty rriteshin e aty rrudheshin dhe herë-herë përziheshin e dridheshin si ca shufra tē stërgjatura, që rrihnin natën gjer atje ku kapte drita.

— Po djalli e mori! — tha Petroja dhe shtrenëgoi gruashin, si tē ngjeshte fjalën dhe zërit t'i jepte më forcë. — Prisni tē mbarojë kjo shtjellë

më parë dhe mandej...

Ariani përplasi lopatën në anë të karrocës, për ta shkundur më mirë:

— Inxhinier Artini thotë se betoni nuk pret për nesër, usta!

— Ai nuk tha të rrezikojmë.

— Secili kokën e ka me vete, usta! Edhe në mos e pastë...

Ajo fjalë mbeti përgjysmë dhe nuk u mor vesh kush e tha, se nga urëza u ndje rrapellima e një karroce të përbysur dhe sharja e rëndë e një vullnetari. Fluturoi dhe një lopatë. Petroja këlthiti: «Këtu inxhinieri jam unë!» Ajo thirrë edhe vetë atij iu duk e gjerrë. Nuk kaloi gjatë dhe tërë ajo pamje në një çast u errësua: secili ndjeu të papriturën. Dritat u fikën. Era ndihej si një kuisje e largët e ta merrte frymën. Fryu e fryu dhe pastaj u qetua. U duk sikur dhe ajo vetë mbeti pa frymë, si një kacek i grisur. Vullnetarët filluan të thërrisin njëri-tjetrin. Gjoka shkoi mbas zërit të Regës, që ngjasonte me thirrjen e atij zogu të natës, kur kérkon shokun nëpër dru-rë: «Gjokë! Gjokë!» Ajo e dëgjoi tek i tha: «Ja tek jam, Rega!» dhe iu afroa më shoqet.

— Po na i shpon sytë errësina. — tha Tusha.

Martës iu duk sikur po i dhembnin sytë, tek mendoi errësirën:

— Do të ketë këputur ndonjë tel firaunia, — shfreu Petroja. Ai ndjeu shqetësim, sikur të kishte ethe në palcë të kurrizit.

— Betoni nuk pret, usta! — tha Artani.

— Do të presësh ti, në mos pret betoni, — tha Petroja.

— Duhet të nisemi, të kërkojmë défektin, usta! — tha ai përsëri.

Petroja as e kishte menduar ndonjëherë që ai zë t'i vinte si urdhër i prerë. Tek ata po zgjo-

hej burrëria. Atij i shkoi mendja te «koha». Ko-
ha është diçka e madhe në jetën e njeriut dhe,
për këtë, ai qe grindur edhe me Artinin.

Se kush kishte ndezur një zjarr.

Rega i tha të shoqit të vishite xhupin, se mos
ftohej.

Kur u shuan dritat, Genci nuk nxori asnjë zë.
Mori lopatën dhe u nis pér andej nga zbrazej
betoni në soletë. Rrugës u ndodh përballë me
Lorën, tek zbriste urëzën me dërrasa, që dilte
nga shtrati i përroit dhe, si dredhonë në breg,
ngjitej gjer te soleta. Ndonëse e dalloi, ajo py-
eti se cili qe dhe bëri një hap prapa.

— Genci jam, — tha ai pa lëvizur nga vendi.
Zëri i tij i druajtur Lorës iu duk si një zë i ne-
mitur.

— Mirë, ç'do?!

— Si thua ti, ç'dua unë?!
Lora u tremb dhe mori të largohej, se ishte
natë dhe nata ruante të fshehta. Pëstaj seç u
zhvillua një bisedë e ngatërruar! Që asaj dite,
ajo ndjeu dhimbje pér sa ndodhi. Dhe kjo dhim-
bje po i ripërtërihej përséri. «Nuk e di,» — i
tha ajo. «Pse s'e di?!» — i tha ai dhe e kapi lek-
të në krah. Ai i tha se deshi të bisedonte më gjat-
të. Ajo ia mori dorën dhe ia hoqi nga krahut i
vet. Vetëm kaq i mbeti asaj ndër mend dhe iku
pér te shoqet e veta. Dora e Gencit u lëshua si e
këputur.

Luhatjet e flakëve herë-herë ndriçonin fyty-
rat e vullnetarëve dhe herë-herë ato fytyra i
mbulonte një hije. Lora vajti pranë Bujarit. Zja-
rri digjek bubulak, dhe ndricimi hije-dritë i jep-
te secilit pamjen e një ravijëzimi si në gravurë,

ku përhijohej dhe silueta e Lorës. Agushi i lutej ustait t'i jepte pincat. Ai kishte bërë një kurs për elektricist dhe merrte vesh. «Nuk e shëh?! — tha Petroja. — Dy javë kurs ti dhe dashke të shkosh vetëm! Unë kam gjithë jetën që merrem me të dhe prite ndonjë ditë...» Petroja nuk e çoi mendimin deri në fund, se nuk deshi të përmendte rrezikun midis vullnetarëve.

— Po kur të vijnë dritat, kush do të na e ndezë betonierën?! — pyeti Kujtimi.

— Si thua, Arian? — pyeti dhe Petroja për t'i dhënë zemër. — Kujdes masën: tre me dy!

— Si urdhëron, usta! — u gatit Ariani, si të qe nën urdhër.

Petroja i tha Agushit të nisej dhe vetë i shkoin nga pas. Sa më shumë që largoheshin nga zjarret, aq më shumë u humbišnin dhe hijet nëpër natë. Zjarret digjeshin dhe rrëth tyre nga larg vullnetarët ngjanin si barinjtë në fushë, netëve të verës, tek tregojnë përralla për të përzënë gjumin. (Na ishte një urë, një betonierë dhe një grup vullnetarësh!) Vullnetarët lëviznin rrëth zjarrave. Dy vajza të mbështetura kokë më kokë, sesi nisen vetiu një këngë të dëgjuar kësaj anë, që këndohej e qetë:

U shkëput një yll, vajti drejt hënës:

Rritur goca rritur, me nazet e nënës!

Fustanin e gjatë, gjer në fund të këmbës:

Rritur goca rritur, me nazet e nënës!

Më hyje në odë, me gishtat e këmbës:

Bobo, goca rritur, me nazet e nënës!

E sillje kafenë në mes të pëllëmbës,

Rritur goca rritur, me nazet e nënës!

Të tjerët dëgjonin këngën dhe përsërisnin me vete melodinë.

Atë natë nuk kishte as hënë, as yje dhe kështu nuk mund ta shihje yllin e këputur, për ta kërkuar e gjetur, kudo që të binte, siç thoshin andej nga anët e Lorës. E éma i kishte thënë se dikur vajzat nuk flinin në netët e kthjellëta, po rrin e vështronin yjet, paditur ku binte fati i tyre (se kështu qe fati i vajzës, që bashkohej me yllin. Ato caktonin një yll dhe prisnin që ai të këpuntej). Si shumë e ngatërruar qe kjo lidhja me yjet dhe Lora nuk ia tha Bujarit. Ajo i tha se nata e kthjellët është e ftohtë dhe të ftohtët e dërgojnë yjet. Ja, asaj nate ishte vjeshtë e dytë dhe prapë nuk bënte aq ftohtë, se nuk kishte yje. Nata e kthjellët e ngrinte vesën dhe, kur kishte re, nuk kishte as brymë... Kjo qe një bisedë për natën dhe për yjet. Lora mendonte se do të qe mirë të shkëputeshin yje mbi lumë, paçka se ato mund të dërgonin të ftohtët. Bujari ca i dëgjoi, ca nuk i dëgjoi. Pastaj ata folën për Gencin, për Martën, Regën dhe për dashurinë e madhe, si një vazhdim të asaj bisede të lënë përgjysmë, kur diskutohej për Gjokën. Bujari mendonte se dashuria e pastër nuk ka nevojë për fshehtësira e tinëzi, se ato e vyshknin dhe e zvogëlonin, ndonëse çuditërisht fshehtësia sikur ruante dhe diçka të vegantë dhe joshëse në jetën e të dashruuarve. Lora asnijëherë nuk e kishte dëgjuar Bujarin të fliste kaq gjiltër e pa drojë. Diç e kishte gjetur asaj nate, apo vetë nata ia dëlirte mendimet si poetëve. Ajo e vështronë me kureshtje, si për t'ia kuptuar dhe formën e fjalës, kur i dilte nga goja. Ai i fliste për dashurinë me ca fjalë që e ngacmonin.

— Po më çudit, Bujo! — i tha ajo.

— Duket më ke kujtar për shakaxhi, — i tha ai.

— Nuk është e vërtetë!

— Ti përpélitesh dhe nuk vendos, — i tha ai.
Fjalën e kishte për Gencin.

— Nuk është e vërtetë! — përsëriti ajo me padurim.

— Ti ke frikë!

Ajo i tha se secili èndrrën e shihte vetë. Fjalën e kishte për vete dhe për Gencin. Edhe atje te zjarri kërkonin të gjenin rrugëdalje. Një tha se paskësh qenë avaria. Një çast pati hutesë, që tërroqi vëmendjen dhe të Bujarit dhe të Lorës, por i pari që mblodhi veten ndër ata përreth qe Ariani: «Ohu! Dëgjoni ju?! Ngushëllim të bukur po na thotë: Avari. E ku do të dijë norma për avari, o shokë!»

— Një minutë, se e gjeta! — tha Bujari.

— E gjete?! — mbeti ajo duke pritur.

Ai tha gati me një frymë se duheshin ndezur zjarre rreth betonierës. Gjoka qeshi. Rega kafshoi buzën.

— Përse qesh?! — pyeti Ariani.

— Me zjarr do me e lëvizë betonierën ai?!
Rega mbeti me të qeshurën në buzë: «Hë, do me ia hedhë Gjokës!» Bujari u ul mbi një kovë të kthyer përbys dhe tha se betonin do ta bënин me krahë. Të tjerët ia pëlqyen mendimin. Gjoka diç përbluante. Rega ende kishte mbetur me vështrim mbi Bujarin dhe ai mundohej t'i mënjanohet atij vështrimi: dy sy të mëdhenj kishin shtangur mbi të dhe as vërenin gjë tjetër përreth. Gjoka u shkëput nga e shoqja, shkoi pranë Bujarit dhe i tha të çohej. Bujari u çlir nga vështrimi i Regës dhe u çua si hutaq.

— Çohu e sill përsëri kova! — tha Gjoka.

— Të lumtë, Gjokë! — tha Kujtimi dhe brofi ta përqafonte.

Rega u gazmua. «Gjoka ka me vra ariun në

bjeshkë e jo ma... hihih!» — qeshi ajo me vete. Kovat do të mbusheshin me hi të zjarreve dhe, në qoftë se s'kishte për të gjitha, një pjesë do të mbushej me dhë. Ariani vrapoi te fuçia për naftë. Rega kishte parë dhe të tjera kova matanë urës.

— Shko e merri me Bujarin! — urdhëroi Kujtimi.

Gjoka heshti në mendimin e vet. Ishte natë, frynte dhe erë. Atij iu duk sikur po e vinin në provë. «Nata shihte me syrin e bufit!» Qe një proverb, që Gjokës iu kujtua përsëri.

— Po shkoj dhe unë! — tha Lora.

— Jo! Ti mbush kovat! — tha Kujtimi.

— Shkoni e i sillni, Rega! — tha Gjoka pritur. Kjo u duk si një çudi.

Njerëzit u çlirën vetiu dhe u përtérinë me forca të reja. Lora tha se atje kishte shumë kova dhe u nis pas Regës. Ishte natë. Frynte erë. Bujarit iu kujtua se fjala me Lorën i kishte mbeetur te ëndrra.

XVI

Genci as foli e as përshëndoshi, por nu afroa dhe hodhi hi në kovë të Lorës. Asaj iu duk si një i marrosur me atë vështrim të picërruar, aty pranë zjarrit, tek shpejtonte të shtinte sa më shumë hi në kovë. Ajo u përhit ndër sy dhe as mendoi më për kovat, ku do të digjej hi i përzier me naftë. «Mos, Genci!» — tha ajo. Era ia tori fjalën nga buzët. «Më pëlqen të shtie hi!» — tha ai dhe e lëshoi kovën përtokë. Kova u përplas, por Lora sakaq e kapi dhe nuk e la të derdhej. Dhe tek ura nuk desha të të fyej,» — tha ai. Ajo ndjeu angështi dhe nuk deshi ta përmendtë më atë bisedë.

Ai qeshi nën hundë dhe Lorës iu duk sikur mori pamjen e një tuhafi, kur i përmendi se, po natën, ajo qe gati të shkonte me Bujarin pér të marrë kovat. Lora ndjeu një drobitje të përgjithshme të shtatit. Ajo deshi t'i thoshte se qe edhe me Regën. Dhe u ul t'i shtinte kovës hi, por më parë trazoi zjarrin që të mos shuheshin flakët. Drita e zbehtë e flakëve i lëpiu fytyrën. Dhe fytyra e saj qe e zbehtë. «Kjo më ka çuditur gjithnjë që dhe hiri digjet,» — tha ai. Lora imbeti me kovë në dorë dhe endjeu veten si një e dënuar e pafaj. Kur u ndezën kovat me naftë e hi, flakët luhateshin në atë natë vjeshte dhe krijonin vatra të kuqërrrema drite. Kovat ngjanin me flakadanë dhe i jepnin asaj nate pamjen e festave të vjetra, kur hidheshin themelet e kalave. Theroria bëhej natën.

Frynte erë. Kovat digjeshin nëpër natë. Gjoka shpjegonte se një herë në qytet kishte parë fëmijët në ditë festë të ndiznin nga një kuti me naftë e hi dhe vërvhonin rrugëve. Me ata fëmijë i qe ngatërruar dhe Bujari. Shaka vullnetarësh në një natë betoni. Frynte erë.

— Më pëlqen mendja jote, Gjokë! — tha Genci në një çast.

Lora e kuptoi shpotinë. Ashtu kishte qenë Bujari, gjithë jetën fëmijë.

Gjoka qeshi:

— Fëmija i paudhë nguc, Bujar!

Rega pa Gjokën: «Gruan pranë e ban hoka?!» Kovat digjeshin nëpër natë. Aty pranë betonierës sitnin zhavorr. Një e merrte nga grumbulli dhe formonte pirgun e parë, ku derdheshin dy thasë cimento nga Gjoka dhe Bujari dhe, mandej, thuajse lopatë më lopatë, zhavorri kalonte në dy radhë vullnetarësh. Së fundi i hidhej ujë. Kjo ishte dhe përzierja e fundit, ku duhej shpej-

tësi, që betoni të mos thahej. Mandej mbushej karroca e karrocieri vraponte dhe e zbrazte në soletë, ku e shpërndanin Tusha, Marta dhe një i ri fjalëpakë, që e thërrisnin «ekskavatori». Ai ndonëse me një dorë të këputur, punonte si një ekskavator i vërtetë: mbështete në ijë bishtin e lopatës, e shtrëngonte me llërën e dorës dhe, kur jepte fuqi me të djathën, ndihej vetëm zhurma e lopatës në shpërndarjen e betonit: «Vring! Vring!»

Aty nga mesnata Sokoli u ngjit në soletë pa zhurmë e bujë dhe pa përshëndetur askënd. Mësoret u panë me shoqja-shoqen. Njëra diç bëri me shenjë. Tjetra kafshoi buzën. Sokoli i vuri re dhe nuk bëri zë. Nën ritmet e tokmakut ai përpunonte vargjet e një vjershe:

«Rak e tak!» një tokmak

Godet nëpër natë,

«Vring-e vring!» dhe një lopatë.

Sokoli ndihej i poetepsur. Lora zbrazi karrocën dhe përshëndeti. Dhe ai e përshëndeti, por nuk deshi t'i jepte shoqëri një vajze, që e kishte quajtur shakaxhi të lezetshëm. Së largu pa Bujari e siguroi se qenë aq të lehtë, sa Gjoka mbante dhe nga dy. Gjoka u tërbua. «Dua ta rrej, prandaj,» — tha Bujari si heshtazi. «Rrej, por jo me Gjokën,» — tha Gjoka e iku dhe e la pa përfillje. Bujari shpejtoi pas tij. Sokolit nuk i pëlqeu ajo mendje, se për të tillë thasë çimentoje kaq të lehtë nuk kishte dëgjuar. Ai iu lut Kujtimit t'i gjente një vend tjetër pune, ngaqë tokmaku...

— Po të hanë duart a?! — e pyeti Tusha.

— Si urdhëroni! — iu përgjigj ai.

— Shpina e dorës?! — qeshi ajo.

Sokoli e pa dhe nuk foli. Kishte filluar dhe

Tusha tē bënte humor, pa le! Tusha me opinga që kishte prerë flokët dhe atij i dukej si pula bishtshkulur. Ai la tokmakun dhe shkoi për nga depoja, se vërtet e pa Gjokën tē mbante dy thasë. Ca larg, pas tij, vinte Bujari. Sokoli nxitoi t'i priste rrugën dhe, pa e ditur se po futej në lojën e tyre, iu lut Bujarit t'ia hidhte thesin mbi shpatull dhe vetë tē kthehej e tē merrte një tjetër. Dhe, ai ia hodhi. Sokolit po i merreshin këmbët. «Oj?! Ojaaaa! Pasha verën, ra!» — thirri Tusha nga soleta. Ajo qeshi. E qeshura e saj u përzie me vringëllimën e lopatave, me rrahjen e tokmakaëve dhe me një sharje tē Sokolit, që i bëri turirit tē Bujarit... Asaj nate ai nuk pati gjumë dhe u ngrit e erdhi aty ku derdhej beton. Tusha i dha zemër se nuk e lëshonte burri veten për një thes cimento. Dritat u ndezën. Brohorima e vullnetarëve Sokolin e gjeti tē ulur mbi thes.

Lora shpejtoi tē gjente Bujarin, se kishin lënë një bisedë përgjysmë. Ajo natë betoni ende nuk kishte mbaruar. Kovat digjeshin pa u vënë re.

XVII

Vjeshta qe laramane: gjelbërimi i mekur i pemëve qe përzier me njollat e verdha tē gjetheve ende tē parëna dhe shkrihej me pamjen e qiellit, që dukej si i larë mbas shiu. Andej nga ana e detit vareshin ca tufëza resh tē bardha dhe ngjanin si lëkurë deleje. Rega ishte bujtëse në shtëpinë e Petros. Ajo sodiste pamjen joshëse tē Elenës dhe i dukej sikur përpara po i çelej një botë tjetër e nga gjoksi po i fërgëllonte një melodi e re, që deri atë ditë kishte qenë e panjohur

për të. Elena i bënte guga djalit dhe ai nuk ia ndante vështrimin. Nga strehët e banesave të mbuluara me tjegulla, harabeli fluturonte me turË e cicërima i vinte si e harruar. Regës i dallonte kurmi i drejtë, shtati i hedhur, qafëza e gjatë. Atë këngë të Elenës për djalin ajo e dëgjonte për të parën herë dhe mundohej ta përsëiste me vete:

«Gugugu!» — këndon gugash!

Në një degë sheqerbashi,

Gugugu!

Kliti i gëzohej Elenës, kur ajo e gicilonte. Pastaj ajo e pyeti Regën se si i dukej djali. Rega iu afrua dhe iu përkul paksa. Supet e Regës dukeshin si dy pllaka të prera.

— Bukuria vetë! — tha ajo.

— Është ca budalla, — iu përkëdhel e ëma dhe ia shkuli hundëzën të birit të mos ia merrnin mësysh. Klitoni u përvaj dhe Elena e ngjasoit përvajin e tij. «Budala, budala! Të ka mami budala!» Djali hoqi me ngashërimë. Elena e mori në gji dhe filloi t'i këndellej e të përkundej me të. Regës iu duk sikur po ndiente gjëzimin e krijesës së vet dhe ia mori Elenës nga duart.

— Edhe ti do ta keshë një, — tha Elena.

Regës se si i erdhi. I ra një të kuq i lehtë mollëzave të faqeve dhe buza i mbeti si në të qeshur. Ato po thoshin ca fjalë, sikur ta njihnin shoqja-shoqen prej kohësh, ndonëse kjo ishte hera e dytë që Rega vinte në këtë shtëpi. Një herë me Gjokën dhe tanë vetëm. Asaj ndajnate, kur qe edhe Gjoka, sec qishte treguar Petroja për një që e luanin Jero, apo Jeronim, që nuk qishte fëmijë të barkut të vet. Elena dhe Rega

1) mashkull i guguftusë (kumrisë)

po gatuanin në kuzhinë dhe dëgjonin prej an-dej se ai qe fotograf dhe me aparatin e tij nxirr-te gjithmonë fëmijë... Fëmijë në çdo fotografi Elena i tha të merrte dy pjatat e të shkonte mbas saj. Dhe ajo i mori. Më parë Elena vendosi pí-runët, mandej pjatat, ku secili në pjatën e vet kishte djathë, vezë të ziera të ndara përgjysmë, mish të skuqur, sallam të prerë në feta dhe kokrra ulliri. Pranë pjatës secilit i vuri një pecetë. Elena e ftoi të zinte vend. Rega pa Gjokën. Ata e kuptuan se me miqtë uleshin dhe gratë. Petroja coi gotën dhe e cakrroi me Regën, mandej me Gjokën. Asaj sesi i erdhi dhe iu duk e pahirë që ajo, më parë se Gjoka, po bënte urimin në shtëpinë e mikut. Mandej e coi Elena dhe e takoi me miqtë. Gjoka bëri sikur nuk e vuri re, kur Elena e takoi më parë me të dhe uroi që së shpejti të kishin një djalë. Dhe madje nuk u bë më fjalë as për Gjokën dhe as për Regën. E zonja e shtëpisë herë-herë cohej e shërbente dhe shkëmbente fjalë me miqtë. Mandej Gjoka i bëri shenjë Regës dhe ajo u qua të shërbente. «Uuu?! Ti je mikeshë!» — tha Elena. Tha Gjoka: «Nuk prish punë!» Tha Petroja: «Në ka dëshirë, Elena....» Tha Rega: «Sa me mësue!» Këtë e mban-te mend mirë Rega. Edhe se Jeroja e quante të sho-qen teta Leta, si e thërrisin fëmijët, e mbante mend. Edhe se ai nuk ia kthente asnjëherë fjalën, se ajo qe grua e mirë dhe ia ndiente dëshpërimin të shoqit dhe nuk i thoshte asgjë kur ai pinte ndopak. Teta Leta i thoshte të merrnin e të rritnin një fëmijë, por ai e donte ta kishte nga barku i vet. Teta Leta e donte shumë të shoqin. Dhe ai e donte. Aty nga mosha pesëdhjetë e tre vjeç Jeroja filloi ta ndiente dhe më shumë nevo-jën pér të pasur një fëmijë nëpér këmbë, se vinte në shtëpi, hapte derën dhe shtëpia i dukej e shur-

dhër. Ai rrëmbushej në shpirt me një ankth dhe i vinte për të qarë... Jeroja kishte marrë një zog dhe e kishte vënë në kafaz. Pastaj e kishte mësuar që, sa herë të ulej e të pinte, zogu dilte nga kafazi dhe vinte e çukiste meze, në një gjysmë veze të zier enkas për të. Kështu që zogu u bë si pjesëtar i shtëpisë dhe teta Leta e Jeroja mundo-heshin t'i krijonin hare. Zogu fluturonte, ulej mbi gju dhe ai e ushqente e fjalosej edhe me të, edhe me teta Letën. Pastaj zogu u mësua ta dallonte Jeron edhe kur ngjiste shkallët (se Jeroja fliste që te shkallët me zogun) dhe sa vinte çelësin në derë, ndiente cicërimën e veçantë të zogut. Sa hynte brenda, zogu i turrej dhe e çukiste fluturimthi. Po erdi një ditë dhe Jeron e kapi ankthi. «Ankthi?!» — pyeti Elena papritur. «Po. Sëmundje: heq thellë me ngashërimë, vetiu», tha Petroja. «Pse?!», pyeti Elena e trembur, «Për një zog?!». Petroja i tha: «Për një fëmijë!» Regës se si iu duk, sikur dhe ajo e kishte një zog në barkun e vet, me sqep e krah e flatra... Kështu kishte mbetur në mendjen e saj ajo histori e dhimbshme: Gjoka e kishte parë me ca sy të venitur dhe nuk e kishte quajtur burrëri atë marramendje të fotografit për një trumcak apo vocërrak. Tërë ato ditë ajo kishte jetuar me zogun e vet. «Sa pemë nuk lidhin kokrra!», kishte thënë Gjoka. «Ah, jo!», mendoi ajo: gjithkush kishte frutin e vet dhe shtohej.

Ajo mori Klitin gushagushë dhe deshi ta thith-te e ta shtinte në gji. «Na, gratë, jemi pema!», i tha ajo dhe i dha të voglin nënës. Elenës i pël-queu ky mendim i thënë si pakujdes. «Gjallojmë botën, si toka, Elenë! Më ka thanë nana», ngazelleu ajo. Elenës syri i Regës iu duk si sy njomë-zaku, që përlotet së koti. E ëma i kishte thënë se «barku ishte gurra», dhe në ato përsëritje Elena ndiente Regën e çiltër, të pafajshme dhe bindjen

e saj se gruaja duhej ta gjallonte jetën, ndryshe çdo gjë do të thahej e do të zhuritej si një bimë e paujë. Prandaj, duket, i kishte bërë dhe kaq përshtypje aknthy i Jeros, që në fotografitë e veta nxirrte gjithmonë fëmijë dhe kishte qarë hallin e teta Letës me bark të shterpëzuar e të tharë.

— Ti, a ke gjë? — pyeti Elena si e rrëmbyer.

Regës, për çudi, Elena iu duk e trembur. Ajo puliti sytë paksë. Elena e kuptoi se edhe Rega do të bëhej nënë.

— Do t'i bajmë vëllazën, — tha Rega si e marramendur në fjalë dhe iu afroa Klilit aq afër, si të donte ta thëthinte me frymën e vet, — vëllazën ose motër e vëlla.

— Do ta malim nuçë! Nuçë me shami të kuqe! — tha Elena me përkëdheli. Ajo mori e shtroi në dysheme të verandës një copë të leشتë, shkoi e solli rrethoren dhe vuri në të djalin.

— Rri aty tanë e rrezohu! — i tha ajo dhe vuri përpara një pjatë alumini dhe dy lugë të vogla. Elena ia hoqi dhe tutat prej fanellate t'i rreziteshin mirë kofshët dhe duart në diellin e vjeshtës. Diali filloi të merrej me lodrat. Matanë urës një vajzë e vogël me flokët bukle e thirri Klitin dhe ngriti përpjetë një tufë trëndafilash të freskët. Diali, sa dëgjoi u hodh nga vendi në drejtim të zërit. Vajza kaloi urëzën me dërrasa. Elena i doli përpara dhe e përgëzoi për trëndafilat e bukur që i solli.

— M'i dha mami për Klitin, — tha vajza e vogël.

— I thuaj mamit se atë më të bukurin do t'ia falim teta Regës! — i tha Elena dhe sakao e afroi vajzën në drejtim të Regës që ta zgjidhë tevetë.

Rega u gjallërua dhe shpejtoi të merrte trën-

dafilin e kuq, por, tek e kapi, gjembi i shpoi gishtin. Rega e largoi menjëherë dhe mbeti duke parë Elenën. Fëmija mbante trëndafilat në dorë dhe queshte: «Teta Ega, trëndafili ka gjemba!» Elena buzëqeshi dhe luajti kokën. Duket nga ana e Regës nuk kishte trëndafila. Ajo mori tufën, veçoi trëndafilin e kuq dhe i tha Regës se gjembi ia ruan bukurinë trëndafilit. Vajza e vogël vajti te Kliti që zgjaste duart nga rrethorja. Rega i mori erë trëndafilit dhe vesa i lagu hundën dhe buzët.

— Po të mos kishin gjemba, edhe fëmija edhe nuset do t'i këpusnin lehtë trëndafilat, — tha Elena dhe sakaq nxori nga tufëza dhe një trëndafil tjetër të bardhë. — Jepja Gjokës, — i tha ajo.

Rega mori trëndafilin e bardhë dhe e bashkoi me të vetin. Pastaj Elena mori thikën, hoqi gjembat e një dege trëndafili dhe ia hodhi të birit në rrethore, tek lozte me Albanën e vogël. Klitonit e mori trëndafilin dhe e bëri fletë-fletë.

— Po jo ashtu, more budalla, jo! — thirri Albania. — Ky e prishi, teta Lena.

— Le ta prishë!

Elena i hodhi një tjetër trëndafil dhe pyeti Regën se çfarë kishte mundur t'i gatiste fëmijës.

— Asgja!... E çka duhet me i gatitë? — pyeti Rega.

Elena shkoi e mori një bohçe, që e kishte bërë gati me ndërrresa për fëmijën, e vuri në tavolinën e verandës dhe filloi t'ia tregonte Regës një e nga një. Rega ndjeu t'i kalonte nëpër trup një afsh i ngrohtë mirënjojheje për kujdesin e Elenës. Nga rruga u ndje zëri i Petros. Ai i thirri Kllitit, për të kujuar Elenën se nuk po vinte vetëm.

— Nuk ban me i pa burrat, — tha Rega dhe shpejtoi t'i mblidhëte. Duart e tyre u ngatërruan

me njëra-tjetërën dhe nuk po mund t'i lidhni. Burrat kaluan urën. Regës i dukej sikur i kish-te mbi krye e po shihet përpëlitjen e duarve të saj. Elena e qetësoi dhe Rega u mënjanua. Ajo lidhi bohçen dhe e largoi nga tavolina. Gjoka erdhi e përshëndeti Elenën. Petroja përshëndeti Regën.

— Të ka ruajtur një trëndafil, Gjokë, — tha Elena.

Gjoka bëri sikur nuk dëgjoi. Petroja i tha ta merrte, se dhe Elena i ruante atij trëndafila e ato kishin erë të mirë. Rega i ofroi trëndafilat. Gjoka bëri sikur nuk e kishte mendjen dhe luajti kokën, gjoja se kjo qe një sjellje e mirë e Elenës. Petroja i përsëriti se i pëlgenin trëndafilat e kuq. Atëherë dhe Gjoka zgjati dorën si pa kujdes dhe sakaq e tërhoqi, se dhe atij ia shpoi gjembi gishtin. Rega e vështroi me sy të qeshur:

— A nuk e di se gjembi ia ruan bukurinë trëndafilit!?

— Kush ta ka thënë, Elena? — pyeti Petroja aty për aty dhe pa nga e shoqja. Rega buzëqeshi dhe u skuq.

— Uh, ja! Nuk e sheh?! Do apo nuk do ti, atje ku është e bukura është dhe gjembi që e ruan, — tha Elena gjithë ojna, mori bohçen e mble-dhur dhe ftoi Regën të shkonte mbas saj.

— Dëgjoje! — tha Petroja me ngazëllim.

— Si kujtove ti?! — dhe Elena u nis e para për në dhomë, ku do të rendisnin rrrobat përfëmijën.

Gjokës iu duk një lojë e përgatitur enkas.

Ca re nga ana e detit, ende qëndronin të varurë në qiell.

Albana dhe Kliti grindeshin në rrethore përfletë trëndafili *“suh i pshë”* ohe aq tërkeshes.

Bashkë